

HUMAN  
RIGHTS  
HUMAN  
HUMAN  
RIGHTS

**RAPORTI I SHOQËRISË CIVILE  
PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
NË KOSOVË NË VITIN 2020**

---

HUMAN  
RIGHTS

MAJ 2021

# PËRMBAJTJA

---

<b>1. HYRJE</b>	<b>1</b>
<b>2. METODOLOGJIA</b>	<b>1</b>
<b>3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË</b>	<b>3</b>
<b>4. VËSHTRIM MBI NDIKIMIN E COVID-19 NË TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË</b>	<b>5</b>
<b>5. SEKSIONI A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE</b>	<b>9</b>
5.1. E drejta për trajtim njerëzor dhe ndalimi i torturës	9
5.2. E drejta për liri dhe siguri të personit	12
5.3. E drejta për proces të rregullt gjyqësor dhe mjet juridik efektiv	14
5.4. Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim, dhe e drejta e privatësisë	16
5.5. Liria e tubimit paqësor	18
5.6. Liria e asociimit	20
5.7. Liria e besimit, ndërgjegjës, dhe e fesë	21
<b>6. SEKSIONI B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULURORE</b>	<b>23</b>
6.1. Të drejtat e punës	23
6.2. E drejta për arsim	27
6.3. E drejta për kujdes shëndetësor	30
6.4. Të drejtat pronësore	33
6.5. Të drejtat kulturore	35
<b>7. SEKSIONI C: TË DREJTAT E PERSONAVE OSE GRUPEVE TË CAKTUARA</b>	<b>40</b>
7.1. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	40
7.2. Të drejtat e fëmijëve	44
7.3. Të drejtat e rinisë	47
7.4. Personat me aftësi të kufizuara	48
7.5. Të drejtat e komuniteteve	51
7.6. Të drejtat e lgbt+	54
7.7. Personat në lëvizje	56
<b>8. SEKSIONI D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT</b>	<b>59</b>
8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut	59
8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut	64
8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut	66

# LISTA E SHKURTESAVE

<b>AGK</b>	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
<b>AGTS</b>	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë
<b>AIP</b>	Agjencia për Informim dhe Privatësi
<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>AKKVP</b>	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
<b>Ashkali</b>	Ashkali i Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>Boshnjak</b>	Boshnjak i Kosovës
<b>BSPK</b>	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
<b>CAT</b>	Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës
<b>DHSLK</b>	Dhuna seksuale lidhur me konfliktin
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>Egjiptian</b>	Egjiptian i Kosovës
<b>FCPNM</b>	Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
<b>GKK</b>	Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për personat LGBT+ në Kosovë
<b>Goran</b>	Goran i Kosovës
<b>GPNA</b>	Grupi i Punës për Ndalimin Arbitrar
<b>GPPZH</b>	Grupi Punues për Personat e Zhdukur në lidhje me Ngjarjet në Kosovë
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>IKSHPK</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>IPNDESHK</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>KDPAK</b>	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
<b>KEGFDG</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>KEGFDR</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KGVK</b>	Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës
<b>KK</b>	Kuvendi i Kosovës
<b>KNKK</b>	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq

<b>Komisioni i Venedikut Konventa e Stambollit</b>	Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
<b>KOS</b>	Kisha Ortodokse Serbe
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>KPT</b>	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit
<b>KQPZH</b>	Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur
<b>KQVR</b>	Këshilli Qendror i Veprimit Rinor
<b>KVRL</b>	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
<b>KZM</b>	Këshilli për Zbatim dhe Monitorim
<b>LGBT+</b>	Lezbike, Gej, Biseksual dhe Transgjjinor
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
<b>MPK</b>	Mekanizmi Parandalues Kombëtar
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>OBSh</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>ODIHR</b>	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>OHCHR</b>	Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
<b>OJQ</b>	Organizata Jo-Qeveritare
<b>OP-CAT</b>	Protokolli Fakultativ i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit a Ndëshkimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>OSHC</b>	Organizata e Shoqërisë Civile
<b>PNDPC</b>	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
<b>PPM</b>	Pajisje Personale Mbrojtëse
<b>PSRK</b>	Prokuroria Speciale e Kosovës
<b>QBPZH</b>	Qendra Burimore për Persona të Zhdukur
<b>QK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>Roma</b>	Rom i Kosovës
<b>Serb</b>	Serb i Kosovës
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>Shqiptar</b>	Shqiptar i Kosovës
<b>UNESCO</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
<b>UNHCR</b>	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>UNMIK</b>	Misioni i Administratës së Përkohshme të KB-së në Kosovë
<b>UNSC</b>	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos diskriminim

## 1. HYRJE

**1.** Ky raport<sup>1</sup> ofron një pasqyrë të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 2020, përfshirë problemet dhe sfidat kryesore për realizimin e të drejtave të njeriut si dhe shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut. Raporti është përgatitur bashkërisht nga OSHC-të që punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë me qëllim të plotësimit të boshllëkut ekzistues në raportimin e përbashkët për të drejtat e njeriut në Kosovë në nivel lokal dhe ndërkombëtar, si dhe rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit midis tyre. Ky është raporti i dytë i kësaj natyre, që vjen pas raportit të parë të tillë për periudhën e vitit 2019.

**2.** Raporti është i strukturuar në katër seksione kryesore. **Seksioni A** trajton të drejtat civile dhe politike, ku hyn edhe e drejta për trajtim njerëzor dhe ndalimi i torturës; të drejtën për liri dhe siguri, të drejtat për proces të rregullt gjyqësor dhe mjet juridik efektiv; lirinë e shprehjes dhe e mendimit, të drejtat e informimit dhe të drejtën për privatësi; lirinë e tubimit paqësor; lirinë e asociimit; dhe lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë. **Seksioni B** nga ana tjetër, analizon të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, në veçanti të drejtat e punës, të drejtën për arsimim, të drejtën për shëndetësi, të drejtat pronësore dhe të drejtat kulturore. **Seksioni C** vlerëson të drejtat e personave ose grupeve specifike, përfshirë ato të grave; fëmijëve; të rinjve; komuniteteve joshumicë; personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjjinorë (LGBT+), si dhe të personave në lëvizje. Dhe në fund, **Seksioni D** adreson çështjet të ndërlidhura të drejtësisë tranzicionale, korrupsionit dhe të drejtave të njeriut, dhe të drejtave të njeriut dhe mjedisit.

## 2. METODOLOGJIA

**3.** Ky raport adreson çështjet dhe sfidat më urgjente të të drejtave të njeriut në Kosovë që janë përzgjedhur pas një vlerësimi të plotë të kontekstit lokal dhe bazuar në një proces konsultativ me OSHC-të për të drejtat e njeriut në Kosovë si dhe në kontributet e tyre në raport. Megjithëse raporti është gjithëpërfshirës, duhet pranuar se ka kufizime në atë që është mbuluar.

**4.** Procesi i hartimit të këtij raporti është bazuar nëparimin etë pjesëmarrjes së të gjitha OSHC-ve që punojnë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivelin lokal dhe qendror në Kosovë. Informacioni i përpiluar dhe i paraqitur është pasqyrim i kontributeve të drejtpërdrejta me shkrim të disa OSHC-ve, hulumtimit të literaturës dhe procesit konsultativ në mes të OSHC-

<sup>1</sup> Ky raport është përgatitur në përfundim të fazes së dytë të projektit të quajtur "Angazhimi me shoqërinë civile në monitorimin dhe raportimin rreth të drejtave të njeriut" i financuar nga Komponenti për të Drejtat e Njeriut i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Zyra e Komisarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) për të forcuar kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë për monitorimin dhe raportimin rreth të drejtave të njeriut. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të OSHC-ve kontribuese që e hartuan dhe përgatitën këtë raport.

ve. Disa OSHC kanë dhënë kontribute të drejtpërdrejta me shkrim, ndërsa OSHC-të e tjera kanë dhënë komente dhe sugjerime për raportin gjatë takimeve direkte dhe virtuale. Hulumtimi i literaturës ka përfshirë shqyrtimin dhe mbledhjen e të dhënave nga dokumentet relevante për të drejtat e njeriut, Kushtetutës dhe legjislacionit të Kosovës, dokumentet zyrtare dhe raportet nga institucionet e Kosovës si Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), raportet e organizatave ndërkombëtare dhe të ambasadave të huaja që veprojnë në Kosovë, botimet dhe raportet nga OSHC-të si dhe raportet mediale.

**5.** Procesi i konsultimit ka përfshirë korrespondencën me email si dhe disa disa takime konsultative me mbi 34 OSHC të Kosovës që punojnë në fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut. Takimi i parë konsultativ u mbajt online në nëntor 2020, pasuar nga një takim tjetër virtual i hartimit dhe mentorimit që u organizua të njëjtin muaj. Pasi raundi i parë i komenteve ishte mbledhur nga OSHC-të kontribuese, një takim tjetër me prani fizike u organizua në shkurt 2021, ku organizatat patën mundësi të punojnë bashkërisht në draftin e parë të raportit. Gjatë këtij takimi, u krijua një komitet redaktues me qëllim të përfshirjes të sa më shumë OSHC-ve në procesin e redaktimit të raportit. Komiteti përbëhej nga përfaqësues të pesë OSHC-ve, përkatësisht, Advancing Together, Balkan Sunflowers Kosova, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, Programi për të Drejtat Civile në Kosovë dhe Qendra për Ndhimën Juridike dhe Zhvillimin Regjional. Në prill 2020 një draft final i raportit u dërgua te të gjitha OSHC-të kontribuese, në mënyrë që të të shqyrtojnë draftin e raportit, të vërtetojnë gjetjet dhe konkluzionet e tij, dhe të japin komentet dhe sugjerimet e tyre, të cilat më pas u përfshinë në raport. Procesi i hartimit dhe redaktimit të raportit u lehtësua nga z. Hilmi Jashari, Ekspert i të Drejtave të Njeriut dhe ish Avokat i Popullit në Kosovë dhe znj. Marigona Shabiu, Drejtore Ekzekutive e Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë.

**6.** Për këtë raport kontribuan 34 OSHC-të e mëposhtme: Advancing Together (AT), Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Qendra për Ndhimë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD), Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD), Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), Diakonie Mitrovica, Lëvizja FOL, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Handikos, Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK), Integra, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), Qendra Kosovare për Rehabilitim e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (KGSC), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), Avokatët e Rinj të Kosovës (KYL), Medica Gjakova, Qendra Burimore për Persona të Zhdukur (QBPZH), Nisma e Re Sociale (NSI), OJQ AKTIV, OJQ THY, Qendra e Partnerëve për Menaxhimin e Konflikeve, Romët në Veprim, Roma Versitas, Banimi Social dhe të drejtat pronësore në Kosovë (SHPRK), Terre des Hommes Kosovo, Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VORAE), dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS).

### 3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

**7.** Kushtetuta e Kosovës përmban shumë dispozita në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut.<sup>2</sup> Neni 3 i Kushtetutës deklaron se autoritetet publike në Kosovë sigurojnë barazinë e të gjithë individëve para ligjit dhe respektimin e plotë të “të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht”, Neni 7 përcakton që rendi kushtetues i Kosovës bazohet, mes tjerash, në parimet e barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mosdiskriminimit, dhe mishëron barazinë gjinore si vlerë themelore.

**8.** Kapitulli II i Kushtetutës përcakton dispozita specifike që mbrojnë të drejtat civile dhe politike (p.sh., të drejtat për proces të rregullt gjyqësor, e drejta e privatësisë dhe liria e shprehjes, liria e tubimit paqësor, liria e asociimit dhe liria e lëvizjes), si dhe disa të drejta ekonomike, shoqërore dhe kulturore (p.sh., e drejta për arsim dhe liria e zgjedhjes së profesionit). Është e rëndësishme të ceket që neni 53 kërkon që çdo interpretim i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës të bëhet në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**9.** Edhe pse Kosova nuk mund të bëhet zyrtarisht palë në konventat dhe mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, neni 22 i Kushtetutës përcakton që tetë instrumente të të drejtave të njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KB)<sup>3</sup> dhe rajonale<sup>4</sup> zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, duke ofruar kështu burime plotësuese ligjore që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut në Kosovë. Në një zhvillim të rëndësishëm për të drejtat e grave dhe vajzave, Kuvendi i Kosovës (KK) ndryshoi nenin 22 duke shtuar Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në listën e instrumenteve të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në shtator 2020.<sup>5</sup> Çështje e rëndësishme, të gjitha këto instrumente të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt kanë përparësi ndaj legjislacionit të Kosovës ose akteve të tjera të institucioneve publike në rast konflikti. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (IPNDESHK), megjithatë,

2 Shih përgjithësisht, [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#) (9 prill 2008), e ndryshuar më 25 Shtator 2020 (në tekstin e mëtejshëm Kushtetuta e Kosovës)

3 Domethënë, [Deklarata Univerale e të Drejtave të Njeriut](#) (10 dhjetor 1948) (në tekstin e mëtejshëm DUDNJ); [Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike](#) (16 dhjetor 1966) 999 UNTS 171 (në tekstin e mëtejshëm PNDKP); [Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor](#) (4 janar 1969) 660 UNTS 195 (në tekstin e mëtejshëm KEGFDR); [Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave](#) (3 shtator 1981) 1249 UNTS 13 (në tekstin e mëtejshëm KEGFDG); [Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#) (2 shtator 1990) 1577 UNTS 3 (në tekstin e mëtejshëm KDF); dhe [Konventa kundër Torturës dhe Trajtitit a Ndëshkimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar](#) (26 qershor 1987) 1465 UNTS 85 (në tekstin e mëtejshëm CAT).

4 Në mënyrë specifike, [Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore](#) (4 nëntor 1950) 213 UNTS 221 (në tekstin e mëtejshëm KEDNJ); the Council of Europe, [Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare](#) (1 shkurt 1995) ETS 157 (në tekstin e mëtejshëm FCPNM); [Konventa e KE për Parandalimin dhe Duftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje](#) (11 maj 2011) CETS 210 (në tekstin e mëtejshëm Konventa e Stambollit).

5 [Amendmenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës Nr. 07-V-058](#) (25 shtator 2020).



nuk është radhitur në mesin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë. Sidoqoftë, Kuvendi i Kosovës (KK) e ka adoptuar Agjendën e vitit 2030 dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në një rezolutë unanime me 24 janar 2018, duke siguruar një pikënisje të mirë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore në Kosovë.

**10.** Në vitin 2015, Kosova bëri progres të mëtutjeshëm në përafrimin e kornizës së saj ligjore me standardet ndërkombëtare, kur miratoi pakon e ligjeve themelore për të drejtat e njeriut, gjegjësisht, Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zbatimi i plotë i tyre është thelbësor për zbatimin efektiv të kornizës së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe kërkon alokimin e resurseve të nevojshme dhe përpjekje serioze për ndërtimin e kapaciteteve. Siç theksohet në këtë raport, Kosova ka edhe ligje të tjera më specifike lidhur me mbrojtjen e të drejtave ose grupeve të caktuar të personave.

**11.** Kosova ka krijuar organe dhe mekanizma të veçantë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim (ZQM) harton politika në fushat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe kundër diskriminimit dhe mbikëqyr dhe këshillon Ministrinë në fushat e përmendura. Grupi Koordinues Ndërmintor për të Drejtat e Njeriut është një mekanizëm politik i nivelit të lartë i krijuar nga ish-Kryeministri i Kosovës në prill 2016 për të monitoruar zbatimin e politikave të të drejtave të njeriut në Kosovë, i cili e mbajti një takim në dhjetor 2020 për herë të parë që nga viti 2018. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione është një nga komisionet e përhershme të KK-së që ka mandatin për të hartuar ligje dhe për të monitoruar zbatimin e atyre ekzistuese. Megjithëse Komisioni nuk ishte parashikuar si mekanizëm individual i ankesave, ai mund të nxjerrë në pah çështjet dhe trendet e të drejtave të njeriut brenda KK-së dhe të përcjellë tutje ankesat individuale ose grupe, sipas nevojës. IAP-i është organ i pavarur kushtetues me mandatin për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga shkeljet e autoriteteve. Në përmbushjen e mandatit pesëvjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje, IAP-ja, veç tjerash, mund të pranojë ankesa, të nisë hetime, të bëjë rekomandime dhe të publikojë raporte, si dhe të avokojë për ndryshime që përmirësojnë zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

**12.** Qeverisja e Kosovës bazohet në parimet e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre<sup>6</sup> Sidoqoftë, dega ekzekutive përgjithësisht karakterizohet me mungesë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies, ndërsa KK shpesh nuk është në gjendje të ushtrojë kontrollin e duhur parlamentar mbi degët ekzekutive dhe gjyqësore. Indeksi i Sundimit të Ligjit i Projektit Botëror të Drejtësisë për vitin 2020 e ka renditur Kosovën në përgjithësi të 54-ën nga 128 vendet dhe territoret e përfshira në vlerësim.<sup>7</sup> Në indeks, Kosova renditet në vendin e 71-të nga 128 vende në faktorin

6 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 4.

7 Projekti Botëror i Drejtësisë, '2020 Indeksi i Sundimit të Ligjit: Kosovë', qasja e fundit 27 prill 2021.



“kufizimet e pushtetit të qeverisë”, i cili përfshin tregues siç janë nëse kompetencat qeveritare janë të kufizuara në mënyrë efektive nga (1) legjislatura; (2) gjyqësori; dhe (3) auditimi dhe kontrolli i pavarur, etj.<sup>8</sup> Kosova gjithashtu renditet në vendin e 97-të nga 128 vende në faktorin «zbatimi i detyruar rregullator», i cili përmban tregues të tillë si, nëse (1) rregulloret e qeverisë zbatohen në mënyrë efektive; (2) rregulloret e qeverisë aplikohen dhe zbatohen pa ndikim të papërshtatshëm; dhe (3) procedurat administrative zhvillohen pa vonesa të paarsyeshme, etj.<sup>9</sup>

## 4. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I NDIKIMT TË COVID-19 NË TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

**13.** Si përgjigje ndaj rasteve të para të raportuara të COVID-19 në Kosovë në muajin mars, Qeveria e Kosovës (QK) zbatoi me shpejtësi masa të rrepta fillestare për të kontrolluar pandeminë të cilat më pas u hoqën, u rivendosen dhe/ose u modifikuan në disa raste, për të qenë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe për t’iu përgjigjur situatës epidemike që zhvillohej. Pasi qeveria nuk e shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në vitin 2020 e cila do ta kishte lejuar atë të shmangte disa, por jo të gjitha, të drejta të njeriut në Kosovë,<sup>10</sup> masat COVID-19 që kufizuan të drejtat e njeriut vlenin vetëm në atë masë sa ato ishin (1) të parashikuara me ligj; (2) kishin një qëllim legjitim (p.sh., mbrojtja e shëndetit publik); dhe (3) ishin të domosdoshme dhe proporcionale për arritjen e një qëllimi legjitim.<sup>11</sup> Lidhur me këtë, më 31 mars, Gjykata Kushtetuese shpalli antikushtetuese orën policore dhe kufizimet e tubimeve private dhe publike me arsyetimin se masat për mbarë Kosovën nuk ishin “të parapara me ligj” dhe kështu shkelnin lirinë e lëvizjes, lirinë e tubimit paqësor, lirinë e asociimit dhe të drejtën e privatësisë. Ky vendim bëri që Ministria e Shëndetësisë të miratojë më pastaj masa specifike për komuna duke filluar nga 14 prilli 2020. Në gusht, hyri në fuqi Ligji Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Kosovë, duke forcuar bazën ligjore për Ministrinë e Shëndetësisë për kufizimin e të drejtave të njeriut për aq kohë sa është e nevojshme për të luftuar dhe parandaluar përhapjen e COVID-19 dhe për shqiptimin e gjobave njerëzve për mosrespektimin e masave COVID-19.<sup>12</sup>

**14.** Me kusht që ato të paraqesin kufizime valide të të drejtave të njeriut, masat e qeverisë mund të konsiderohen se i përmbushin detyrimet e saj pozitive për të treguar kujdesin e duhur sipas të

8 Po aty.

9 Po aty.

10 Shih Kushtetutën e Kosovës, shënimi 2, neni 56. Të drejtat e njeriut nga të cilat nuk mund të shmangen përfshijnë, ndër të tjera, e drejta për jetën dhe ndalimin e torturës ose trajtimit tjetër mizor, çnjerëzor dhe poshtëruese.

11 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 55.

12 [Ligji Nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Kosovë](#) (25 gusht 2020).

drejtave për jetën dhe shëndetin për të parandaluar, ndaluar ose në të paktën zbutur përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme për jetën si COVID-19.<sup>13</sup> Masat e ndërmarra në vitin 2020 për të kontrolluar pandeminë COVID-19 në Kosovë përfshinin, ndër të tjera, vendosjen e orarit rotativ të lëvizjes, orën policore dhe futjen në karantinë të komunave të cilat kufizonin lëvizjen; kufizimin e tubimeve në më pak se pesë persona dhe ndalimin e tubimeve shoqërore dhe familjare; pezullimin e aktiviteteve fetare dhe kulturore, megjithëse aktivitetet kulturore u lejuan me kapacitete të reduktuara që nga shtatori; mbylljen e shkollave dhe sigurimin e mësimit në distancë deri në shtator 2020; mbylljen e veprimtarive jo-thelbësore të bizneseve e pasuar me kufizime të ndryshme të orarit të punës; pezullimin e linjave të udhëtimit ajror dhe tokësor, me disa përjashtime deri në qershor; dhe duke kërkuar që personat që hyjnë në Kosovë t'i nënshtrohen karantinës për 14 ditë në qendrat e caktuara për këtë qëllim të pasuar me vetë-izolim në shtëpi.

**15.** Në nëntor, qeveria filloi të aplikojë një sistem masash të COVID-19 me tri nivele, në varësi të faktit nëse komuna klasifikohet si zonë e gjelbër, e verdhë ose e kuqe në bazë të numrit të rasteve për 100,000 banorë.<sup>14</sup> Përveç vazhdimit të ndalimit të tubimeve publike me më shumë se pesë persona dhe kufizimeve specifike të lëvizjes për personat e moshuar (mbi 65 vjeç) përveç për arsye emergjente dhe mjekësore, ajo gjithashtu vendosi orën policore dhe kufizime të hyrje-daljeve nga ora 19:00 deri më 05:00 në komunat e klasifikuara si "zona të kuqe"; orar të kufizuar të punës për bizneset deri në ora 20:00 ose më herët, në varësi të klasifikimit; dhe përsëri pezulloi të gjitha ceremonitë dhe aktivitetet fetare (përveç me anëtarët e familjes së ngushtë). Që nga 31 dhjetori, masat e miratuara në nëntor mbetën kryesisht të njëjta, megjithëse fillimi i orës policore dhe kufizimet e hyrje-daljes në komunat në zonën e kuqe u zgjatën deri në orën 20:00.<sup>15</sup>

**16.** Përveç kufizimit të lirisë së lëvizjes, tubimeve paqësore dhe fetare, pandemia dhe masat për ta kontrolluar atë ndikuan në mënyrë të konsiderueshme në ushtrimin e një game të gjerë të të drejtave të tjera civile dhe politike, si dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë. Përkeqësimi i situatës epidemiologjike në korrik dhe gusht dhe pastaj përsëri në tetor dhe nëntor, paraqiti implikime serioze për të drejtat për jetën dhe shëndetin, veçanërisht duke marrë parasysh raportimet lidhur me testimin e kufizuar dhe selektiv për COVID-19, punëtorët shëndetësorë të infektuar, spitale të mbingarkuara, pajisje mjekësore të pamjaftueshme dhe çmime të larta të ilaçeve për COVID-19. Deri më 31 dhjetor kishte 51,328 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe 1,335 raste të vdekjes sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).

**17.** Arrestimet e më shumë se 1,000 personave për mosrespektim të masave fillestare COVID-19 që më vonë u shpallën antikushtetuese ngritën implikime për të drejtën e lirisë dhe sigurinë e personit, megjithëse arrestimet nuk çuan në ndjekje penale. Derisa punonjësit e mediave u përjashtuan nga kufizimet në lirinë e lëvizjes gjatë kohës që ishin në detyrë, çështje të tjera, siç ishte mungesa e pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) për të marrë pjesë dhe për të raportuar

13 Komiteti i KB-aë për të Drejtat e Njeriut, Komenti i Përgjithshëm Nr. 36 mbi Nenin 6: E Drejta për Jetë' (3 shtator 2019) [UN Doc. CCPR/C/GC/36](#), paragrafi 26; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 'Komenti i Përgjithshëm Nr. 14: E Drejta për një Standard më të Lartë të Arritshëm të Shëndetit (Neni 12)' (11 gusht 2020) [UN Doc. E/C.12/2000/4](#), paragrafët 16, 44.

14 [Vendimi i QK Nr. 01/42](#) (11 nëntor 2020).

15 [Vendimi i QK Nr. 01/51](#) (22 dhjetor 2020).

mbi ngjarjet zyrtare, penguan lirinë e mediave. Pandemia gjithashtu përkeqësoi problemet që kanë ekzistuar përpara lidhur me të drejtat gjuhësore dhe të drejtën e informimit për komunitetet joshqiptare dhe personave me aftësi të kufizuara. Për më tepër, mediat publikuan, në disa raste, të dhëna personale të pacientëve me COVID-19 në shkelje të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të drejtën e privatësisë. Gjykatat e Kosovës punuan me kapacitet të kufizuar ndërsa iu dhanë përparësi çështjeve urgjente (p.sh., çështjeve që kanë të bëjnë me paraburgime dhe dhunë në familje) në pjesën më të madhe të vitit 2020, duke ngritur shqetësime për të drejtën e mjeteve juridike dhe të drejtën për gjykim të drejtë në raste jo-prioritare. Vendimi për të shtyrë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut deri më 29 nëntor preku të drejtat për të marrë pjesë në çështjet publike dhe votim, ndërsa mbajtja e zgjedhjeve në mes të pandemisë gjithashtu kërkoi një balancim të kujdesshëm me të drejtat për jetën dhe shëndetin.

**18.** Pandemia dhe masat e mbajtjes nën kontroll të COVID-19 gjithashtu ndikuan negativisht në ushtrimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë, veçanërisht të drejtave për një standard të duhur të jetesës, sigurisë dhe shëndetit në punë, arsim dhe pjesëmarrje në jetën kulturore. Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar që aktiviteti ekonomik në Kosovë kishte një rënie prej gjashtë për qind në vitin 2020 për shkak të pandemisë,<sup>16</sup> e cila rezultoi, ndër të tjera, me humbjen e raportuar të vendeve të punës së më shumë se 50,000 njerëzve, mbyllje të bizneseve dhe rritje e numrit të personave dhe familjeve në skemat e ndihmës sociale. Institucionet e Kosovës kanë miratuar dhe zbatuar disa pako dhe masa të rimëkëmbjes ekonomike për të zbutur disa nga ndikimet socio-ekonomike të pandemisë, si pakoja emergjente prej 170 milionë eurosh për rimëkëmbje ekonomike në mars, ndryshimi i buxhetit që krijoi një fond të rimëkëmbjes ekonomike prej 365 milionë eurosh në gusht, dhe Ligji Nr. 06 L-016 për Rimëkëmbje Ekonomike - COVID-19 për të siguruar lehtësira shtesë ekonomike në dhjetor.

**19.** Mbyllja e institucioneve arsimore në të gjitha nivelet dhe përdorimi vetëm i mësimin në distancë nga mesi i marsit deri në shtator ndikoi në ushtrimin e të drejtës për arsim. Me fillimin e vitit të ri akademik në shtator, shkollat fillore dhe të mesme rifilluan duke përdorur një kombinim të mësimin me prani fizike dhe atij online, ndërsa universitetet vazhduan të mbanin mësimin vetëm në distancë. Mungesa e pajisjeve teknologjike dhe/ose lidhjes së internetit, megjithatë, pamundësoi qasjen në arsim për disa pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe për personat që jetojnë në varfëri dhe personat me aftësi të kufizuara.

**20.** Masat kundër pandemisë dhe masat e ngjashme me to rezultuan në anulimin e shumicës së aktiviteteve kulturore në vitin 2020 dhe ndikuan dukshëm në ushtrimin e të drejtave kulturore, ndërsa masat e rimëkëmbjes ekonomike fillimisht nuk arritën të shenjëstrojnë mjaftueshëm krijuesit e përmbajtjeve kulturore në Kosovë. Me përjashtim të muajit maj dhe qershor kur u hoqën

16 Fondi Monetar Ndërkombëtar, "Kosova: Raporti i Stafit për Konsultimet rreth Artikulli IV" (17 shkurt 2021), f. 4.

për një kohë të shkurtër masat COVID-19, qeveria pezulloi të gjitha aktivitetet kulturore nga mesi i muajit mars deri me 25 shtator 2020, pas të cilës aktivitetet kulturore me prani fizike u lejuan me kapacitete të reduktuara.

**21.** Masat e kontrollit të pandemisë COVID-19 dhe masat e lidhura me të ndikuan në mënyrë disproporcionale në të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë dhe personave që janë në situata të cenushme. Komunitetet jo-shumicë, përfshirë serbët, u ballafaquan me sfida në rritje për të drejtën për informim, siguri personale dhe publike, dhe qasje të barabartë në shërbime, përfshirë ndihmën dhe lehtësirat ekonomike. Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian hasën në rreziqe dhe sfida të shtuara, ndër tjera edhe për shkak të qasjes së tyre të kufizuar në arsim, ujë të pastër dhe kujdes shëndetësor. Raportimi i rritjes së dhunës me bazë gjinore, përfshirë edhe dhunën në familje, si dhe mospagesa e punës së përkujdesjes për shkak të pandemisë dhe masave përkatëse ndikuan në mënyrë disproporcionale në të drejtat e grave dhe vajzave për jetë, integritet fizik dhe mendor, shëndet dhe barazi. Kriza e COVID-19 gjithashtu preku të drejtat e fëmijëve për jetë, shëndet fizik dhe mendor, siguri dhe arsimim dhe duket se ka rezultuar në rritje të dhunës ndaj fëmijëve. Personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara, po ashtu kanë përjetuar disa sfida në të drejtën e tyre për qasje në shërbimet themelore sociale, shëndetësore dhe rehabilituese, megjithëse janë aplikuar përjashtime të rëndësishme në masat që kufizojnë lëvizjen e njerëzve që kujdesen për ta.

**22.** Janë pranuar raporte të shumta se personat në gjendje të vështirë, veçanërisht të moshuarit, personat në lëvizje dhe pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, nuk kishin ushqim të mjaftueshëm, pajisje mjekësore dhe PPM, duke ndikuar kështu në ushtrimin e të drejtave të tyre për jetë, shëndet, ushqim dhe të drejta të tjera të ndërlidhura. Për shkak të rrezikut të tyre të shtuar për ndërlikime shëndetësore që lidhen me COVID-19, personat e moshuar kanë qenë subjekt i masave specifike që kufizonin lëvizjen e tyre. Njerëzit në lëvizje gjithashtu kishin mundësi të kufizuar që të aplikojnë masat e distancimit fizik në qendrat e azilit, qendrat e paraburgimit për emigrantët dhe qendrat kolektive për personat e zhvendosur brenda Kosovës. Për më tepër, kufizimet e lëvizjes përkeqësuan gjendjen e vështirë me të cilën ballafaqohen personat LGBT+ në Kosovë, ndërsa pezullimi i linjave të udhëtimit ndërkombëtar ajror dhe tokësor deri në qershor ndikoi në mënyrë disproporcionale në qasjen e personave transgjjinorë në shërbimet themelore të kujdesit shëndetësor, siç është terapia me hormone, të cilat nuk ofrohen në Kosovë.

**23.** Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) në përgjithësi e ka menaxhuar pandeminë në institucionet korrektuese të Kosovës duke miratuar dhe zbatuar një plan të veçantë operativ dhe me sukses ka kufizuar numrin e të paraburgosurve dhe të burgosurve që janë infektuar me COVID-19. Në të njëjtën kohë, pezullimi i vazhdueshëm i vizitave nga anëtarët e familjes, avokatët dhe organizatat monitoruese si dhe çështjet që pengojnë mundësinë e masave alternative të paraburgimit ngritën disa shqetësime.

## 5. SEKSIONI A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

### 5.1. E drejta për trajtim njerëzor dhe ndalimi i torturës

**24.** Kushtetuta e Kosovës e ndalon torturën, trajtimin a ndëshkimin mizor, çnjerëzor ose poshtërues.<sup>17</sup> Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit të Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (CAT) dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) gjithashtu ndalojnë veprime të tilla dhe zbatohen drejtpërdrejt dhe, në rast të konfliktit, kanë epërsi ndaj legjislacionit të Kosovës.<sup>18</sup> Obligimi për të interpretuar dispozitat e Kushtetutës në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>19</sup> parashikon gjithashtu obligimin për të hetuar akuzat për torturë, trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Kodi Penal i Kosovës e bën torturën vepër penale,<sup>20</sup> ndërsa Kodi i Procedurës Penale ndalon imponimin për pranimin e fajit,<sup>21</sup> në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kodi Penal gjithashtu e bën vepër penale keqtrajtimin, frikësimin ose fyerjen e rëndë nga ana e personit në një pozitë me autoritetit.<sup>22</sup> Trajtimi a ndëshkimi tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, megjithatë, ende nuk është bërë vepër penale në të njëjtat mënyrë si tortura, pavarësisht rekomandimit të Raportuesit Special të KB-së për torturën dhe trajtimet a ndëshkimet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (Raportuesi Special për torturë), për ta bërë këtë gjatë vizitës së tij në Kosovë në vitin 2017.<sup>23</sup> Raportuesi Special gjithashtu kishte rekomanduar që Kosova të përjashtojë shprehimisht pranueshmërinë e provave të marra përmes torturës ose trajtimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues.<sup>24</sup>

**25.** Në përputhje me kërkesat e Neneve 1 dhe 3 të Protokollit Opsional të CAT (OP-CAT) dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit,<sup>25</sup> Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Parandalues Kombëtar (MPK) kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Në vitin 2020, MPK kreu gjithsej 52 vizita ad hoc në vendet ku gjendeshin personat e privuar nga liria.<sup>26</sup> Gjatë periudhës raportuese, IAP-ja kishte iniciuar hetimet për pesë raste të pretenduara të keqtrajtit nga ana e Policisë së Kosovës, ndërsa në një rast është kërkuar që Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) të nis një hetim sipas mandatit të tij.<sup>27</sup> Rastet ishin nën hetim gjatë kohës së hartimit

17 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 27.

18 Po aty., neni 22. Shih gjithashtu CAT, nenet 1-2, 4; KEDNJ, neni 3.

19 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 53.

20 [Kodi Penal i Kosovës Nr. 06/L-074](#) (14 janar 2019), neni 196 (në tekstin e mëtejshëm Kodi Penal).

21 [Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale](#) (28 dhjetor 2012), neni 10 (në tekstin e mëtejshëm Kodi i Procedurës Penale).

22 Kodi penal, shënimi 20, neni 195.

23 Raportuesi Special për torturën dhe trajtimin a ndëshkimin tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, 'Raport për Vizitën në Serbi dhe Kosovë nga 13 deri më 24 nëntor 2017' (25 janar 2019) [Dokument i KB A/HCR/40/59/Add.1](#), paragrafi 109.

24 Po aty.

25 [Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit](#) (26 qershor 2015), neni 17.

26 IAP, 'Raport Vjetor 2020 Nr. 20' (14 prill 2021), f. 101 (në tekstin e mëtejshëm 2020 Raporti i IAP-së).

27 Po aty, f. 103.

të këtij punimi. Në vitin 2020, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KPT) vizitoi Kosovën nga 6 deri më 16 tetor, dhe gjetjet e tij paraprake iu komunikuan autoriteteve përkatëse.

**26.** Autoritetet e Kosovës kanë vazhduar të tregojnë përkushtim për të respektuar përgjithësisht të drejtën për trajtimin njerëzor dhe ndalimin e torturës. Në vitin 2020, QKRMT ka kryer tetë vizita në qendrat e paraburgimit dhe nuk ka marrë asnjë raport të torturës. Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së për vitin 2020, megjithatë, përmend dy raste të izoluar të keqtrajtimit.<sup>28</sup> Sipas raportit vjetor të MPK-së për vitin 2020, më nuk po ndodhin incidente në mes të të burgosurve nuk në qendrat e ndalimit në Kosovë.<sup>29</sup>

**27.** Mos adresimi i duhur i nevojave specifike të grupeve dhe personave në gjendje të cënueshme në vendet e ndalimit (p.sh., gratë, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, personat me sëmundje kronike dhe aftësi të kufizuara mendore dhe personat LGBT+), hetimet joefikase dhe mosdhënia e përparësisë në procedimin e lëndëve për këto raste nga autoritetet kosovare, megjithatë, kanë vazhduar të ngrehin shqetësime edhe në vitin 2020.

**28.** Marrja në pyetje dhe hetimet policore gjithashtu vazhdojnë të jenë jashtë fushëveprimit të mekanizmave të monitorimit. Ankesat për keqtrajtim gjatë marrjes në pyetje dhe hetimeve policore theksojnë edhe më shumë nevojën për forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes në Policinë e Kosovës. Pas rekomandimeve të KPT-së, Policia e Kosovës ka filluar instalimin e kamerave për të miturit në stacionet policore, ndërsa është planifikuar të instalohen kamerat e sigurisë në të gjitha stacionet dhe dhomat e intervistave deri në fund të vitit 2021.

**29.** Gjatë vitit 2020, IPK-ja ka pranuar 15 për qind më shumë ankesa se në vitin 2019.<sup>30</sup> Nga 1,658 ankesa, 35 për qind janë dërguar për hetime penale në Departamentin e Hetimeve, ndërsa 65 për qind e tyre u proceduan si çështje disiplinore nga Divizioni i Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimi i të Kaluarës brenda Policisë së Kosovës. Në vitin 2020, janë bërë kallëzime penale në 82 raste të hetuara nga IPK-ja. Nga këto 82 raste, 23 kishin të bënin me keqtrajtim dhe nëntë kishin të bënin me dhunë në familje.<sup>31</sup>

**30.** Raportimi i QKRMT-së tregon se kushtet materiale dhe të strehimit në institucionet korrektuese në Kosovë janë relativisht të mira.<sup>32</sup> Ka pasur gjithashtu përmirësime në kushtet e strehimit për shkak të rinovimeve dhe funksionalizimit të objekteve të reja, sikurse që është rasti me qendrën e ndalimit në Prishtinë. Në të njëjtën kohë, kushtet e strehimit në disa prej institucioneve korrektuese vazhdojnë të jenë sfiduese, për shembull në disa pjesë të qendrës korrektuese në Dubravë dhe në qendrën e paraburgimit në Pejë.

28 Departamenti i Shtetit të SHBA, 'Raporti i vitit 2020 për të Drejtat e Njeriut në Kosovë' (30 mars 2021), f. 5 (në tekstin e mëtejshëm Departamenti i Shtetit të SHBA-së, Raporti për të Drejtat e Njeriut 2020).

29 2020 Raporti i IAP -së, shënimi 26, f. 107.

30 IPK, 'Raporti Vjetor 2020' (2020), ff. 6, 9.

31 Po aty., f. 19.

32 QKRMT, 'Të Drejtat e Njeriut në Institucionet Korrektuese të Kosovës. Raporti i Monitorimit 2019 - 2020' (dhjetor 2020), f. 30 (në tekstin e mëtejshëm QKRMT 2019 - 2020 Raporti i Monitorimit).



**31.** Çështja e vendosjes dhe trajtimit të personave të ndaluar, përfshirë të paraburgosurit, që kanë probleme të shëndetit mendor nuk është adresuar ende nga autoritetet përkatëse, siç është Ministria e Drejtësisë (dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës si agjenci e saj) dhe Ministria e Shëndetësisë (dhe Njësia Shëndetësore e Burgjeve në kuadër të saj). Personat e ndaluar me probleme të shëndetit mendor ende mbahen në qendrat e paraburgimit ose qendrat korrektuese në pritje të vendimit nga gjykata ose edhe pas përfundimit të gjykimit. Sidoqoftë, infrastruktura, shërbimet dhe trajtimet nuk u janë përshtatur si duhet nevojave dhe kërkesave specifike të tyre, në kundërshtim me kornizën ligjore të Kosovës dhe instrumentet e të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt. Bazuar në vlerësimin e QKRMT-së, trajtimi i të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor në Kosovë konsiderohet të jetë në kundërshtim me parimet e trajtimit me dinjitet të personave të privuar nga liria.

**32.** Në vitin 2020, një nga sfidat kryesore për SHKK-në ishte menaxhimi i pandemisë dhe parandalimi i përhapjes së COVID-19 në qendrat e mbajtjes. Bazuar në vlerësimin e QKRMT-së, SHKK-ja dhe Njësia Shëndetësore e Burgjeve, në përgjithësi, kanë menaxhuar me sukses situatën. Numri i të burgosurve të infektuar me COVID-19 mbeti shumë i ulët. Sigurimi i produkteve higjienike dhe masave mbrojtëse për të paraburgosurit dhe personelin u siguroi, ndërsa furnizimi me maska për fytyrë ka qenë i kënaqshëm. Maska janë prodhuar edhe nga të dënuarit në qendrën korrektuese në Lipjan. QKRMT-ja përgatiti një raport mbi menaxhimin e pandemisë COVID-19 nga SHKK-ja,<sup>33</sup> dhe rekomandimet përkatëse u ndanë me SHKK-në dhe Departamentin Shëndetësor të Burgjeve.

**33.** Ndonëse ka zotime verbale për të adresuar rekomandimet e Raportuesit Special për torturën, institucionet përkatëse, si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), ende nuk kanë vepruar dhe nuk kanë zbatuar këto rekomandime. Këto rekomandime përfshijnë krijimin e programeve sistematike të trajnimit për Protokollin e Stambollit për profesionistët shëndetësorë që ekzaminojnë personat e privuar nga liria, si dhe për avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët me qëllim të forcimit të aftësive të tyre për të identifikuar dhe dokumentuar torturën dhe format e tjera të keqtrajtimit.

#### **34. Rekomandimet:**

- Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, KGJK-ja dhe SHKK-ja duhet të veprojnë në përputhje me rekomandimet e MPK-së.
- Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, KGJK-ja dhe SHKK-ja duhet të zbatojnë rekomandimet e Raportuesit Special për torturën.
- Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, KGJK-ja dhe SHKK-ja duhet të adresojnë dhe të veprojnë në përputhje me rekomandimet paraprake të KPT-së.<sup>34</sup>

<sup>33</sup> Po aty., ff. 51-67.

<sup>34</sup> KPT, 'Komiteti Anti-torturë i Këshillit të Evropës Viziton Kosovën\*' (20 tetor 2020).



## 5.2. E drejta për liri dhe siguri të personit

**35.** Kushtetuta e Kosovës i garanton të gjithëve të drejtën për liri dhe siguri.<sup>35</sup> Kodi i Procedurës Penale<sup>36</sup> dhe instrumentet e të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt<sup>37</sup> krijojnë një kornizë të fuqishme ligjore për të mbrojtur njerëzit nga arrestimi ose ndalimi arbitrar. Kushtetuta përcakton që kushdo që privohet nga liria, do të informohet menjëherë për arsyet e privimit të tyre në një gjuhë që e kuptojnë dhe do të dal para një gjykatësi brenda 48 orëve.<sup>38</sup> Ai parashikon gjithashtu të drejtën e kompensimit për të gjithë të arrestuarit ose të ndaluarit në kundërshtim me garancitë e përcaktuara nga Kushtetuta.<sup>39</sup>

**36.** Përdorimi dhe kohëzgjatja e tepërt e paraburgimit, megjithatë, ka vazhduar në Kosovë në vitin 2020. E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashikon që paraburgimi duhet të urdhërohet vetëm kur është i arsyeshëm dhe i nevojshëm, si dhe kur masat e tjera të kufizimit konsiderohen të pamjaftueshme. Ai duhet të jetë përjashtim, e jo rregull.<sup>40</sup> Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale janë kryesisht në përputhje me këtë standard, pasi ato përcaktojnë se paraburgimi mund të aplikohet vetëm kur masat e tjera të kufizimit janë të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të pandehurit në gjykim, për të parandaluar përsëritjen e veprës ose për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale.<sup>41</sup> Sidoqoftë, monitorimi i QKRMT-së tregon se paraburgimi po përdoret në mënyrë të tepruar në Kosovë, shpesh pa i kushtuar vëmendje e duhur rrethanave të rastit. Sipas QKRMT-së, rreth 70 për qind e të ndaluarve në Kosovë, përfshirë të paraburgosurit, nuk kanë një vendim përfundimtar të gjykatës.<sup>42</sup> Që nga viti 2015, QKRMT-ja ka dorëzuar rreth 50 parashtresa në gjykata të ndryshme në Kosovë duke ngritur shqetësime në lidhje me praktikën e urdhërimit dhe zgjatjes së paraburgimit, e cila, sipas mendimit të saj, ka rezultuar në "paraburgim të stërzgatur dhe vetëm sipërfaqësisht të justifikuar".<sup>43</sup> Situatën e përkeqësojnë më tej vonesat në procedurat gjyqësore të shkallës së parë dhe një numër i konsiderueshëm i rasteve që po kthehen për rigjykim nga Gjykata e Apelit.<sup>44</sup> Kosova ende nuk ka krijuar një mjet juridik efektiv, përfshirë kompensimin, për të adresuar një ndërhyrje të tillë në të drejtën për liri dhe siguri.<sup>45</sup>

**37.** Në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në një rast që kishte të bënte me disa aspekte të së drejtës për liri dhe siguri të personit, vlerësoi se zgjatja e paraburgimit pa shqyrtim të vazhdueshëm dhe të individualizuar të rrethanave ishte shkelje e të drejtës për liri dhe siguri të personit. Sidoqoftë, mbetet të shihet nëse gjykatat e Kosovës do ta zbatojnë me konsekuencë

35 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 29.

36 Kodi i Procedurës Penale, shënimi 21, nenet 10, 12-13.

37 DUDNJ, nenet 3, 9; PNDPC nenet 9-10; KEDNJ, neni 5.

38 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 29.

39 Po aty.; shih gjithashtu Kodin e Procedurës Penale, shënimi 21, neni 15.

40 PNDPC, neni 9(3); Këshilli i KB për të Drejtat e Njeriut, 'Kommenti i përgjithshëm Nr. 35: neni 9 (Liria dhe Siguria e Personit)' (16 dhjetor 2014) [UN Doc. CCPR/C/GC/35](#), paragrafët 11-12, 38.

41 Kodi i Procedurës Penale, shënimi 21, neni 187.

42 QKRMT, Raporti Monitorues 2019 – 2020 shënimi 32, f. 48.

43 Po aty.

44 Komisioni Evropian, '[Kosova\\* Raporti 2020](#)' (6 tetor 2020), f. 22 (në tekstin e mëtejshëm 2020 KE Raporti i Progresit).

45 Po aty.

këtë standard të ri, i cili kërkon që gjyqtarët të bëjnë një vlerësim të individualizuar të të gjitha rrethanave përkatëse në secilën rast.

**38.** Masat për të mbajtur nën kontroll COVID-19 gjithashtu kanë ndikuar në ushtrimin e të drejtës për liri dhe siguri në Kosovë. Sipas ish-Avokatit të Popullit, më shumë se 1.000 persona janë arrestuar në fazat e hershme të pandemisë për mosrespektim të masave për parandalimin e COVID-19.<sup>46</sup> Disa prej tyre u arrestuan për shkelje të orës policore të aplikuar në fillim ose ndalimit të tubimeve publike dhe private, që të dyja të cilësuar si jo kushtetuese më 31 mars. Më 20 gusht, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që njerëzit që janë arrestuar për mosrespektim të masave kundër COVID-19 që u aplikuan në mars nuk do të akuzohen ose ndiqen penalisht.<sup>47</sup> Sipas vendimit, një ndjekje e tillë do të ishte e mundur vetëm nëse do të kishte vendime që trajtonin individë të veçantë për atë që ata mund ose nuk mund të bëjnë. Të arrestuarit pa bazë të mjaftueshme ligjore nuk morën asnjë kompensim përkundër avokimit nga ish-Avokati i Popullit.<sup>48</sup> Në fazat e hershme të pandemisë, ish-Avokati i Popullit gjithashtu bëri thirrje për zbatimin e masave alternative të kufizimit kur ishte e mundur, por nuk u përkrah.<sup>49</sup> Komisioni i KK-së për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Zhdukur dhe Peticionet shqyrtoi mundësinë e ndryshimit të legjislacionit përkatës për të lejuar lirinë e parakohshëm të të burgosurve për shkak të COVID-19 por në fund erdhi në përfundimin se kjo ishte jashtë fushëveprimit të mandatit të tij.

**39.** Në gusht, Grupi i Punës për Ndalimin Arbitrar (GPNA) nxori një opinion për rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve Turq në mars të vitit 2018 për shkak të lidhjeve të tyre të pretenduara me lëvizjen Hizmet/Gülen.<sup>50</sup> GPNA-ja konstatoi se privimi i lirisë së këtyre gjashtë individëve nga autoritetet e Prishtinës ishte arbitrar dhe se nuk kishte asnjë bazë ligjore që justifikonte privimin e tillë të lirisë dhe largimin nga Kosova. GPNA-ja vuri në dukje se arrestimi dhe ndalimi i këtyre gjashtë individëve ka rezultuar nga ushtrimi i të drejtave të tyre për lirinë e mendimit dhe shprehjes dhe kërkoi nga autoritetet në Prishtinë dhe Ankara që të sigurojnë, ndër të tjera, një hetim të plotë dhe të pavarur të çështjes dhe t'u akordojë gjashtë shtetasve turq një të drejtë të zbatueshme për kompensim dhe reparacione të tjera.<sup>51</sup> Në vitin 2020, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) vazhdoi hetimin e rastit. Vlen të përkujtohet se ky rast tashmë ishte shqyrtuar nga institucione të ndryshme në Prishtinë. IAP-ja nxori një raport ex officio në prill të vitit 2018, ndërsa KK miratoi një raport<sup>52</sup> në qershor të vitit 2019, duke përmendur 31 shkelje të ligjit dhe procedurave, përfshirë shkelje të pretenduara të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), nga autoritetet e

46 Policia e Kosovës, 'Policimi në kohën e Pandemisë: Raporti i Gjashtë (6) Mujorit të Punës së Policisë së Kosovës' (shtator 2020), f. 4.

47 Gjykata Supreme e Kosovës, 'Miratohet Mendimi Juridik lidhur me veprën penale – Mosveprimi sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë' (20 gusht 2020).

48 RTK Live, 'Kërkohet Dëshmipërblim për Qytetarët që u Arrestuan gjatë Epidemisë' (rtklive.com, 1 qershor 2020).

49 IAP, 'Njoftimi për shtyp' (20 prill 2020).

50 Në Mars të vitit 2018, gjashtë shtetas turq u arrestuan nga autoritetet e Kosovës dhe u dëbuan në Turqi për lidhjet e tyre të pretenduara me lëvizjen Hizmet/Gülen. Ata u akuzuan për "spiunazh ndërkombëtar" dhe "drejtimin e një organizate të armatosur terroriste".

51 GPNA, 'Opinionet e miratuara nga Grupi i Punës mbi Ndalimin Arbitrar në seancën e tetëdhjetë e tetë, 24–28 gusht 2020' (25 shtator 2020) UN Doc. A/HRC/WGAD/2020/47, paragrafët 103-106 (në tekstin e mëtejshëm Opinion i GPNA -së).

52 Departamenti i Shtetit të SHBA-së, 'Raporti i vitit 2019 për të Drejtat e Njeriut në Kosovë' (shkurt 2020), f. 16.

Prishtinës. Ndërkohë, të paktën tre prej këtyre gjashtë shtetas turq janë dënuar në Turqi me shtatë deri në tetë vjet burgim për “pjesëmarrje në një organizatë të armatosur terroriste.”<sup>53</sup>

#### 40. Rekomandimet:

- KGJK, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të respektojë udhëzimet në lidhje me aplikimin e paraburgimit të përcaktuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të 8 tetorit 2019.
- Gjykatat e Kosovës duhet të trajtojnë paraburgimin si masë e kufizimit që duhet të zbatohet vetëm kur është absolutisht e nevojshme sipas kornizës ligjore në fuqi.
- QK dhe KK duhet të krijojnë një mjet juridik efektiv për të adresuar rastet e privimit arbitrar nga liria që rezultojnë nga procedurat e tejzgjatura gjyqësore dhe përdorimi i tepërt i paraburgimit.

### 5.3. E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjet juridik efektiv

**41.** Kushtetuta e Kosovës u garanton të gjithëve të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm,<sup>54</sup> ndërsa Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat përcakton se “të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”<sup>55</sup>

Kushtetuta parashikon gjithashtu që çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë ose me ligj.<sup>56</sup> PNDKP dhe KEDNJ, të cilat gjithashtu garantojnë të drejtën për proces të drejtë gjyqësor, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë dhe kanë përparësi ndaj legjislacionit të Kosovës në rast konflikti.<sup>57</sup> Në të njëjtën kohë, sipas analizës së IKD-së, nga 209 aktgjykime të të gjitha gjykatave në Kosovë, vetëm 20 aktgjykime gjyqësore (ose 9.56 për qind) iu referuan qartë KEDNJ-së.<sup>58</sup>

**42.** Pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, KGJK-ja mori një vendim më 15 mars për të reduktuar të gjitha aktivitetet e gjykatave të Kosovës vetëm në raste urgjente, si ato që përfshijnë paraburgimin ose masa të tjera kufizuese dhe rastet e dhunës në familje. Rifillim i shkurtër i punës së rregullt në qershor u pasua shpejt me një reduktim tjetër të aktiviteteve në korrik dhe prioritizim të rasteve të kategorive të lartpërmendura. Mediat dhe monitoruesit e gjykatave janë lejuar të marrin pjesë në procedurat gjyqësore vetëm sipas diskrecionit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve, gjë që ngriti shqetësime në lidhje me transparencën e procedurave. Seanca e parë gjyqësore online në Kosovë u mbajt në një rast civil në Gjykatën Themelore të Prizrenit vetëm në shtator 2020.<sup>59</sup>

**43.** Sipas IKD-së, grumbullimi i lëndëve administrative, civile dhe penale u rrit gjatë pandemisë. Gjatë vitit 2019, Departamenti për Çështje Administrative kishte 9,244 lëndë administrative në pritje nga të cilat 2,929 (ose rreth 32 për qind) u zgjidhën, ndërsa 6,315 lëndë (ose rreth 68 për

53 Opinion i GPNA-së, shënimi 51, paragrafët 47, 49, 53.

54 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 31.

55 [Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat](#) (18 dhjetor 2018), neni 7(5).

56 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 54.

57 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 22. Shih gjithashtu PNDKP, neni 14; KEDNJ, neni 6.

58 IKD, ‘[Praktika e GJEDNJ-së, obligim në letër](#)’ (25 shtator 2020).

59 Marcel Lekaj, ‘[FOTO - Gjykata e Prizrenit mban seancën e parë online](#)’ (kallxo.com, 2 shtator 2020).

qind) mbetën në pritje. Në vitin 2020, sipas statistikave të ofruara nga gjykatat, nga 8,285 lëndë që departamenti i kishte të pazgjidhura, vetëm 1,947 lëndë (ose 23,50 për qind) u zgjidhën. Një rritje edhe më e madhe është shënuar në grumbullimi i rasteve civile dhe penale. Në vitin 2019, 4,739 lëndë penale ishin në pritje nga të cilat vetëm 1,630 lëndë (ose 34 për qind) u zgjidhën. Në vitin 2020, nga 5,791 lëndë në pritje, vetëm 1,808 lëndë (ose 31.22 për qind) u zgjidhën.

**44.** Lidhur me procedurat civile, gjetjet e IKD-së tregojnë se kohëzgjatja mesatare e procedurës në gjykatat e shkallës së parë është 1,513 ditë dhe 1,288 ditë në gjykatat e shkallës së dytë. Kohëzgjatja mesatare e një lënde që shqyrtohet nga të dy instancat është, pra, 2,801 ditë ose rreth shtatë vjet e tetë muaj. Kosova ende nuk ka krijuar një mjet juridik efektiv, përfshirë kompensimin, për të trajtuar vonesat në procedurat gjyqësore.

**45.** Në vitin 2020, të paktën tre anëtarë të KPK-së dhanë dorëheqje për të aplikuar për pozitat e drejtuesve të disa prokurorive dhe më pas u zgjodhën. Kjo praktikë, e cila vazhdoi përgjatë viteve, është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik<sup>60</sup> dhe u kritikua nga Ambasada Amerikane në Kosovë si dhe nga Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë.<sup>61</sup> Në Dhjetor të vitit 2020, KGJK-ja vendosi të ngre në pozitë pesë nga 11 gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë në Departamentin Special të kësaj Gjykate. Si pasojë, gjykimet në rreth 1.000 lëndë është dashur të nis nga fillimi për shkak të ndryshimit të kryetarëve të trupit gjykues. Në fillim të vitit 2021, Departamenti i Krimeve të Rënda mbeti vetëm me gjashtë gjyqtarë. Vendime të tilla bashkë me mungesën e politikave të qëndrueshme dhe mungesën e zgjidhjeve efektive ndikojnë në vazhdimësinë e funksionimit të gjykatave dhe ndikojnë në të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme.

#### **46. Rekomandimet:**

- Qeveria dhe Kuvendi duhet të hartojnë një ligj që përcakton kompensimin e viktimave të çdo shkeljeje të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë brenda një kohe të arsyeshme.
- KGJK-ja duhet të sigurojë që çfarëdo ndërprerje e punës në sistemin gjyqësor të mos shpie në shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë dhe mjet juridik efektiv, duke përfshirë dhe duke i dhënë prioritet rasteve sipas rëndësisë së përgjithshme dhe ndikimit mbi të drejtat e personave dhe grupeve në gjendje të cënueshme; promovimi i zgjidhjeve teknologjike si shërbimet online, seanca në distancë dhe video konferenca; dhe duke respektuar udhëzimet e ekspertëve të dhëna nga Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për efikasitetin e drejtësisë.

<sup>60</sup> [Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik](#) (27 prill 2018).

<sup>61</sup> IKD, 'Dorëheqja e anëtarëve të KPK-së në kohën para shpalljes së konkursit për kryeprokurorë, praktikë që mund të paraqesë konflikt të interesit dhe mungesë të integritetit' (8 tetor 2020).

## 5.4. Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim, dhe e drejta e privatësisë

**47.** Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes dhe mendimit, të drejtën për informim, si dhe lirinë e mediave në Kosovë,<sup>62</sup> ndërsa bazat për kufizime janë në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë,<sup>63</sup> në veçanti KEDNJ-në.

**48.** Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike, i cili ka hyr në fuqi në korrik të vitit 2019, synon të garantojë të drejtën e secilit person pa diskriminim për qasje në dokumente publike të prodhuara, pranuar, mbajtura apo të kontrolluara nga institucionet publike, si dhe të drejtën e ripërdorimit të dokumenteve të sektorit publik.<sup>64</sup> Me këtë ligj, relativisht të ri krijohet Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) si organ i pavarur përgjegjës për monitorimin e zbatimit të tij. Sidoqoftë, pas tri përpjekjeve të pasuksesshme, Kuvendi ende nuk ka arritur të zgjedhë Komisionerin për Privatësi. Propozimi i Komisionit të Kuvendit për Siguri për të ndryshuar ligjin në lidhje me zgjedhjen e komisionerit u kritikua nga OSHC-të, të cilat e konsideruan atë si një përpjekje për të politizuar këtë mekanizëm.

**49.** Për sa i përket lirisë së medias, ka pasur disa sulme të raportuara ndaj punonjësve të mediave në vitin 2020, disa prej të cilave ndërlidhen me punën e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me pandeminë. Më 5 maj, Policia e Kosovës në Gjilan dyshohet se kërcënoi një gazetare derisa po hetonte pretendimet se masat COVID-19, përfshirë edhe një karantinë të detyrueshme 14-ditore, po zbatoheshin në mënyrë të pabarabartë.<sup>65</sup> Me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit më 3 maj, disa mekanizma, përfshirë IAP-në, Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) në Kosovë dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK), ngritën shqetësime rreth sulmeve dhe kërcënimeve të fundit ndaj gazetarëve dhe theksuan rëndësinë thelbësore të lirisë së mediave në Kosovë.<sup>66</sup> Për më tepër, në tetor, AGK-ja publikoi një raport hulumtues të titulluar “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve”, i cili adreson disa sfida me të cilat punonjësit e mediave janë përballur gjatë pandemisë sa i përket të drejtave në punë dhe atyre ekonomike, sigurisë në punë dhe aftësisë për të ushtruar funksionet e tyre të raportimit.<sup>67</sup> Raporti tërheq vëmendjen në largimet nga puna, uljet e pagave dhe vonesat në dhënien e pagave që pretendohet se kanë ndodhur nga marsi i vitit 2020, duke vënë në dukje më tej se disa punonjësve të mediave u janë ndërprerë kontratat e punës pa njoftim paraprak, në kundërshtim me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212. Sipas raportit, punonjësit e mediave gjithashtu nuk u klasifikuan si “punëtorë thelbësorë” në pakon fiskale emergjente për COVID-19 të Qeverisë dhe për këtë arsye nuk kishin të drejtë të merrnin disa nga përfitimet e saj, duke ndikuar më tej në situatën e tyre ekonomike. Gjithashtu, thekson se punonjësit e mediave janë përballur me vështirësi në kryerjen e punës së tyre dhe sigurimin e PPM-ve të mjaftueshme për të mbrojtur të drejtën e tyre për siguri dhe shëndet në punë.

62 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, nenet 40-42.

63 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 22; shih gjithashtu DUDNJ, neni 19; PNDKP, neni 19; KEDNJ, neni 10.

64 [Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike](#) (4 korrik 2019), neni 1.

65 AGK, ‘[Kërcënime tjera ndaj gazetarëve, Yllka Ahmetxhekaj, Prishtinë](#)’ (5 Maj 2020).

66 Shih, p.sh., IAP, ‘[Deklarata e Avokatit të Popullit me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit](#)’ (3 maj 2020).

67 AGK, ‘[Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Gjendjen Ekonomike të Gazetarëve, Kameramanëve dhe Fotoreporterëve](#)’ (27 tetor 2020).

**50.** Komunitetet jo-shqipfolëse u ballafaquan me sfida të veçanta në marrjen e informacioneve të duhura dhe në kohën e duhur për masat e parandalimit dhe luftimit të COVID-19 pasi pandemia përkeqësoi problemet ekzistuese në lidhje me sigurimin e përkthimeve në të dy gjuhët zyrtare, duke prekur të drejtën e tyre të informimit dhe të drejtës gjuhësore. Përkundër nenit 5 të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve,<sup>68</sup> përkthimet e vendimeve të Qeverisë së Kosovës në lidhje me masat e parandalimit të COVID-19 në gjuhën serbe shpesh arrinin tek komunitetet serbisht-folëse vetëm pasi ato masa kishin hyrë në fuqi, ndërsa disa konferenca për shtyp të lidhura me COVID-19 nuk kishin përkthyes për personelin e mediave që raportonte në gjuhën serbe. Për shembull, IKSHPK ofronte informacione të përditësuara mbi situatën e COVID-19 në Kosovë vetëm në gjuhën shqipe. Sipas një sondazhi të opinionit publik të kryer nga OJQ-ja AKTIV, “dështimi i institucioneve të Kosovës për të komunikuar në mënyrë efektive me komunitetet jo-shumicë [rreth informacioneve në lidhje me COVID-19] ka krijuar një hapësirë të gjerë për përhapjen e teorive konspirative dhe ‘lajmeve të rrejshme’, duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në “perceptimet lidhur me rrezikun që paraqet nga COVID-19”. OJQ AKTIV theksoi, në veçanti, se Ministria e Shëndetësisë nuk ka përditësuar versionin e faqes së saj të internetit në gjuhën serbe për muaj të tërë gjatë pandemisë.<sup>69</sup>

**51.** Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtën për privatësi,<sup>70</sup> ndërsa e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale garantohej me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.<sup>71</sup> Ligji kërkon që subjektet e të dhënave të njoftohen në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe që përpunimi i të dhënave personale të kryhet vetëm nëse është e nevojshme dhe proporcional me ndjekjen e qëllimit të qarta, specifik dhe legjitim.<sup>72</sup>

**52.** Në një rast simbolik më 4 prill, një shtëpi mediatike publikoi emrat e 210 serbëve, romëve dhe goranëve të Kosovës të cilët u urdhëruan të izoloohen, përfshirë emrat e njerëzve që trajtohen për COVID-19.<sup>73</sup> Sipas Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, publikimi i të dhënave të tyre private dhe statusit të tyre të mundshëm me COVID-19 ishte shkelje e Kapitullit 7 të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës, i cili garanton të drejtën e privatësisë në raportimin e mediave.<sup>74</sup> Më vonë atë ditë, IAP reagoi dhe i dërgoi një letër-rekomandim Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke pretenduar shkelje të Kushtetutës dhe legjislacionit përkatës. Në një rast tjetër, një medium ka publikuar emrat dhe numrat e identifikimit të 82 mjekëve dhe infermierëve serbë që kanë hyrë në Kosovë për të monitoruar situatën me COVID-19 në komunat veriore.<sup>75</sup> Incidente të tilla duket

68 [Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve](#) (1 mars 2007) (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Përdorimin e Gjuhëve).

69 OJQ AKTIV, ‘[Raporti vjetor mbi Gjendjen e të Drejtave Gjuhësore në Kosovë: Të Drejtat Gjuhësore në Kohë Pandemie](#)’ (1 shkurt 2021) (në tekstin e mëtejshëm 2020 Raporti i AKTIV për të Drejtat Gjuhësore).

70 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 36.

71 [Ligji Nr. 06/L-082 mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale](#) (25 shkurt 2019).

72 Po aty., neni 3.

73 Radio Kontakt Plus, ‘[Gazeta Sinjali da hitno ukloni lične podatke osoba u izolaciji i obolelih od Kovida-19](#)’ (radiokontaktplus.org, 4 prill 2020).

74 Po aty.

75 Indeksonline, ‘[Dokument/ Emrat e 82 mjekëve e infermierëve serbë që hynë sot në Kosovë](#)’ (indeksonline.net, 28 prill 2020).



se shkelin Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të drejtën e privatësisë të garantuar me Kushtetutën e Kosovës si dhe me instrumentet e të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejtë, siç është neni 17 i PNDCP-së.

**53.** E vetmja mënyrë për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave është fuqizimi i autoritetit të AIP-së. Kapaciteti ekzistues dhe mbështetja financiare e kësaj agjencie nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të siguruar zbatimin e duhur të kornizës ligjore që mbron të drejtat për informim dhe privatësi në Kosovë.

#### **54. Rekomandimet:**

- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojnë që zgjedhja e Komisionerit të AIP-së të bëhet pa ndonjë vonesë të paarsyeshme dhe të caktohen burimet e duhura njerëzore dhe financiare për t'i dhënë mundësi AIP-së të kryejë mandatin e saj.
- Të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal duhet të sigurojnë qasje në informacione në të gjitha gjuhët zyrtare dhe, gjatë pandemisë, të sigurojnë informacione përkatëse në gjuhët e komuniteteve të tjera lokale.
- Të gjitha palët e interesit duhet të sigurojnë që çdo përpunim i të dhënave shëndetësore të jetë i sigurt dhe të mbahet konfidencial në përputhje me kornizën ligjore në fuqi në Kosovë.

#### **5.5. Liria e tubimit paqësor**

**55.** Kushtetuta e Kosovës dhe instrumentet e të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejtë garantojnë lirinë e tubimit paqësor për çdo person në Kosovë.<sup>76</sup> Ligji Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike u garanton qytetarëve të Kosovës të drejtën për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime publike.<sup>77</sup> Korniza ekzistuese ligjore kërkon që tubimet publike të lajmërohen 72 orë më herët, përjashtim të rasteve për të cilat nuk kërkohen masa shtesë të sigurisë. Kur asnjë përgjigje nuk ofrohet nga autoritetet 48 orë para mbajtjes së tubimit publik, tubimi mund të zhvillohet pa asnjë kufizim. Nëse autoritetet e ndalojnë tubimin, ligji lejon paraqitjen e një ankese kundër një vendimi të tillë tek "organet më të larta të policisë" brenda 48 orëve. Autoritetet duhet të japin përgjigjen e tyre brenda 48 orëve. Organizatori ose përfaqësuesi i tubimit publik, i cili nuk është i kënaqur me vendimin e autoritetit për të ndaluar tubimin publik, atëherë ka të drejtë të apelojë vendimin në gjykatë brenda tre ditësh përmes një procedure të shpejtë.

**56.** Çka është me rëndësi, dispozitat e Ligjin Nr. 03/L-118 për Tubime Publike vlen vetëm për banorët e Kosovës. Mbetet e paqartë nëse garancitë e përcaktuara nga ligji vlejné edhe për jobanorët, siç janë personat pa shtetësi, refugjatët dhe shtetasit e huaj, etj. Tubime spontane dhe kundër-tubimet nuk lejohen, edhe pse kjo nuk është theksuar shprehimisht. Ligji thotë se një

76 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 43; PNDCP, neni 21; KEDNJ, neni 11.

77 [Ligji Nr. 03/L-118 për Tubime Publike](#) (15 prill 2009).



kërkesë për të organizuar tubim mund të refuzohet nëse planifikohet të ndodhë në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë apo kohë të përafërm me një tubim tjetër që është lejuar të mbahet.

**57.** Në vitin 2019, Ministria e Punëve të Brendshme filloi procesin e hartimit të një Ligji të ri për Tubime Publike. Në kohën e hartimit të këtij dokumenti, projektligji ka kaluar konsultimet publike online; megjithatë, versioni i fundit prapë nuk i adreson komentet e bëra nga OSHC-të. Në tetor të vitit 2020, me kërkesë të Qeverisë, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) publikoi opinionin e tij për projektligjin.<sup>78</sup> Sipas Opinionit, përkufizimet “tubimi publik paqësor” dhe “tubimi publik” janë të paqarta dhe mund të çojnë në konfuzion në lidhje me rolin e policisë në rastet e tubimeve publike dhe detyrat dhe përgjegjësitë e organizatorëve të “tubimeve publike paqësore”. Projektligji nuk përcakton nocionin “paqësor”, duke krijuar hapësirë për interpretime të ndryshme. Përkufizimet e “dhunës” dhe “protestave” nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Nocioni “organi kompetent” që është i autorizuar të lejojë ose refuzojë tubimet publike kërkon detaje të mëtejshme, përfshirë edhe specifikimin se cilat organe ose zyrtarë bien brenda fushëveprimit të kësaj dispozite. Përveç kësaj, sanksionet ndaj personave fizikë që shkelin ligjin u vlerësuan si disproporcionalisht të larta. Është gjithashtu e rëndësishme që Qeveria e Kosovës të marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e Udhëzimeve për Lirinë e Tubimit Paqësor që Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR) dhe Komisioni i Venedikut i botuar në vitin 2019,<sup>79</sup> të cilat pasqyrojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe praktikën e demokracive të tjera. Këto udhëzime përqendrohen në një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut në kryerjen e detyrave policore gjatë tubimeve dhe ofrojnë udhëzime për zbatimin e legjislacionit vendor mbi lirinë e tubimit paqësor në përputhje me standardet ndërkombëtare.

**58.** Masat e parandalimit të COVID-19 ndikuan ndjeshëm në ushtrimin e lirisë së tubimit paqësor. Gjatë tërë vitit, varësisht prej numrit të infektiveve të reja dhe masave të përcaktuara nga qeveria, liria e tubimit iu nënshtrua kufizimeve të ndryshme duke filluar nga ndalimi i plotë i tubimeve<sup>80</sup> në fazat e hershme të pandemisë deri në heqjen e të gjitha kufizimeve në lirinë e tubimit paqësor në qershor. Ky izolim, megjithatë, nuk i ka penguar banorët e Kosovës të gjenin mënyra kreative për të shprehur mendimet dhe shqetësimet e tyre. Për disa ditë, banorët anembanë Kosovës protestuan në ballkonet e tyre dhe nga dritaret e shtëpive të tyre duke goditur tenxheret dhe tiganët për të dënuar politikanët e Kosovës për «shkaktimin e dramës dhe pasigurisë» mbi të ardhmen e udhëheqjes së Kosovës gjatë pandemisë COVID-19. Gjithashtu, Lëvizja Vetëvendosje, duke ndjekur procedurat e zakonshme, mori leje nga Policia e Kosovës për të organizuar dy (test) protesta në përputhje me masat parandaluese COVID-19 të vendosura nga IKSHPK-ja. Për më tepër, Policia e Kosovës lëshoi një deklaratë duke pretenduar se protestat gjatë pandemisë lejohen nëse

78 Komisioni i Venedikut, ‘Opinion mbi Projektligjin për Tubimet Publike’ (9 tetor 2020) Dok. Nr. CDL-AD (2020)030.

79 Komisioni i Venedikut dhe ODIHR, ‘Udhëzime për Lirinë e Tubimit Paqësor’ (8 korrik 2019) Dok. Nr. CDL-AD(2019)017.

80 Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 01/15 (23 mars 2020).

zbatohen masat, siç është distancimi social. Në të njëjtën kohë, aktivistët që kërkonin drejtësi për një djalë 11-vjeçar rom të vrarë në korrik të vitit 2019 ngritën padi ndaj Policisë së Kosovës duke e kontestuar refuzimin nga ana e tyre të kërkesë për të mbajtur një protestë fizike më 31 gusht për arsye të pandemisë. Kërkesa u refuzua edhe pse organizatorët thuhet se respektuan të gjitha masat e zbatueshme për mbajtjen nën kontroll të COVID-19.

## 59. Rekomandimet:

- Qeveria e Kosovës duhet të adresojë dhe përfshijë rekomandimet në Opinionin e Komisionit të Venedikut në projektligjin për tubimet publike.
- Qeveria e Kosovës duhet të adresojë dhe përfshijë rekomandimet e ODIHR-it dhe Komisionit të Venedikut në Udhëzimet e tyre për Lirinë e Tubimeve Paqësore në projektligjin për tubimet publike, të bazuar në të drejtat e njeriut sa i përket tubimeve publike.
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë që ndryshimet në Ligjin Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike ofrojnë mundësi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime spontane dhe kundër-tubime. Ai duhet të përfshijë gjithashtu dispozita që shtrijnë lirinë e tubimit për personat pa shtetësi, refugjatët, shtetasit e huaj dhe të tjerët.

## 5.6. Liria e asociimit

**60.** Liria e asociimit është e garantuar me nenin 44 të Kushtetutës së Kosovës. Përfshirë të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa marrë leje, të drejtën për të qenë ose jo anëtar i një organizate dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitetet e një organizate. Versioni i fundit i Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare hyri në fuqi gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019.<sup>81</sup> Ligji njih tri forma të OJQ-ve: shoqatat, fondacionet dhe institutet. Institutet janë njohur si formë e re ligjore së fundmi, dhe aktet nënligjore që e përcaktojnë formimin dhe funksionimin e instituteve ende janë duke u hartuar. Ligjet specifike rregullojnë asociimin brenda sindikatave, partive politike dhe bashkësive fetare. Korniza ligjore ekzistuese nuk përmban kufizime që u kërkojnë organizatave të veprojnë vetëm në zona të caktuara dhe nuk e kufizon numrin e organizatave që mund të veprojnë për qëllime të ngjashme. Liria e asociimit zbatohet në mënyrë të barabartë për individët dhe personat juridikë që duan të krijojnë shoqata, fondacione ose institute. Asnjë person nuk diskriminohet për shkak të vendimit për t'u bashkuar apo për të mos u bashkuar, dhe asnjë person nuk obligohet të bashkohet kundër vullnetit të tij.<sup>82</sup> Korniza ligjore lejon krijimin e organeve të nivelit bazë. Sidoqoftë, nuk i përcakton ato si kategori e veçantë.

**61.** Ligji i ri e ka shkurtuar procedurën e regjistrimit nga 60 në 30 ditë, e cila është falas dhe e thjeshtë për tu ndjekur. Ekzistimi i një platforme online për regjistrimin e OSHC-ve lehtëson procesin. Më 31 dhjetor 2020, Regjistri Publik i OJQ-ve ka pasur 10,759 organizata, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash siç janë personat me nevoja të veçanta, fuqizimin, demokratizimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

81 [Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare](#) (24 prill 2019).

82 Po aty., neni 4.

**62.** Në vitin 2020, KCSF-ja intervistoi OSHC-të, donatorët dhe institucionet publike për të mbledhur informacione nga të gjitha palët e rëndësishme të interesit se si ka ndikuar pandemia në shoqërinë civile në Kosovë. Sipas rezultateve të sondazhit, 96.71 për qind e OSHC-ve deklaruan se pandemia COVID-19 ka ndikuar në punën e tyre të përditshme dhe rreth 20 për qind e OSHC-ve i kishin mbyllur zyrat e tyre, ndërsa më shumë se 60 për qind raportuan se punonin online. Rreth 30 për qind e OSHC-ve të anketuara raportuan se u ishte dashur të pushonin nga puna ose të pezullonin përkohësisht stafin, ndërsa 38 për qind e OSHC-ve raportuan zvogëlim të numrit të vullnetarëve. Shumica e OSHC-ve të anketuara të regjistruara vitin e kaluar nuk raportuan për ndonjë presion nga autoritetet. Asnjë nga OSHC-të e anketuara nuk tha se ishte ballafaquar me ndonjë kufizim gjatë ushtrimit të lirisë së tyre për asociimit online ose offline.

**63.** Në vitin 2020, Qeveria e Kosovës nuk inicioi asnjë ndryshim në kornizën ligjore për lirinë e asociimit ose në kornizën e përgjithshme ligjore për OJQ-të. Në ndërkohë, OSHC-të në Kosovë ishin shumë të zëshme në nxitjen e Qeverisë që t'i përfshijë ato në paketot e saj emergjente të rimëkëmbjes ekonomike COVID-19. Avokimi për të përfshirë OSHC-të si përfituese të Pakos Fiskale Emergjente e Ministrisë së Financave ka rezultuar e suksesshme.

#### **64. Rekomandimet:**

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që OSHC-të të përfshihen në mënyrë specifike në të gjitha masat e lehtësimit ekonomik COVID-19 për të siguruar funksionimin e duhur të shoqërisë civile si gjatë ashtu dhe pas pandemisë COVID-19.

### **5.7. Liria e besimit, ndërgjegjës, dhe e fesë**

**65.** Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë e Fetare në Kosovë përcaktojnë që Kosova është laike dhe neutrale në çështjet e besimeve fetare.<sup>83</sup> Korniza ligjore i garanton të gjithëve të drejtën për lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar.<sup>84</sup> Kjo e drejtë përfshinë lirinë “për të pasur ose për të mos pasur fe, për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin, qoftë si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht” dhe “lirinë për të manifestuar fenë ose besimin, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive.”<sup>85</sup> Ligji, megjithatë, nuk u siguron bashkësive fetare ose grupeve mundësinë për t’u regjistruar dhe për të fituar subjektivitet juridik, gjë që krijon pengesa shtesë për punën dhe funksionimin e duhur të bashkësive fetare. Komunitetet fetare pa subjektivitet juridik nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për pronë, të mbajnë llogari bankare, të punësojnë punëtorë, etj. Si rezultat, disa bashkësi fetare janë të detyruara të regjistrohen dhe të funksionojnë si OJQ, pavarësisht se kjo kornizë është joadekuate për bashkësitë fetare.<sup>86</sup>

83 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 8; [Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë](#) (1 prill 2007), neni 5 (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Lirinë Fetare).

84 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 38.

85 Ligji për Lirinë Fetare, shënimi 83, neni 1.

86 Serbeze Haxhijaj, ‘[Grupet fetare të Kosovës ende të ndara për Ligjin që ofron Status Ligjor](#)’ (kallxo.com, 11 shkurt 2021).

**66.** Përkundër disa raundeve të shqyrtimeve dhe rishikimeve për ta harmonizuar atë sa më shumë me opinionin e Komisionit të Venedikut të vitit 2014,<sup>87</sup> projektligji për të ndryshuar Ligjin Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë për të lejuar bashkësitë fetare të regjistrohen dhe të marrin statusi i personit juridik është në pritje që nga viti 2013 dhe nuk është miratuar ende as deri në dhjetor 2020. Nëse miratohet, projektligji përfundimisht do t'u siguronte bashkësive fetare të drejtën për t'u regjistruar dhe për të fituar personalitetin juridik, duke krijuar një sistem regjistrimi në dy nivele për statusin e subjektit juridik: regjistrim automatik dhe status juridik për gjashtë bashkësitë e njohura fetare dhe regjistrim fakultativ për bashkësitë "e reja" fetare nëse plotësohen kushtet e përcaktuara. Sipas versionit të fundit të projektligjit të miratuar nga Qeveria e Kosovës në shtator 2020, janë gjashtë bashkësi fetare të njohura që kanë të drejtë për regjistrim automatik dhe status të personit juridik: Bashkësia Islame e Kosovës, Kisha Katolike, Kisha Ortodokse Serbe (KOS), Komuniteti Fetar Hebre, Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës dhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës.

**67.** Në vitin 2020, pjesëtarët e komuniteteve serbe të Kosovës vazhduan të ishin të ekspozuar ndaj dhunës dhe frikësimit kur përpiqeshin të hynin në objektet fetare dhe kulturore për pelegrinazhe ose ngjarje të tjera të rëndësishme. Në fillim të vitit 2020, serbët u përballën me një protestë kur u përpoqën të vizitonin një kishë ortodokse në Gjakovë, siç ishte rasti në fillim të vitit 2019. Kjo mund të konsiderohet si kufizim i të drejtës së tyre kushtetuese për lirinë fetare dhe besimin pasi pelegrinët nuk patën mundësi të hynin në vendin (vendet) e tyre të besimit. Kishte edhe sulme në varreza dhe përpjekje për të frikësuar dhe kërcënuar ata që përpiqen t'i vizitojnë ato. Prej janarit deri në nëntor 2020 janë raportuar tri raste të përdhosjes së varreve ortodokse serbe në komunat e Istogut dhe Mitrovicës së Jugut. Dështimi i autoriteteve për të parandaluar sulmet ndaj objekteve dhe monumenteve fetare, si dhe për të siguruar qasjen në to, i pengoi besimtarët të praktikonin fenë e tyre dhe mund të konsiderohet si shkelje e të drejtës për lirinë fetare.

**68.** Masat kufizuese që filluan të aplikohen pas pandemisë COVID-19 ndikuan në ushtrimin e lirisë fetare. Gjatë vitit 2020, Qeveria e Kosovës shtrëngoi dhe lehtësoi kufizimet varësisht nga situata e COVID-19 në Kosovë. Shumica e xhamive, kishave dhe objekteve të tjera të besimit u mbyllën gjatë kulmit të pandemisë dhe nuk u lejua asnjë ceremoni fetare të zhvillohej aty,<sup>88</sup> duke prekur, ndër të tjera, lirinë e tubimit në lidhje me fenë ose besimin siç përcaktohet me ligj.

## **69. Rekomandimet:**

- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të ndryshojnë Ligjin Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë për t'u siguruar grupeve fetare të drejtën për t'u regjistruar dhe për të fituar personalitetin juridik.
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë mbrojtje më të mirë për objektet fetare, si varrezat, manastiret, kishat dhe xhamitë.

87 Komisioni i Venedikut, 'Opinion mbi Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë e Fetare në Kosovës' (25 mars 2014) Doc. No. CDL-AD(2014)012.

88 [Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 01/15](#) (23 mars 2020); [Vendimi i Qeverisë Nr. 01/42](#) (11 nëntor 2020).

## 6. SEKSIONI B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

### 6.1. Të drejtat e punës

**70.** Kushtetuta e Kosovës garanton mbrojtjen e barabartë ligjore dhe mosdiskriminimin, të drejtën për punë dhe lirinë për të zgjedhur profesionin dhe lirinë e asociimit, përfshirë lirinë për të themeluar sindikata.<sup>89</sup> Ajo përcakton gjithashtu që fëmijët gëzojnë të drejtën për të qenë të mbrojtur, përveç të tjerash, nga eksploatimi.<sup>90</sup> Ligji i Punës nr. 03/L-212 , i miratuar në vitin 2010, vazhdon të rregullojë marrëdhëniet e punës dhe të drejtat në punë të punonjësve si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik,<sup>91</sup> ndërsa Ligji Nr. 04 / L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i cili u miratua në 2013 siguron mbrojtje ligjore për të drejtën e sigurisë dhe shëndetit profesional.<sup>92</sup> Ligji nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal rregullon dhe përcakton të drejtat dhe lirinë e punonjësve për themelimin e organizatave sindikale në sektorin publik dhe privat.<sup>93</sup>

**71.** Në një zhvillim pozitiv, Qeveria e Kosovës propozoi Projektligjin Nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës me qëllimet kryesore të trajtoj punësimin joformal dhe rritjen e kapacitetit për inspektimet e bizneseve për të parandaluar shkeljet e të drejtave të punëtorëve sipas koncept dokumentit. Sidoqoftë, Projektligji, i cili do të zëvendësonte Ligjin ekzistues Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, është në pritje të shqyrtimit dhe miratimit nga komisioni funksional i Kuvendit që nga shtatori.<sup>94</sup>

**72.** Inspektorati i Punës, i cili është mekanizmi kryesor për monitorimin e zbatimit të ligjeve të punës së Kosovës dhe trajtimin e ankesave përkatëse, paraqiti një pasqyrë shqetësuese të sektorit të punës në raportin e tij të vitit 2020.<sup>95</sup> Sipas raportit, Inspektoratit të Punës i mungon kapaciteti i nevojshëm për të mbikëqyrë në mënyrë efektive zbatimin e ligjeve të punës pasi ka vetëm 30 inspektorë të cilët duhet të inspektojnë dhe mbikëqyrin 50,000 subjekte aktive vetëm në sektorin privat. Me fjalë të tjera, secili inspektor duhet të mbikëqyrë 1,666 subjekte brenda një viti. Një çështje tjetër kyçe është mospërputhja e ankesave të shqyrtuara nga Inspektorati i Punës që kishin të bënin me sektorin publik (10,010 ankesa) kundrejt sektorit privat (646 ankesa). Raporti gjithashtu tregon se punësimi joformal vazhdon të jetë problem i pandryshuar në të gjithë Kosovën: 19 për qind e 25,725 të punësuarve në subjektet që janë inspektuar nuk kishin kontrata të punës. Një nga arsyt kryesore pse punëdhënësit nuk lidhin kontrata formale të punësimit është për të shmangur detyrimin e pagesës së kontributeve në llogaritë e Trustit Pensional të punonjësve të tyre.

89 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, nenet 24, 44, 49.

90 Po aty., neni 50.

91 [Ligji Nr. 03/L-212 i Punës](#) (1 dhjetor 2010) (në tekstin e mëtejshëm Ligji i Punës).

92 [Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë](#) (14 qershor 2013) (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).

93 [Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë](#) (26 gusht 2011).

94 [Projektligji Nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës](#) (14 shtator 2020).

95 Inspektorati i Punës, [‘Raporti i Punës për Vitin 2020’](#) (22 mars 2021).

**73.** Në maj, Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) theksoi se janë duke u shkelur se të drejtat e punëtorëve në Kosovë, përfshirë të drejtën për siguri dhe shëndet në punë gjatë pandemisë.<sup>96</sup> OJQ-ja RRGK gjithashtu bëri thirrje për vëmendje më të madhe për të drejtat e grave në tregun e punës dhe për përpjekje shtesë në luftimin e diskriminimit gjinor në tregun e punës.

**74.** Punëtorët në institucionet publike të Kosovës vazhduan të kenë detyrim ligjor të punojnë gjatë gjithë pandemisë, megjithëse Qeveria e Kosovës ka marrë disa vendime për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë që nga fillimi, si kërkesa që institucionet të punojnë me staf të reduktuar. Shumë nëpunës civilë raportuan se këto rregulla dhe vendime të qeverisë nuk po zbatoheshin dhe respektoheshin sa duhet. Në disa raste, punonjësit e sektorit publik ishin të detyruar të punojnë edhe nëse mjedisi i punës nuk ofronte mundësi për të mbajtur distancën e sigurt fizike dhe masat e duhura higjienike. Në të vërtetë, dezinfektuesit dhe PPM-të u bënë gjerësisht të disponueshme në vendet e punës me kalimin e kohës. Në një rast simbolik, Lëvizja FOL ka raportuar se punonjësve në disa institucione të nivelit qendror u ishte kërkuar që të ktheheshin në punë më 14 shtator, në shkëlqje të drejtpërdrejtë të vendimit të Qeverisë të datës 1 korrik që i detyronte të gjitha institucionet të punojnë me staf të reduktuar për të siguruar distancën e duhur fizike të punëtorëve. Ky rast specifik paraqet shkëlqje të të drejtave të punës së punëtorëve, në veçanti të drejtën e tyre për siguri dhe shëndet në punë për të cilën ata kanë të drejtë në bazë të kontratave të tyre të punës, Kushtetutës dhe legjislacionit të Kosovës.<sup>97</sup>

**75.** Sipas raporteve, mësimdhënësit me probleme shëndetësore është dashur gjithashtu të punojnë personalisht kur u rihapën shkollat në shtator, duke ngritur shqetësime të veçanta për të drejtën e tyre për siguri dhe shëndet në punë.<sup>98</sup> Në të njëjtën kohë, Kryetari i BSPK-së theksoi shqetësimin e përgjithshëm për rastet e raportuara në të cilat kompanitë nuk kishin lejuar punëtorët e tyre të testohen për COVID-19, duke i privuar përsëri nga e drejta e tyre për siguri dhe shëndet në punë.<sup>99</sup> Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës raportoi se 293 zyrtarë policorë ishin infektuar me COVID-19, 234 zyrtarë policorë ishin në karantinë dhe 12 zyrtarë policorë kanë vdekur për shkak të COVID-19 që nga 15 dhjetori,<sup>100</sup> duke ngritur edhe një herë implikime për të drejtën e sigurisë në punë dhe shëndetin e një kategorie tjetër të punëtorëve.

**76.** Pandemia COVID-19 dhe masat që kanë të bëjnë me të kanë prekur pothuajse të gjitha aspektet e shoqërisë, por kanë pasur ndikim veçanërisht negativ tek punëtorët, veçanërisht tek ata të punësuar në sektorin privat. Në veçanti, Qeveria e Kosovës aplikoi kufizimet e lëvizjes COVID-19<sup>101</sup> dhe kufizoi aktivitetet e bizneseve dhe industrive të sektorit privat, ngjarjeve kulturore dhe sportive, dhe përfundimisht institucioneve arsimore në shkallë të ndryshme gjatë pandemisë.<sup>102</sup> Kështu, bizneset u prekën nga këto kufizime dhe pësuan një rënie të të hyrave, gjë që ndikoi në mirëqenien e shumë grupeve shoqërore. Sipas Administratës Tatimore të Kosovës, Kosova përjetoi

96 RTK Live, 'Ajdini: Nuk po Respektohen të Drejtat e Punëtorëve në Kosovë' (1 maj 2020).

97 Ligji i Punës, shënimi 91; shih gjithashtu Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, shënimi 92.

98 Arbisa Shefkiu, 'Denoncimi i Jasharajt, mësuesit e sëmurë po obligohen të mbajnë mësim gjatë COVID-19' (kallxo.com, 10 nëntor 2020).

99 Mediana Halili, 'Jusuf Azemi: Pronarët e bizneseve nuk lejuan testimin e punëtorëve për COVID-19' (kallxo.com, 25 nëntor 2020).

100 Kuvendi i Kosovës, 'Nga mbledhja e Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes' (15 dhjetor 2020).

101 Vendimi i QK Nr. 01/15 (23 mars 2020).

102 Po aty; Vendimi i QK Nr. 01/42 (11 nëntor 2020).



një rënie të konsiderueshme në të hyrave në nëntë muajt e parë të vitit 2020, mbi 1 miliardë € më pak se në vitin 2019.<sup>103</sup>

**77.** Në fillim të pandemisë, më 30 mars, ish-qeveria miratoi një pako emergjente fiskale për të zbutur disa nga pasojat socio-ekonomike të pandemisë, e cila përfshinte 15 masa që synonin të ndihmojnë punonjësit individualë, bizneset dhe organizatat publike me 179,6 milionë € për të përballuar vështirësitë e shkaktuara nga pandemia,<sup>104</sup> përfshirë mbështetjen financiare për kompanitë duke subvencionuar pagat mujore me një shumë prej 170 € për dy muaj, 50 për qind subvencione për koston e qerasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe 130 € subvencion për një periudhë tre mujore për njerëzit që kanë humbur vendin e punës. Megjithatë, ka pasur vonesa në shpërndarjen e mjeteve për shkak të nevojës për të rishikuar buxhetin e Kosovës, e cila mori kohë shtesë për tu proceduar nga Kuvendi për shkak të kundërshtimeve politike. Disa grupe gjithashtu përjetuan vështirësi në qasjen në këto përfitime. Në veçanti, disa të kthyer dhe persona të zhvendosur brenda vendit nuk ishin të familjarizuar me mënyrën e aplikimit në internet dhe nuk kishin dokumentacion përkatës, ndërsa shërbimet civile punonin me staf të kufizuar. Përveç kësaj, personat që nuk kishin kontrata zyrtare të punës dhe që humbën vendet e tyre të punës gjatë pandemisë rrezikuan të mos përfitonin sepse kompanitë private hezitonin të formalizonin kontratat e tyre një vjeçare, gjë që ishte parakusht.<sup>105</sup>

**78.** Derisa bizneset kishin vështirësi në përpjekjet e tyre për të vazhduar punën si zakonisht, kriza COVID-19 preku në mënyrë disproporcionale punëtorët të cilët përjetuan shkelje akute të së drejtës për kushte të drejta dhe të favorshme të punës, si ndërprerja e paligjshme e kontratave, uljet e pagave, mungesa e marrëdhënieve kontraktuese mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, ngarkesa e shtuar e punës për shkak të zvogëlimit të numrit të punonjësve, pagesave të vonuara të kompensimeve për punën jashtë orarit dhe mungesa e rrjeteve adekuate të sigurimeve sociale për punëtorët. Shumë njerëz në Kosovë u pushuan nga puna për shkak të mungesës së mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve dhe më pas u ekspozuan situatave të vështira financiare. Disa punonjës të sektorit publik, siç janë zyrtarët policorë të cilët kanë punuar me orë të zgjatura për shkak të pandemisë, thuhet se përjetuan vonesa në pagesën e kompensimit për punën jashtë orarit. Për shembull, në shtator, Qeveria e Kosovës më në fund ndau rreth 4 milionë € për të paguar kompensimin për punën jashtë orarit për pjesëtarët e Policisë së Kosovës që u grumbulluan nga 15 marsi deri më 31 gusht, duke zgjidhur një çështje të kahershme që prekte të drejtat e tyre të punës. Ndërkohë, stafi mbështetës mjekësor, siç janë punëtorët teknikë në institucionet shëndetësore, fillimisht nuk u përfshinë në shtesat e pagave të ofruara për mjekët dhe infermierët, gjë që do të kishte qenë diskriminuese, megjithëse përfundimisht u përfshinë në pagesa të tilla. Raste të tjera simbolike që përfshijnë shkeljen e të drejtës për kushte të drejta dhe të favorshme të punës

103 Instituti GAP, 'Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Ekonominë e Kosovës' (tetor 2020).

104 Ministria e Financave dhe Transfereve, 'Vendimi për Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente' (3 prill 2020).

105 Antigona Isufi, 'Dy muaj pasi u largua nga puna pronari i kompanisë i kërkon punëtorit 170 eurot e Pakos Emergjente' (kallxo.com, 18 gusht 2020).



përfshinin raste të kompanive që nuk kontribuonin në llogaritë e Trustit Pensional të punonjësve të tyre,<sup>106</sup> punëdhënësit refuzonin të lejonin punonjësit e infektuar me Covid-19 të marrin pushim mjekësor me pagesë për t'u karantinuar dhe nënshtruar trajtimit mjekësor,<sup>107</sup> dhe punonjës që nuk kishin kohë të mjaftueshme nga përfundimi i ndërrimeve të tyre për t'u kthyer në shtëpi para fillimit të orës policore, duke rezultuar në gjoba.<sup>108</sup>

**79.** Mungesa e sindikatave të fuqishme, respektimi i pamjaftueshëm i sundimit të ligjit si dhe çështje të tjera që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien në Kosovë kanë përkeqësuar shkeljet e të drejtave të punës në Kosovë, veçanërisht gjatë pandemisë.<sup>109</sup> Kjo veçanërisht prek pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe gratë pasi ata janë të punësuar kryesisht në ekonominë joformale dhe kësaj rrallë mund të përfitojnë nga ndihma financiare e qeverisë.<sup>110</sup> Të dhënat që korrespondojnë me gratë dhe burrat e përfshirë në ekonominë joformale janë ende të paqarta. Nuk ka analizë gjinore për të informuar masat e nevojshme për të trajtuar punëtorët në ekonominë joformale të cilët mbesin më të prekurit nga shkeljet e të drejtave të punës. Diskriminimi gjinor në sektorin e fuqisë punëtore po ashtu mbetet i përhapur dhe me vetëm pak raste të raportuara, mungesë të njohurive mbi mekanizmat e referimit institucional dhe inspektime joadekuate për këtë çështje.

## **80. Rekomandimet:**

- KK duhet të sigurojë që Projektligji Nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës të jetë plotësisht në përputhje me të drejtat dhe standardet ndërkombëtare dhe rajonale të punës dhe të marrë përsipër miratimin e saj për të përmirësuar funksionimin e Inspektoratit të Punës, ndërsa Qeveria duhet të ndajë fonde shtesë për të adresuar kapacitetet e kufizuara të monitorimit dhe inspektimit të Inspektoratit të Punës.
- Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë mbështetje më specifike për punëtorët të cilët janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga pandemia e Covid-19, veçanërisht ata që kanë humbur burimet e tyre të të ardhurave dhe të jetesës. Kjo përfshin sigurimin e mbështetjes financiare për të gjithë të papunët, me theks të veçantë në komunitetet e marginalizuara.
- Qeveria e Kosovës duhet të kujdeset më tepër për të siguruar të drejtën e të gjithë punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë, duke përfshirë, në veçanti, mjediset e duhura të punës që janë në përputhje të plotë me masat e mbrojtjes dhe sigurisë për Covid-19.
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) duhet të mundësojë që rrjetet e sigurisë sociale të janë gjerësisht në dispozicion për të gjithë punëtorët për tu siguruar që ata të mos bien në vështirësi të papritura financiare në raste të emergjencës.

106 Behar Mustafa, 'Ndërtimtarët nuk ua paguajnë Trustin punëtorëve – VIDEO' (kallxo.com, 16 dhjetor 2020).

107 Telegrafi, 'Prishtinë, punëtori me coronavirus punoi në një market – nuk i dha pushim shefi i tij' (telegrafi.com, 23 nëntor 2020).

108 Adelina Ahmeti, "'Ora policore", qytetarja ankohet se u dënua nga Policia duke u kthyer nga puna' (kallxo.com, 13 nëntor 2020).

109 RTK Live, 'Pa Kontratë Pune, S'Ka Ndihmë Nga Pakoja Emergjente' (rtklive.com, 10 prill 2020).

110 Demokracia për Zhvillim, '(Mos)përfshirja e grave në tregun e punës!' (12 janar 2021).

## 6.2. E drejta për arsim

**81.** Neni 47 i Kushtetutës së Kosovës garanton dhe mbron të drejtën për arsimim, duke theksuar se arsimi bazë është i detyrueshëm dhe pa pagesë, dhe gjithashtu garanton mundësi të barabarta arsimore për të gjithë njerëzit sipas nevojave dhe aftësive të veçanta të tyre. Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Para-universitar është ligji bazë që rregullon sistemin arsimor para-universitar në Kosovë.<sup>111</sup> Përveç përcaktimit të detyrave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar, Ligji gjithashtu përcakton që “[a]snjë personi nuk do i mohohet e drejta për arsimim” dhe kërkon që MASHT-i të marrë parasysh, gjatë planifikimit, menaxhimit dhe ofrimit të arsimit parauniversitar, normat e miratuara ndërkombëtare, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve në situata të cenueshme dhe avancimin e barazisë gjinore.<sup>112</sup> Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë synon të sigurojë cilësinë e arsimit të lartë në Kosovë dhe kërkon ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim.<sup>113</sup> Përveç kësaj, Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Kosovës rregullon organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e të gjitha niveleve të arsimit publik në nivel komunal, duke kërkuar nga MASHT-i, ndër të tjera “të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim” dhe “të përmirësojë cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin arsimor.”<sup>114</sup>

**82.** Disa çështje vazhduan të ndikojnë në të drejtën për arsim në Kosovë, përfshirë braktisjen e shkollimit nga nxënësit dhe sfidat në lidhje me përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, si dhe edukimin dhe zhvillimin në fëmijërinë e hershme. Çështja e nxënësve që braktisin shkollimin bazë të detyrueshëm vazhdon të jetë një nga çështjet më problematike në sistemin arsimor të Kosovës, megjithëse ka pasur një rënie të lehtë të numrit të rasteve të braktisjes - 0.05% në vitin 2020 krahasuar me 0.07% në 2019.<sup>115</sup> Sipas vlerësimit statistikor vjetor të kryer nga MASHT-i dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës për vitin 2020, arsimi dhe përfshirja e të gjithë nxënësve me nevoja të veçanta në arsim të rregullt, mbetet gjithashtu një çështje shqetësuese. Sipas vlerësimit, në klasat e rregullta ka pasur 3,903 nxënës me nevoja të veçanta,<sup>116</sup> megjithëse raporti vuri në dukje se vlerësimi nuk është bërë për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta për arsye se ekipet profesionale nuk kishin përfunduar ende vlerësim në komunitet e tyre përkatëse.

**83.** Zhvillimi në fëmijërinë e hershme gjithashtu mbetet një sfidë e veçantë pasi vetëm 15 për qind e fëmijëve (17 për qind djem dhe 13 për qind e vajza) të moshës tre deri në katër vjeç morën

111 [Ligji Nr. 04/L-032. Për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës](#) (16 shtator 2011).

112 Po aty, nenet 3 dhe 5.

113 [Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës](#) (9 shtator 2011).

114 [Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Kosovës](#) (15 qershor 2008).

115 MASHT, 'Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë: Java kundër braktisjes 11-20 nëntor 2020' (nëntor 2020).

116 Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe MASHT-i, 'Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/20' (12 qershor 2020), f. 69.

pjesë në programet e edukimit të hershëm.<sup>117</sup> Rënia e konsiderueshme e numrit të fëmijëve nga komunitetet e rom, ashkali dhe egjiptian që morën pjesë në shkollimin në fëmijërinë e hershme në vitin 2014 (16 për qind) krahasuar me 2020 (tetë për qind) tregon një rritje të hendekut të barazisë në arsimin në fëmijërinë së hershme në mes të fëmijëve nga këto komunitete dhe fëmijëve të tjerë në Kosovë.<sup>118</sup>

**84.** Masat fillestare të ndërmarra nga qeveria për të parandaluar përhapjen e Covid-19 në mars 2020 përfshinin mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore dhe ofrimin e arsimit përmes mësimin në distancë. Kjo ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme në cilësinë e përgjithshme të arsimit, si dhe qasjen në arsim për disa nxënës, veçanërisht ata që u përkisnin grupeve të caktuara në gjendje të cenueshme, siç janë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, të kthyerit, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat që jetojnë në varfëri për shkak të pozitës së dobët financiare të tyre, duke rezultuar në mungesë të pajisjeve thelbësore të TI-së dhe/ose lidhjes në internet.

**85.** Në përgjigje ndaj pandemisë, MASHT-i pezulloi mësimin me pjesëmarrje fizike më 12 mars 2020 dhe me kohë zhvilloi një platformë mësimore për mësimin në distancë për klasat 1 deri 9 që u transmetua nga 20 mars 2020 nëpërmjet stacioneve televizive publike dhe gjithashtu përmes internetit.<sup>119</sup> Ministria e Arsimit e Serbisë gjithashtu filloi mësimin në distancë për nxënësit sipas planprogramit serb në Kosovë, i cili po ashtu u ofrua edhe përmes TV stacioneve publike dhe online.<sup>120</sup> Megjithatë, nxënësit nga komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës u përballën me pengesa të mëdha me qasjen e mësimin në distancë për shkak të mungesës së pajisjeve të TI-së, lidhjes së internetit ose pajisjeve të TV-së.<sup>121</sup> Sipas ish-ministrit të arsimit, rreth 32,000 nxënës nuk e kanë ndjekur rregullisht ose nuk e kanë ndjekur fare mësimin në distancë për shkak të arsyeve të lartpërmendura, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.<sup>122</sup> Më pas, MASHT-i raportoi se 9,070 nxënës (ose 2.8 për qind) të nxënësve në shkollat publike nga klasa 1 deri në 12 vjeç nuk kanë ndjekur mësimin në distancë nga marsi deri në qershor 2020 për shkak të gjendjes së vështirë socio-ekonomike dhe mungesës së pajisjeve të nevojshme teknologjike, ndërsa nxënësit e shkollave private kishin një normë të pjesëmarrjes prej 100 për qind.<sup>123</sup> Sipas një raporti, vetëm 22 për qind e nxënësve dhe mësimitdhënësve në Kosovë besonin se kishte platformë adekuate për të mbështetur mësimin efektiv online, dhe papërshtatshmëria dhe mospërgatitja e mësimitdhënësve në përdorimin e teknologjisë për të dhënë mësim online po ashtu paraqitën një tjetër sfidë.<sup>124</sup>

**86.** Universitetet u lejuan gjithashtu të mësonin duke përdorur vetëm mësimin nga distanca nga marsi dhe pjesa e mbetur e vitit 2020, edhe pse është bërë përjashtim në fund për të lejuar

117 Zyra e UNICEF-it në Kosovë, [‘Rezultatet e Programit Vjetor 2020’](#) (22 mars 2021), f. 3 (në tekstin e mëtejshëm Rezultatet e Programit të UNICEF 2020).

118 Po aty, ff. 3-4.

119 MASHT, [Platforma E-mësimin](#).

120 Ministria e Arsimit e Serbisë, [‘Распоред емитовања образовних садржаја’](#).

121 Gentiana Ahmeti, [‘Viti i pandemisë në shkolla, mësimi online i paarritshëm për të gjithë’](#) (kallxo.com, 6 shkurt 2021).

122 Arbisa Shefkriu, [‘Likaj: Rreth 32 mijë nxënës s’janë përfshirë në mësimin nga distanca’](#) (kallxo.com, 16 qershor 2020).

123 MEST, [‘Udhëzues i Përgjithshëm i MASHT për Organizimin e Mësimin në Vitin Shkollor 2020/2021 në Kushtet e Pandemisë COVID-19’](#) (10 shtator 2020); Telegrafi, [‘Mungesa e mjeteve teknologjike bënë që 9.070 nxënës të mos marrin pjesë në mësimin online’](#) (telegrafi.com, 17 shtator 2020).

124 Banka Botërore, [‘Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanit Perëndimor Nr.17: Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19’](#) (Pranvera 2020).

pjesëmarrjen fizike për punë praktike ose laboratorike, ekzaminime dhe shërbime administrative.<sup>125</sup> Megjithatë, ka pasur disa raporte se universitetet dhe studentët e tyre nuk respektonin dhe zbatonin masat mbrojtëse kundër Covid-19, siç janë distanca fizike, objektet e pamjaftueshme higjienike në klasa dhe tualete, mungesa e termometrave dhe mosmbajtja e maskave mbrojtëse nga studentët.<sup>126</sup>

**87.** Më 27 gusht 2020, MASHT-i vendosi që viti shkollor 2020 - 2021 në Kosovë do të fillojë më 14 shtator 2020 sipas Masteplanit të saj të miratuar nga qeveria që parashikonte mësimin sipas tre skenarëve – me prezencë fizike, mësimi nga distanca, ose qasja e kombinuar - në varësi të situatës epidemiologjike për secilën shkollë.<sup>127</sup> Megjithatë, raportohet se MASHT-i nuk kishte bërë përgatitjet e nevojshme pas rifillimit të vitit shkollor që të zbatohet vetëm mësimi nga distancë, nëse situata epidemiologjike do përkeqësohet.<sup>128</sup> Pothuaj menjëherë u raportuan raste të reja të Covid-19 në mesin e mësimdhënësve dhe nxënësve, duke detyruar mbylljen e disa shkollave fillore dhe të mesme përkohësisht dhe kthimin në përdorimin vetëm të mësimin nga distanca, të cilat, sërish, çuan në disa nga sfidat e lartpërmendura që ndikojnë në cilësinë dhe qasjen në arsim. Në sistemin shkollor të menaxhuar nga qeveria Serbe në Kosovë, klasat 1 deri në 4 gjithashtu rifilluan në fund të shtatorit mësimin me prani fizike, ndërsa klasat 5 deri në 8 dhe shkolla e mesme filluan të përdorin një përzierje të mësimin me prani fizike dhe në distancë. Raportohet se disa shkolla nuk janë dezinfektuar rregullisht dhe nuk kishin dezinfektues për nxënësit dhe stafin arsimor. Megjithatë, sipas një sondazhi të përbashkët të Fondit të Fëmijëve të KB-së (UNICEF) dhe MASHT-it të publikuar në tetor, shumica e nxënësve ishin të kënaqur që shkollat u rihapën dhe preferonin të vazhdonin mësimin me prani fizike për vitin akademik 2020-2021.<sup>129</sup>

## 88. Rekomandimet:

- MASHT duhet të zhvillojë dhe të publikojë një studim zyrtar për ndikimin e pandemisë së Covid-19 në realizimin e të drejtës për arsim në Kosovë, veçanërisht sa i përket rezultateve mësimore të nxënësve gjatë viteve akademike 2019 - 2020 dhe 2020 - 2021.
- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë hapa më konkretë në sigurimin e të drejtës për arsim për të gjithë nxënësit gjatë pandemisë, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes financiare dhe mbështetëse për nxënësit, duke furnizuar institucionet arsimore me pajisje të duhura higjienike dhe monitorimin e respektimit të masave mbrojtëse dhe duke qenë më proaktive në proceset e ngritjes së kapaciteteve në shkolla duke ofruar trajnime shtesë për mësimdhënësit dhe profesorët.

125 Gentiana Ahmeti, 'Çalimi në menaxhimin e pandemisë në universitetet publike' (kallxo.com, 31 dhjetor 2020).

126 Xheneta Murtezaj, 'Ngecja e universiteteve në respektimin e masave kundër pandemisë' (kallxo.com, 31 janar 2021).

127 MASHT, 'Udhëzues i Përgjithshëm i MASHT për Organizimin e Mësimin në Vitin Shkollor 2020/2021 në Kushtet e Pandemisë COVID-19' (10 shtator 2020).

128 Nga Xhejlane Kaçiu, 'Pupovci: Vala e dytë e koronavirusit është e parashikueshme, por në arsim nuk janë bërë përgatitje për këtë fazë' (telegrafi.com, 22 shtator 2020).

129 Zyra e UNICEF-it në Kosovë dhe MASHT, 'Kthimi në shkollë: Opinionet dhe perceptimet e U-reporterëve' mbi rihapjen e shkollave në Kosovë' (tetor 2020).

- MASHT-i duhet të zbatohet masa të posaçme për të përmirësuar qasjen në arsim dhe për ta bërë arsimin më gjithëpërfshirës, veçanërisht për nxënësit nga grupet dhe komunitetet e margjinalizuara, nxënësit në situata të cënueshme dhe të gjithë nxënësit e tjerë që përballen me sfida për qasje në arsim për shkak të gjendjes së tyre të dobët financiare dhe mungesës së pajisjeve të duhura arsimore.
- MASHT-i duhet të krijojë një program për ndërtimin e kapaciteteve për mësimdhënësit mbi metodat dhe praktikat e mësimdhënies në epokën e teknologjisë, veçanërisht mbi përdorimin e teknologjisë së mësimnxënies dhe mësimdhënies në distancë.
- MASHT-i duhet t'u ofrojë institucioneve arsimore të gjitha shërbimet e nevojshme higjienike dhe mbrojtëse për Covid-19 dhe të rrisë monitorimin e saj nëse institucionet arsimore në të gjitha nivelet janë duke respektuar masat mbrojtëse të Covid-19.
- MASHT-i duhet të themelojë programe për të mbështetur prindërit dhe ata që kujdesen për të tjerët për zhvillimin në fëmijërinë e hershme.

### 6.3. E drejta për kujdes shëndetësor

**89.** Kushtetuta e Kosovës i garanton secilit person të drejtën për “respektimin e integritetit fizik dhe psikik” të tij, që përfshin të drejtën për të marrë vendimet për trajtimin e tyre mjekësorë dhe për të mos iu nënshtruar trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tyre.<sup>130</sup> Ajo gjithashtu përcakton se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi themelor social që ka të bëjë me, ndër të tjera, sëmundjet dhe aftësitë e kufizuar rregullohen me ligj.<sup>131</sup> Disa instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt gjithashtu garantojnë të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor në Kosovë.<sup>132</sup> Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, i cili parashikon ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të të gjithë njerëzve në Kosovë, shprehimisht përcakton se zbatimi i tij duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardet dhe parimet e garantuara të të drejtave të njeriut.<sup>133</sup> Ai përcakton se ofrimi i kujdesit shëndetësor duhet të sigurojë, ndër parimet e tjera kyçe, edhe barazinë e plotë të qasjes, gjithë-përfshirjen dhe mosdiskriminim dhe cilësi të shërbimeve.<sup>134</sup> Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, nga ana tjetër, mbron dhe promovon shëndetin mendor në Kosovë, duke përfshirë garantimin e disa të drejtave të veçanta për njerëzit me probleme të shëndetit mendor.<sup>135</sup> Ligji Nr. 04 / L-249 për Sigurimet Shëndetësore krijon një sistem të obligueshëm të sigurimeve shëndetësore publike për të siguruar qasje për të gjithë njerëzit në Kosovë ndaj kujdesit shëndetësor themelor me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe për të siguruar mbrojtje financiare ndaj kostove të larta të kujdesit shëndetësor.<sup>136</sup> Ekzistojnë ligje të tjera që gjithashtu mbështesin realizimin e të drejtës për shëndet në Kosovë, përfshirë edhe në lidhje me mbrojtjen e shëndetit publik, parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, të drejtat dhe shëndeti riprodhues dhe siguria dhe shëndeti në punë.<sup>137</sup> Përveç kësaj, një

130 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 26.

131 Po aty., neni 51.

132 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 22; Shih gjithashtu DUDNJ, neni 25; KDF, neni 24; KEGFDG, nenet 10(h), 11(f), 12, 14(b).

133 [Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi](#) (7 maj 2013), nenet 1, 4.

134 Po aty., neni 5.

135 [Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor](#) (23 nëntor 2015), nenet 1, 6, 8.

136 [Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor](#) (30 prill 2014), nenet 1-2, 6.

137 [Ligji Nr. 02/L-78 Ligji për Shëndetësinë Publike](#) (15 gusht 2008); [Ligji Nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse](#) (15 tetor 2008); [Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetësi Riprodhues](#) (1 maj 2008); [Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë](#), shënimi 92.

udhëzim administrativ i miratuar në vitin 2013 krijon një kartë e të drejtave dhe përgjegjësi të pacientëve.<sup>138</sup>

**90.** Disa sfida vazhdojnë të pengojnë zbatimin e kësaj kornize të fuqishme ligjore dhe të pengojnë funksionimin efektiv të sistemit të kujdesit shëndetësor të Kosovës, duke përfshirë burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, zbatimin jo adekuat të ligjeve dhe politikave ekzistuese, koordinimin dhe monitorimin e pamjaftueshëm të sektorit dhe pjesëmarrjen e ulët të grupeve kryesore.<sup>139</sup> Më e theksuara, Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimet Shëndetësore ende nuk është aplikuar dhe zbatuar më shumë se gjashtë vjet pas miratimit të saj fillestar. Sipas Avokatit të tanishëm të Popullit, mos zbatimi i këtij ligji të rëndësishëm është i pajustificueshëm dhe ka sjellë pasoja negative për njerëzit në Kosovë, siç është mbulimi i kostove financiare të shërbimeve themelore të kujdesit shëndetësor.<sup>140</sup> Mungesa e sigurimit të kujdesit universal shëndetësor në Kosovë gjithashtu raportohet se ka krijuar një rrezik të rëndë financiar dhe barrë për pacientët me Covid-19 të cilët kanë qenë të detyruar të paguajnë nga xhepi për trajtimin e tyre, duke e bërë trajtimin e tyre më të vështirë dhe duke ndikuar në mënyrë joproporcionale te personat që jetojnë në varfëri pasi ata nuk ishin në gjendje të paguajnë për disa ose të gjitha ilaçet e tyre të përshkruara.<sup>141</sup>

**91.** Pandemia përkeqësoi dhe ekspozoi sfidat që ekzistonin e që kishin të bëjnë me kapacitetet e kufizuara të sistemit shëndetësor të Kosovës dhe gëzimin e të drejtës për kujdes shëndetësor për të gjithë njerëzit në Kosovë. Sfidat kryesore përfshinin raporte për furnizimin e pamjaftueshëm me oksigjen dhe shtretër spitalor, si dhe vështirësitë që lidhen me furnizimin e pajisjeve mbrojtëse, testeve, ilaçeve dhe respiratorëve për shkak të mos zbatimit si duhet të kornizës ligjor përkatëse.<sup>142</sup> Gjatë kohës më të madhe të pandemisë, numri i testeve ditore PCR Covid-19 të kryera mbeti nën 1,000 teste në ditë, duke ngritur shqetësime lidhur me aftësinë e institucioneve për të bërë gjurmimin e kontakteve dhe monitoruar në mënyrë efektive zhvillimin e situatës epidemiologjike. Ndërsa numri i testeve ditore PCR për Covid-19 në fund u rrit në mes 1.000 dhe 1,900 testeve gjatë muajve të fundit të vitit 2020, testimi mbeti nën rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) që ishte për të kryer 2,000 deri në 4.000 teste në ditë në fund të vitit. Sfidat fillestare për sigurimin e furnizimit adekuat të pajisjeve mbrojtëse ngritën shqetësime të veçanta për të drejtat e profesionit dhe sigurisë së punëtorëve shëndetësorë, disa prej të cilëve u infektuan me Covid-19 dhe si pasojë edhe vdiqën, duke punuar në vijën e parë të ofrimit të kujdesit shëndetësor për njerëzit gjatë pandemisë. Në fund të dhjetorit 2020, punëtorët shëndetësorë përbënin 3,236 nga 49,843 raste të Covid-19, ose 6.5 për qind të të gjitha rasteve. U raportua se disa fshatrave në zonat rurale gjithashtu u mungonin mjekët dhe stafi në klinikat e tyre lokale pasi

138 [Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2013 Karta e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Pacientit](#) (13 gusht 2013).

139 IAP, 'Raporti Ex officio nr. 434/2020 në Lidhje me Kufizimet në Sigurimin e Shërbimeve Shëndetësore gjatë Pandemisë Covid-19 në Kosovë' (23 shkurt 2021), paragrafi 62 (në tekstin e mëtejshëm Raporti Ex Officio i IAP-së mbi Qasjen në Shëndetësi).

140 Po aty., paragrafi 63.

141 Kallxo, 'Pa sigurime shëndetësore në pandemi' ([kallxo.com](#), 6 mars 2021).

142 Raporti Ex Officio i IAP-së mbi Qasjen në Shëndetësi, shënimi 139, paragrafët 58-60.



që stafi mjekësor u rivendos në qendrat mjekësore të Prishtinës për shkak të numrit më të madh të pacientëve në ato vende.

**92.** Sipas Avokatit të tanishëm të Popullit, institucionet e Kosovës gjithashtu nuk arritën të përmbushnin plotësisht detyrimet e tyre kushtetuese dhe ligjore për tu siguruar njerëzve në Kosovë qasje në shërbimet shëndetësore gjatë pandemisë, veçanërisht sa u përket personave që nuk ishin të infektuar me Covid-19 dhe kërkonin trajtim mjekësor për probleme të tjera shëndetësore.<sup>143</sup> Në mënyrë të veçantë, Avokati i Popullit konkludoi se vendimit për të pezulluar operacionet jo të domosdoshme dhe vizitat specialistike nga marsi deri në vitin 2020 “i mungonte baza ligjore” dhe se institucionet e Kosovës nuk ofruan alternativa për të siguruar qasje në shërbimet shëndetësore. Si rezultat, listat e pritjes për operacione “janë rritur ndjeshëm”.<sup>144</sup> Personat që jetojnë me HIV/AIDS dhe tuberkulozë gjithashtu u ballafaquan me sfida të veçanta lidhur me qasjen në kujdesin shëndetësor gjatë pandemisë.<sup>145</sup> Avokati i tanishëm i Popullit gjithashtu raportoi se institucionet e kujdesit shëndetësor nuk kryen teste ose mbajnë kontakt të mjaftueshëm me pacientët e HIV/AIDS, ndërsa pacientët me tuberkulozë përjetuan mungesë të hapësirave të veçanta sanitare në klinikat të pulmologjisë dhe numër i pamjaftueshëm i pulmologëve. Raportohet se “[s]hërbimet joadekuate shëndetësore dhe faktorët mjedisor kanë prodhuar disproporcionalisht norma të larta të vdekshmërisë nga COVID-19” në Kosovë.<sup>146</sup>

**93.** Përtej pasojave të dukshme në shëndetin fizik dhe të drejtën për jetë, pandemia dhe masat që lidhen me të gjithashtu ndikuan negativisht në të drejtën për shëndetin mendor. Masat si ora policore dhe karantinimi i detyrueshëm në muajt e parë të pandemisë, si dhe ndikimi i pandemisë në gjendjen socio-ekonomike dhe pasiguria e përgjithshme në lidhje me të ardhmen e rritën nivelin e problemeve të shëndetit mendor në Kosovë, si ankthi dhe çrregullimet e gjumit. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë raportoi në fund të tetorit se nuk kishte buxhet të nevojshëm për të rritur shërbimet e shëndetit mendor. Në një rast simbolik që lidhet me shëndetin mendor dhe të drejtën për jetë, një student 26-vjeçar i cili u kthye nga Gjermania bëri vetëvrasje në fillim të muajit maj pasi u detyrua t’i nënshtrohej karantinës së detyrueshme në Qendrën e Studentëve në Prishtinë, megjithëse hetimi për këtë çështje ende ishte duke vazhduar në fund të vitit 2020. Ky incident i veçantë nxori në pah ndikimin disproporcional që masat COVID-19 kanë pasur tek personat në situata të cënueshme, përfshirë ata me probleme të shëndetit mendor si dhe nevojën për të siguruar që masat të jenë të fokusuar sa duhet për të adresuar nevojat e tyre specifike.

**94.** Zyra e Komisionerit për Gjuhët dhe Avokati i Popullit pranuan disa ankesa në vitin 2020 në lidhje me publikimin e informacionit të rëndësishëm që ka të bëjë me pandeminë dhe masat parandaluese vetëm në gjuhën shqipe nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK-së, e cila pengon të drejtën e komuniteteve jo-shqipfolëse në Kosovë për tu qasur në informacionin

143 Po aty.

144 Bujar Vitija, ‘Pasojat e gjera të dështimit të Kosovës për të siguruar vaksinat’ (prishtinainsight.com, 1 mars 2021).

145 IAP, ‘Komunikatë për media – Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime nr. 698/2020 në lidhje me qasjen në shërbime shëndetësore të personave të prekur me HIV dhe me tuberkulozë gjatë pandemisë COVID-19’ (27 Janar 2021).

146 Amnesty International, ‘Raporti i Amnesty International 2020/21: Gjendja e të Drejtave të Njeriut në Botë’ (7 prill 2021), f. 217.

e rëndësishëm shëndetësor gjatë pandemisë aktuale.<sup>147</sup> Përkundër ndërhyrjeve të kaluara dhe premtimeve nga të dy institucionet për të zbatuar rekomandimet e lëshuara më parë për të përmirësuar qasjen në informata, faqet e internetit të IKSHPK-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë ende paraqesin informata kryesisht në gjuhën shqipe dhe janë kryesisht jofunksionale në gjuhën serbe.

## 95. Rekomandimet:

- Qeveria e Kosovës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar menjëherë zbatimin e detyrueshëm të Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor pa vonesa të mëtejshme, duke përfshirë sigurimin që të gjithë njerëzit në Kosovë të pajisen me sigurim të kujdesit universal shëndetësor.
- Qeveria duhet të rrisë buxhetin e ndarë për sistemin shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë fonde shtesë për shërbimet e shëndetit mendor.
- Qeveria dhe institucionet përkatëse shëndetësore duhet të sigurojnë që të gjithë njerëzit në Kosovë, sidomos pacientët me COVID-19 dhe personat me gjendje shëndetësore kronike si HIV/AIDS dhe tuberkulozi, të kenë qasjen të barabartë në ilaçe bazike cilësore dhe të përballeshme, furnizime mjekësore (p.sh. teste dhe oksigjen), dhe trajtime mjekësore, përfshirë përbalimin e shpenzimeve të trajtimit shëndetësor privat në rastet kur shërbimet e kujdesit shëndetësor nuk ofrohen nga institucionet shëndetësore publike.
- Ministria e Shëndetësisë dhe spitalet në Kosovë duhet të sigurojnë që vizitat mjekësore të specializuara dhe operacionet jo të domosdoshme tu ofrohen në kohën e duhur atyre që kanë nevojë për to, madje edhe gjatë vazhdimit të pandemisë në përputhje të plotë me masat parandaluese COVID-19.
- Institucionet përkatëse, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, duhet të sigurojnë që klinikat mjekësore rurale të kenë personel dhe pajisje të mjaftueshme.
- Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHPK-ja duhet të përmbushin plotësisht detyrimet e tyre sipas Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve duke siguruar që të gjitha komunikimet zyrtare, përfshirë faqet e tyre të internetit, të ofrojnë informacione në gjuhët zyrtare të Kosovës.

## 6.4. Të drejtat pronësore

**96.** Kosova ka një kornizë të gjerë ligjore të dizajnuar për të mbrojtur të drejtat pronësore.<sup>148</sup>

Në shkurt 2017, Qeveria e Kosovës publikojë Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore e cila vendosi pesë objektiva kryesore të politikave, përfshirë forcimin e kornizës ligjore, adresimin

147 Raporti i IAP-së 2020, shënimi 26, f. 95.

148 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, nenet 7, 46, 121, 122, 156, 159. Shih gjithashtu, p.sh., [Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore](#) (4 gusht 2009); [Ligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës](#) (3 nëntor 2016); [Ligji Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme](#) (1 gusht 2008); [Ligji Nr. 03/L-007 për Procedurën Jokontestimore](#) (12 janar 2009); [Ligji Nr. 2004/06 për Trashëgiminë](#) (1 gusht 2006).

e informalitetit në sektorin e pronës së paluajtshme dhe zbatimin e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve jo-shumicë. Megjithatë, sipas OSHC-ve, miratimi i strategjisë nuk ja doli që të përmirësojë situatën e përgjithshme në lidhje me të drejtat pronësore, dhe sfidat e vjetra edhe më tej mbetën.

**97.** Në vitin 2020 u pa një përparim sa i përket zbatimit të vendimeve të organeve gjyqësore dhe jo-gjyqësore në çështjet pronësore që ndërlidhen me konfliktin. Në prill, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), e cila ka mandatin për të shqyrtuar kërkesat pronësore dhe për të zgjidhur mospërputhjet e titujve pronësorë, miratoi një udhëzim administrativ për përcaktimin e procedurave për shkatërrimin e strukturave të paligjshme. Në tetor, zbatoi për herë të parë një vendim mbi shkatërrimin e një ndërtimi të paligjshëm në një rast që ishte gjykuar nga Gjykata Supreme vite më parë.<sup>149</sup> Sidoqoftë, që nga tetori i vitit 2020, AKKVP kishte 61 dëbime nga prona në pritje, 23 prej të cilave kishin të bënin me prona që gjenden në rajonin e Mitrovicës në pronësi kryesisht të shqiptarëve të Kosovës.<sup>150</sup> AKKVP ende nuk ka marrë mbi katër milionë dokumente kadastrale të skanuara nga Beogradi sipas Marrëveshjes së Brukselit. Kuvendi i Kosovës ende nuk ka miratuar ndryshimet në Ligjin Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës që synon përmirësimin e funksionimit të AKKVP-së.

**98.** Incidentet e vazhdueshme të uzurpimit të paligjshëm, moszbatimi i urdhrave të dëbimit nga prona dhe rrënimit dhe pamundësia e AKKVP-së për të ofruar kompensim adekuat vazhduan të ndikojnë në të drejtat pronësore të personave të zhvendosur dhe të kthyerve, duke penguar më tej mundësinë e tyre për t'u kthyer. Komunitetet jo-shumicë, veçanërisht serbët dhe romët e Kosovës, si dhe shqiptarët e Kosovës në veri të Kosovës ishin posaçërisht të prekur.<sup>151</sup> Disa persona të zhvendosur dhe të kthyer, përfshirë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, gjithashtu hasën në vështirësi në marrjen e dokumenteve të nevojshme të regjistrimit civil dhe të identitetit për të regjistruar pronën në emrin e tyre dhe për të ushtruar të drejtat e veta në lidhje me pronën e trashëguar ose transferuar.<sup>152</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2016 që konfirmon pronësinë e KOS mbi tokën afër Manastirit të Deçanit mbeti i pazbatuar<sup>153</sup> duke ndikuar në të drejtat pronësore të KOS-it.

**99.** Edhe pse Ligji Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje u miratua në vitin 2018, Kosova ende po përballlet me sfidën e legalizimit të ndërtesave të shumta pa leje. Sipas OSHC-ve, më shumë se 356,000 ndërtesa në Kosovë nuk janë legalizuar ende. Bashkësia ndërkombëtare po e adreson këtë çështje duke këshilluar institucionet e nivelit lokal dhe qendror; megjithatë, ende mungon ndihma juridike për aplikuesit se si të dorëzojnë aplikacionet përkatëse tek autoritetet.

149 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti për të Drejtat e Njeriut 2020, shënimi 28, f. 12.

150 Po aty., f. 13.

151 OSBE Misioni në Kosovë, 'Mekanizmi i Shqyrtimit të Kërkesave në Masë për të Drejtat Pronësore: Përvoja e Kosovës' (16 qershor 2020), f. 16.

152 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti i për të Drejtat e Njeriut 2020, shënimi 28, p. 20.

153 Po aty., f. 11.

**100. Rekomandimet:**

- AKKVP duhet të zbatohet, pa vonesë, vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore dhe të Agjencisë Kosovare të Pronës.
- Policia e Kosovës dhe Prokuroritë duhet të sigurojnë që pronat që u përkasin pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë nuk do të ri-uzurpohen pas dëbimeve të kryera nga AKKVP-ja.
- Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal duhet të vazhdojnë fushatën e ndërgjegjësimit për rëndësinë e legalizimit të ndërtimeve pa leje.
- Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të formalizuar vendbanimet joformale në kohën e duhur.

**6.5. Të drejtat kulturore**

**101.** Kosova ka një kornizë të fortë kushtetuese dhe ligjore për të promovuar realizimin e të drejtave kulturore<sup>154</sup> dhe për të mbrojtur trashëgiminë kulturore,<sup>155</sup> edhe pse në vitin 2020 vazhduan disa sfida të zbatimit. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë mbrojnë të drejtën për “të marrë pjesë lirshëm” në jetën kulturore;<sup>156</sup> të drejtat kulturore, fetare dhe gjuhësore të “pakicave etnike, fetare ose gjuhësore”;<sup>157</sup> të drejtën për pjesëmarrje të barabartë dhe jo-diskriminuese në aktivitetet kulturore pa dallime të bazuara në racë, origjinë kombëtare apo etnike<sup>158</sup> apo gjini;<sup>159</sup> dhe të drejtat kulturore të fëmijëve.<sup>160</sup> Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCPNM), e cila gjithashtu zbatohet drejtpërdrejt, imponon detyrime për të promovuar barazinë për komunitetet jo-shumicë në jetën kulturore dhe për të krijuar kushte që ua mundësojnë atyre të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre, religjionin, gjuhën dhe traditat, veçanërisht në fushën e arsimit.<sup>161</sup> Megjithëse IPNDESHK nuk është në listën e instrumenteve që zbatohen drejtpërdrejt, Kosova është zotuar të zbatohet Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm<sup>162</sup> dhe propozon që të harmonizoj kornizën ligjore të Kosovës me IPNDESHK në Programin e saj për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut 2021 - 2025, e cila, nëse zbatohet dhe është e suksesshme, do të zbatonte një rekomandim kyç të Raportuesit Special të KB-së në fushën e të drejtave kulturore.<sup>163</sup>

154 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 58, nën-seksionet (1), (3), (4), dhe neni 59, nën-seksioni (1). Shih gjithashtu, p.sh., [Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës](#) (4 qershor 2008), e ndryshuar më 2011 (në tekstin e mëtejshëm Ligji për të Drejtat e Komuniteteve); [Ligji Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës](#) (1 pill 2007); [Ligji Nr. 02/L-59 për Filarmoninë, Operën dhe Baletin](#) (1 maj 2007); [Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta](#) (30 nëntor 2011), i ndryshuar nga [Ligji Nr. 05/L-047](#) (3 nëntor 2016) dhe [Ligji Nr. 06/L-120](#) (4 korrik 2019).

155 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 9 dhe 58, nën-seksioni (5). Shih gjithashtu, p.sh., Ligji për të Drejtat e Komuniteteve, shënimi 154; [Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore](#) (1 korrik 2008); [Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura](#) (4 qershor 2008) (në tekstin e mëtejshëm Ligji për ZVM-të).

156 DUDNJ, nenet 22, 27.

157 PNDKP, neni 27.

158 KEGFDR, neni 1, 5(e)(vi).

159 KEGFDG, neni 1, 3, 5, 13.

160 KDF, neni 4, 17, 20, 29(c), 30, 31.

161 FCPNM, neni 4, 5, 12, 15, 17.

162 Ekipi i KB në Kosovë, ‘[Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm](#)’, qasja e fundit 28 prill 2021.

163 Raportuesi Special për fushën e të Drejtave Kulturore, ‘Raport për Vizitën në Serbi dhe Kosovë nga 3 deri 14 tetor 2016’ (19 janar 2018) [UN Doc. A/HRC/37/55/Add.1](#), paragrafi 47 (në tekstin e mëtejshëm Raporti i Raportuesit Special për të Drejtat Kulturore).

**102.** Sa i përket detyrimeve sipas legjislacionit përkatës, Ligji Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë mbulon të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë që të kultivojnë, shprehin, zhvillojnë, ruajnë dhe përmirësojnë kulturën, identitetin dhe trashëgiminë e tyre kulturore.<sup>164</sup> Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve garanton më tej të drejtat gjuhësore, të cilat janë thelbësore për identitetin kulturor të secilit komunitet në Kosovë.<sup>165</sup> Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore përcakton detyrime më specifike në lidhje me mbrojtjen, ruajtjes, restaurimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, duke krijuar, ndër të tjera, zona mbrojtëse për trashëgiminë kulturore të paluajtshme. Ligji i miratuar më pas Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM) krijon zona të veçanta që sigurojnë mbrojtje të zgjeruar për manastiret, kishat e KOS-it dhe vendeve të tjera fetare si dhe “vendeve historike dhe kulturore të rëndësishme të veçantë” për komunitetin serb të Kosovës si dhe për komunitetet e tjera në Kosovë.<sup>166</sup> Këshilli për Zbatim dhe Monitorim (KPM) monitoron respektimin e këtij ligji.

**103.** Në nivelin e politikave, Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017 - 2027 mbeti në fuqi në vitin 2020, e cila synon avancimin e mbrojtjes dhe ruajtjes e trashëgimisë kulturore në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare; dhe zhvillimin e qëndrueshëm kulturor, ekonomik dhe shoqëror.<sup>167</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), megjithatë, ende nuk ka miratuar dhe publikuar një strategji gjithëpërfshirëse mbi të drejtat kulturore, edhe pse ka njoftuar në shkurt të vitit 2020 se do të fillonte hartimin e një strategjie të tillë.<sup>168</sup>

**104.** Disa sfida për zbatimin e kësaj kornize të fuqishme ligjore dhe politike vazhduan edhe në vitin 2020, siç janë kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore dhe të resurseve, mungesa e një sistemi adekuat të mbledhjes së të dhënave për të mundësuar politika të bazuara në prova dhe mosrespektimi i Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve nga ana e MKRS-së. Ndarjet buxhetore vazhdojnë të mbeten kryesisht të nxitura nga donatorët dhe të pamjaftueshme për zbatim efektiv të kornizës ligjore për të promovuar realizimin e të drejtave kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë, të dyja këto kërkojnë “mbështetje financiare afatgjatë për të pasur një ndikim të qëndrueshëm”.<sup>169</sup> Përkundër angazhimit të Qeverisë së Kosovës për të “rritur gradualisht” buxhetin për kulturën dhe trashëgiminë kulturore,<sup>170</sup> buxheti i MKRS-së për vitin 2020 për kulturën dhe trashëgiminë kulturore u zvogëlua për 917,287 € (nëntë për qind) dhe 505,939 € (8,3 për qind) respektivisht.<sup>171</sup> Sidoqoftë, zvogëlimi - të paktën sa i përket trashëgimisë kulturore - ishte kryesisht për shkak të ndikimit të përgjithshëm të pandemisë në buxhet. Ndërkohë, MKRS-ja

164 Ligji për të Drejtat e Komuniteteve, shënimi 154, nenet 2.1, 5.1.

165 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, shënimi 68.

166 Ligji për ZVM-të, shënimi 155, neni 1.

167 MKRS, ‘[Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027](#)’ (2 gusht 2016).

168 MKRS, ‘[Ministrja Dumoshi Paralajmëron Strategji për Kulturë](#)’ (14 shkurt 2020).

169 2020 Raporti i Progresit të BE-së, shënimi 44, f. 38.

170 QK, [Programi i Qeveris 2020 – 2023](#) (qershor 2020), f. 59.

171 Krahaso [Ligji Nr. 06 / L-133 për Ndarjet Buxhetore mbi Buxhetin e Kosovës për Vitin 2019 - Tabelat e Buxhetit për Vitin 2019](#) (14 shkurt 2019) me [Ligji Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Kosovës për vitin 2020 \(7 gusht 2020\)](#).

ende nuk është duke respektuar si duhet Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, duke krijuar sfida për komunitetet jo-shqip folëse për të gëzuar të drejtën e tyre për informacion me kohë dhe të plotë mbi të drejtat kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Për shembull, faqja e internetit e MKRS-së ka disa seksione që janë në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe dhe pjesa e saj e lajmeve përditësohet rregullisht në gjuhën shqipe por në gjuhën serbe është përditësuar për herë të fundit gjatë periudhës raportuese më 17 korrik 2020.

**105.** Në vitin 2020, ishin 23 pasuri fetare dhe trashëgimi të tjera kulturore nën mbrojtje të përhershme<sup>172</sup> dhe rreth 1,600 pasuri kulturore nën mbrojtje të përkohshme.<sup>173</sup> Tetë pasuri të reja kulturore u shtuan në listën e mbrojtjes së përkohshme në tetor të vitit 2020, përfshirë ngjarjen tradicionale kulturore “Flaka e Janarit” në Gjilan. Kosova gjithashtu ka 24 ZVM që u ofrojnë vendeve të veçanta të trashëgimisë kulturore mbrojtje të zgjeruar dhe monitorim të ngushtë nga KZM-ja dhe mbrojtje 24-orëshe nga një njësi shumetnike e policisë. Katër monumente kulturore fetare në Kosovë - Manastiri i Deçanit, Patrikana e Pejës, Kisha e Apostujve të Shenjtë dhe e Virgjëreshës së Shenjtë të Levishës – vazhdojnë të njihen dhe mbrohen si Vende të Trashëgimisë Botërore nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO).<sup>174</sup>

**106.** Rifillimi i punës në rrugën tranzit që kalon përmes ZVM-së së caktuar të Manastirit Deçanit në korrik 2020 ngriti shqetësime jo vetëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore por edhe për respektimin e të drejtave të pronësisë dhe sundimit të ligjit, veçanërisht duke marrë parasysh moszbatimin e vazhdueshëm të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të majit 2016 duke konfirmuar të drejtën e pronësisë së KOS-it në mbi 24 hektarë tokë përreth manastirit. Pas ndalimit të ndërtimit në mes të gushtit dhe disa muaj të diskutimeve midis palëve përkatëse të interesit, në nëntor të vitit 2020 KZM miratoi një marrëveshje lidhur me rindërtimin e njëkohshëm të një rruge ndërkombëtare anësore jashtë ZVM-së të Manastirit të Deçanit dhe një rruge vetëm për trafik lokal brenda ZVM-së.<sup>175</sup> KZM theksoi se kjo marrëveshje e re e rëndësishme në fushën e trashëgimisë kulturore është në harmoni të plotë me kornizën ligjore në fuqi dhe do të monitorojë zbatimin e marrëveshjes, e cila synon të nxisë “marrëdhëniet midis komuniteteve përmes mbrojtjes së trashëgimisë kulturore fetare” dhe gjithashtu të promovojë zhvillimit ekonomik të rajonit dhe lëvizjen e lirë të njerëzve në Kosovë.

**107.** Ashtu si viteve të kaluara, administrimi dhe mbrojtja joadekuate e trashëgimisë kulturore mbeti çështje shqetësuese veçanërisht në vitin 2020, siç janë sistemet e pamjaftueshme të mbrojtjes nga zjarri dhe ndërtimi dhe shkatërrimi i paautorizuar që prek disa zona të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Problemet e vazhdueshme në lidhje me restaurimin e Kalasë së Novobërdës - një nga monumentet kulturore më të famshme të Kosovës - paraqet një shembull simbolik të

172 MKRS, [Vendimi Nr. 69/2016](#) (10 tetor 2016).

173 MKRS, [Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme](#) (27 tetor 2020).

174 UNESCO Qendra e Trashëgimisë Botërore, [‘Monumentet Mesjetare në Kosovë’](#) (qasja e fundit 28 prill 2021).

175 KZM, [‘Deklaratë nga Këshilli për Zbatim dhe Monitorim’](#) (12 nëntor 2020).



këtij problemi të vazhdueshëm. Në mars të vitit 2020, prokurorët e Kosovës ngritën një aktakuzë duke kërkuar kompensim nga një kompani për kryerjen e “gabuar” të punëve të restaurimit dhe duke dëmtuar muret e fortesës gjatë një projekti të iniciuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve në tetor të vitit 2019.<sup>176</sup> Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, e cila është një agjenci e pavarur që monitoron dhe mbron trashëgiminë kulturore, paralajmëroi se kalaja ka mbetur e rrezikuar në vitin 2020 pavarësisht punës restauruese.<sup>177</sup>

**108.** Sidoqoftë, kishte disa zhvillime pozitive në restaurimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore gjatë vitit 2020. Për shembull, Komisioni i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve refuzoi një projekt që kërkonte të ruante vetëm një mur të Kishës Katolike të vitit 1926 “Engjëlli i Rojës” në Ferizaj dhe të ndërtonte një kishë krejt të re në vend të saj.<sup>178</sup> Raportohet se Komuna e Prizrenit ndërmori hapa proaktivë për të hequr strukturat e paautorizuara në qendrën historike të qytetit të Prizrenit,<sup>179</sup> e cila mbrohet si ZVM me një ligj specifik.<sup>180</sup> MKRS-ja, në bashkëpunim me institucionet përkatëse komunale, rinovuan mullirin Behramaj të ndërtuar në Obiliq në korrik të vitit 1864<sup>181</sup> dhe tri shtëpi të vjetra në qendrën historike të Prizrenit në tetor të vitit 2020.<sup>182</sup> MKRS-ja gjithashtu krijoi një plan menaxhimi për Kalanë e Prizrenit, që është një objekt i një rëndësie të veçantë për trashëgiminë kulturore të Kosovës,<sup>183</sup> dhe ndërmori hapa për të ruajtur “Mullirin e Dulahit” afër Prishtinës për stinën e dimrit dhe filloi hartimin e planeve për restaurimin e këtij objekti me “rëndësi historike”.<sup>184</sup>

**109.** Ka pasur disa raportime për incidente që kishin cak trashëgiminë kulturore fetare që i përket KOS-it dhe Bashkësisë Islame të Kosovës në vitin 2020. Incidentet që preken pronën e KOS-it u raportua të kishin ndodhur në fillim të vitit 2020 në fshatrat Novakë, Gornjasellë dhe Sreckë.<sup>185</sup> Në prill, një incident zjarri shkatërroi një xhami 450-vjeçare në Gjilan, të cilën komuna e dënoi përmes një deklaratë duke e quajtur atë “një akt kriminal, që dëmton rëndë tolerancën fetare në komunë”. Në gusht, një kishë e KOS-it në Prizren dhe një xhami në Kaçanik janë dëmtuar sipas Policisë së Kosovës,<sup>186</sup> ndërsa një përfaqësues i një xhamie në Pejë raportoi në Policinë e Kosovës se person(a) i/të panjohur kishin hyrë në xhami dhe pretendohet se kishin vjedh një arkë parash që përmbante para të mbledhura gjatë lutjeve të së premtes. Në Policinë e Kosovës në shtator u raportua edhe për përdhosjen e një kisha të KOS-it në Obiliq.<sup>187</sup> Abati i Manastirit të Deçanit, Ati Sava Janjić, shprehu shqetësimet e tij rreth incidenteve të tilla dhe bëri thirrje për përpjekje të reja për të krijuar një shoqëri “në të cilën diversiteti kulturor, etnik, gjuhësor, fetar do të mbrohet dhe ruhet.”<sup>188</sup>

176 Perparim Isufi, ‘Prokurorët e Kosovës akuzojnë kompaninë serbe për rrënim të kalasë mesjetare’ (*balkaninsight.com*, 11 mars 2020).

177 Po aty.

178 <https://www.koha.net/kulture/230232/stopohet-plani-per-rrenimin-e-kishes-shekullore-ne-ferizaj/>.

179 2020 Raporti i Progresit të BE-së, shënimi 44, f. 38.

180 [Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit](#) (18 korrik 2012).

181 MKRS, ‘Restaurohet mulliri i shekullit 19 në Graboc të Obiliqit’ (28 korrik 2020).

182 MKRS, ‘Ministrja Dumoshi: Prizreni, qytet ndër më të pasurit, në trashëgimi kulturore’ (14 tetor 2020).

183 Po aty.

184 MKRS, ‘MKRS-ja do të kujdeset për ‘Mullirin e Dulahit’ (7 tetor 2020).

185 Radio Kontakt Plus, ‘OEBS izražava zabrinutost zbog oštećenja crkve Uspenja Presvete Bogorodice u Sredskoj’ (*radiokontaktplus.org*, 23 gusht 2020).

186 KoSsev, ‘Oštećena crkva u Sredskoj kod Prizrena i staklo džamije u Kačaniku’ (*kossev.info*, 22 gusht 2020).

187 Lajmi, ‘Incident i ri në fshatin e Kosovës ku jetojnë serbët, çka po ndodhë atje?’ (*lajmi.net*, 16 shtator 2020).

188 KoSsev ‘Sava Janjić za Nova.rs: Zabrinuti smo za manastire na KiM’ (*kossev.info*, 3 shtator 2020).

**110.** Të drejtat e pronësisë intelektuale, si e drejta e autorit, janë ende në proces të zhvillimit dhe zbatimit të plotë në Kosovë. Derisa MKRS-ja miratoi Strategjinë 2019 - 2023 për Forcimin e Sistemit të së Drejtës së Autorit në qershor të vitit 2019, ajo ende nuk është funksionalizuar plotësisht. Përveç kësaj, disa çështje vazhduan të pengojnë zbatimin e duhur të të drejtave të pronësisë intelektuale në vitin 2020, siç janë bashkëpunimi i pamjaftueshëm midis agjencive, procedurat e zgjatura të zbatimit dhe aplikimit, dhe procesi i kufizuar gjyqësor mbi të drejtat e pronësisë intelektuale për shkak të mungesës së prokurorëve dhe gjykatësve me njohuri të nevojshme të specializuara.<sup>189</sup>

**111.** Pandemia COVID-19 dhe masat për ta luftuar atë kanë prekur ndjeshëm ushtrimin e të drejtave kulturore dhe të krijuesve të përmbajtjes kulturore në Kosovë. Me përjashtim të majit dhe qershorit kur masat COVID-19 u hoqën në masë të madhe, qeveria kishte pezulluar të gjitha aktivitetet fetare dhe kulturore nga mesi i marsit deri më 25 shtator 2020, duke ndikuar në ushtrimin e të drejtave kulturore në Kosovë. Në shtator, qeveria lejoi sërish aktivitetet fetare me prani fizike duke ju nënshtruar masave parandaluese dhe aktivitetet kulturore me pranoi fizike me 40 për qind të kapacitetit normal. Megjithatë, që nga nëntori, të gjitha aktivitetet fetare u ndaluan përsëri, me disa përjashtime, ndërsa aktivitetet kulturore lejoheshin ende me kapacitet të reduktuar. Drejtuesit e institucioneve kulturore, siç janë Filarmonia e Kosovës, Baleti, dhe Teatri, theksuan se pandemia i detyroi të bëjnë anulimin e shumicës së aktiviteteve kulturore të planifikuara për vitin 2020 dhe se, pavarësisht lejit të rifillimit të pjesshëm të aktiviteteve me prani fizike, rivendosja e orës policore në mbrëmje, më vonë në vitin 2020, ndikoi më tej negativisht në aktivitetet e planifikuara kulturore pasi shumica e shfaqjeve mbahen mbrëmjeve. Pezullimi i aktiviteteve kulturore dhe mbyllja e institucioneve kulturore gjithashtu ndikuan në realizimin e të drejtave ekonomike dhe sociale për krijuesve kulturorë të Kosovës. Krijuesit e vetëpunësuar të përmbajtjes kulturore duket se kanë qenë të përjashtuar nga pakoja fillestare fiskale emergjente e COVID-19,<sup>190</sup> dhe qeveria ka siguruar që personat e vetëpunësuar mund të përfitonin vetëm nga masat e rimëkëmbjes ekonomike sipas programit të saj të rimëkëmbjes ekonomike prej 365 milionë eurosh në tetor.<sup>191</sup>

## 112. Rekomandimet:

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e plotë të kornizës ligjore për ZVM-të dhe të adresojë çështjen e ndërtimeve të paligjshme dhe/ose rrënimin në zonat e mbrojtura.
- Qeveria e Kosovës duhet të respektojë plotësisht Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në të gjitha aktivitetet dhe të sigurojë informacione në kohën e duhur për të drejtat kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në gjuhët zyrtare të Kosovës, përfshirë këtu edhe në faqen e internetit të MKRS-së.

189 2020 Raporti i Progresit të BE-së, shënimi 44, f. 77.

190 [Vendimi i Qeverisë së Kosovës No. 01/19](#) (30 mars 2020).

191 Zyra e Kryeministrit, [‘Qeveria e Kosovës mban mbledhjen e saj të 34-të’](#) (8 tetor 2020).

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë financim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të aktiviteteve dhe institucioneve që kanë të bëjnë me të drejtat kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe përmes ndarjeve të mjaftueshme buxhetore.
- Qeveria e Kosovës duhet të zbatojë të gjitha rekomandimet e nxjerra nga Këshilli i Evropës,<sup>192</sup> i cili monitoron zbatimin e FCPNM në Kosovë dhe të Raportuesit Special të KB-së për të drejtat kulturore.<sup>193</sup>
- Qeveria e Kosovës duhet të vendosë të drejtat e njeriut në qendër të reagimit dhe rimëkëmbjes ndaj COVID-19 me qëllim që të sigurojë që njerëzit të mund të gëzojnë të drejtat e tyre kulturore dhe që krijuesit e përmbajtjes kulturore të mund të realizojnë të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale gjatë dhe pas pandemisë.

## 7. SEKSIONI C: TË DREJTAT E PERSONAVE OSE GRUPEVE TË CAKTUARA

### 7.1. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

**113.** Neni 7 i Kushtetutës e përfshinë barazinë gjinore “si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”. Përveç ndalimit të diskriminimit në bazë të gjinisë, Kushtetuta kërkon gjithashtu që të merren në konsideratë “parimet e barazisë gjinore të njohura ndërkombëtarisht” gjatë emërimeve në disa institucione, përfshirë edhe në Kuvendin e Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese.<sup>194</sup> Disa instrumente për të drejtat e njeriut që mbështesin të drejtat e grave dhe barazinë gjinore zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë.<sup>195</sup> Përtej kësaj kornize kushtetuese, Kosova ka një numër ligjesh aktualisht në fuqi që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përfshirë Ligjin nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore, Ligjin nr. 05/L21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Kodin Penal të ndryshuar.

**114.** Gratë vazhduan të përballen me sfida për të ushtruar të drejtën e tyre për të marrë pjesë në jetën publike, si dhe në vendimmarrje në të gjitha nivelet dhe gjithashtu mbetën të nën-përfaqësuar në institucionet lokale dhe qendrore, si dhe në partitë politike. Sipas Ligjit Nr. 05/L-20 për Barazinë Gjinore kërkohen masa të veçanta për të siguruar përfaqësimin e barabartë (p.sh. 50 për qind) të secilës gjini në jetën publike dhe në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, ndërsa përfaqësimi i barabartë i grave në proceset e vendimmarrjes inkurajohet fuqimisht edhe nga Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të KB mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë (Rezoluta 1325).<sup>196</sup> Megjithatë, shumica

192 Komiteti Këshillimor i Këshillit të Evropës mbi FCPNM, ‘Opinion i Katërt për Kosovën’ (8 mars 2017) Doc No. ACFC/OP/IV(2017)001; Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, ‘Rezoluta CM/ResCMN(2019)11 mbi Implementimin e FCPNM në Kosovë’ (3 korrik 2019).

193 Raportuesi Special për të Drejtat Kulturore, shënimi 163, paragrafët 100, 102.

194 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, nenet 24(2), 71(2), 101(1), 104(2), 108(2) dhe (4), 109(4), 110(1), 114(1).

195 Po aty., neni 22. Shih gjithashtu përgjithësisht, DUDNJ; KEGFDG; KEGFDR; CAT; KDF; KEDNJ; FCPNM.

196 UNSC, Rezoluta 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë (31 tetor 2000) [UN Doc. S/RES/1325](#), paragrafi 1.

e institucioneve të nivelit qendror dhe komunal nuk e kanë përmbushur kërkesën për përfaqësim 50 për qind të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-20 për Barazinë Gjinore, ndërsa gratë dhe grupet për të drejtat e grave vazhduan të ishin të nën-përfaqësuar dhe pamjaftueshëm të konsultuara në dialogun e vazhdueshëm Prishtinë-Beograd duke mos respektuar Rezolutën 1325 dhe Qasjen Strategjike të BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

**115.** Në një hap të rëndësishëm drejt avancimit të të drejtave të grave dhe përpjekjet e vazhdueshme për të adresuar dhunën mbi baza gjinore në Kosovë, Kuvendi i Kosovës ndryshoi nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës për të shtuar Konventën e Stambollit në listën e instrumenteve të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt dhe kanë përparësi ndaj ligjeve vendore në rast konflikti. Konventa e Stambollit i detyron autoritetet e Kosovës të miratojnë një kornizë të hollësishme ligjore dhe të politikave për të adresuar dhunën me bazë gjinore në të gjitha format e saj, për të parandaluar dhe eliminuar dhunën ndaj grave, për të mbrojtur dhe ndihmuar të mbijetuarat e saj dhe për të ndjekur penalisht autorët e krimit. Avokati i Popullit gjithashtu theksoi rëndësinë e këtij zhvillimi, duke theksuar se dhuna ndaj grave dhe vajzave përbën një shkelje të përhapur të të drejtave të njeriut.<sup>197</sup> Në një zhvillim të mirëpritur që ka të bëjë me këtë, në qershor të vitit 2020 Gjykata Supreme e Kosovës miratoi një udhëzim që sqaron kualifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Kosovë, në veçanti në lidhje me nenin 248 të Kodit Penal, dhe kërkon të sigurojë që të mbijetuarat të marrin mbrojtje adekuate në përputhje me Konventën e Stambollit.

**116.** Disa sfida vazhduan edhe në vitin 2020 sa i përket mbrojtjes së të drejtave të grave dhe sigurimin e barazisë gjinore, siç janë zbatimimi joadekuat i kornizës ligjore të Kosovës, kompensimi i pamjaftueshëm për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe mungesa e të dhënave të zbërthyer në bazë të gjinisë. Në veçanti, mungesa e progresit në lidhje me sigurimin e mbledhjes, mirëmbajtjes dhe raportimit transparent të të dhënave të ndara sipas gjinisë vazhdon ta vështirësojë monitorimin e plotë nëse të drejtat e grave dhe barazia gjinore janë duke u respektuar në përputhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe kornizën ligjore të Kosovës.

**117.** Përtej këtyre sfidave të përgjithshme të zbatimit, pandemia dhe masat e ndërlidhura gjithashtu kanë përkeqësuar problemet që kanë ekzistuar edhe më parë lidhur me të drejtat e grave dhe vajzave dhe barazinë gjinore në Kosovë, veçanërisht në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre socio-ekonomike dhe dhunës mbibaza gjinore. Raportet treguan se ndikimi socio-ekonomik i COVID-19 dhe masat për ta luftuar atë kanë prekur në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat në Kosovë, krahasuar me burrat. Gratë në Kosovë fitojnë më pak dhe kanë më pak siguri në punë sesa burrat, pasi 30 për qind e grave janë të punësuar në mënyrë joformale në sektorin privat, që u ofron atyre më pak mundësi ekonomike për të përballuar ndikimet ekonomike të COVID-19.

197 IAP, 'Deklarata e Avokatit të Popullit Naim Qelaj në Ditën Universale të Fëmijëve' (20 nëntor 2020).

Masat parandaluese të COVID-19, siç janë kufizimet e lirisë së lëvizjes dhe mbyllja e shkollave, gjithashtu rritën barrën e punës së papaguar të përkujdesjes që bie në mënyrë joproporcionale mbi gratë dhe vajzat në Kosovë, veçanërisht duke pasur parasysh nënat vetëushqyese që përfaqësojnë shumicën e familjeve me një prind në Kosovë. Gjatë pandemisë, disa aktorë, përfshirë organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, i bënë thirrje Qeverisë së Kosovës që të miratojë masa specifike për të siguruar që gratë dhe vajzat të vendosen në qendër të masave për parandalimin dhe rimëkëmbjen nga COVID-19. Në këtë drejtim, dhe sipas Gjurmuesit Global të Reagimit Gjinator ndaj Covid-19 të Programit për Zhvillim të KB-së, Kosova renditet në mesin e 15 vendeve dhe territoreve në Evropë, Amerikën e Veriut, Australi dhe Zelandën e Re që ka miratuar masa specifike për adresimin e sigurisë ekonomike të grave.<sup>198</sup>

**118.** Disa sfida për të parandaluar dhe adresuar në mënyrë efektive dhunën në bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, vazhduan edhe në vitin 2020, veçanërisht me masat e izolimit që i detyruan gratë të qëndrojnë në shtëpi dhe të përballen me abuzim dhe dhunë e me pak ose aspak mundësi për ta raportuar atë. Sipas Policisë së Kosovës, në vitin 2020 ka pasur 2,069 raste të raportuara të dhunës në familje krahasuar me 1,915 raste në vitin 2019, që paraqet një rritje prej 154 rasteve të raportuara.<sup>199</sup> Megjithatë, raportet treguan se pandemia dhe masat që lidhen me të me gjasë e kanë bërë më të vështirë për të mbijetuarat të raportojnë raste të tilla, duke lënë të kuptohet se numri aktual i rasteve të dhunës në bazë gjinore, përfshirë edhe rastet e dhunës në familje, mund të ketë qenë më i lartë në vitin 2020. Për shembull, vendimi i qeverisë për të karantinuar të mbijetuarat e dhunës në familje gjatë muajve të parë të pandemisë para se të dërgoheshin në një nga strehimoret e dhunës në familje të Kosovës është shënuar si shkak i mundshëm i raportimit të më pak rasteve të dhunës në familje.

**119.** Strehimoreve të të mbijetuarave të dhunës në bazë gjinore dhe formave të tjera të dhunës i'u sigurua ndarje buxhetore për t'u përballur me situatën e vështirë të krijuar nga pandemia dhe duhej të merreshin masa për të siguruar që pranimet e reja të mos rezultojnë në përhapjen e COVID-19. Megjithatë në buxhetin e vitit 2020 është krijuar një vijë e veçantë buxhetore për strehimoret, shumë strehimore që ofrojnë shërbime themelore për gratë, fëmijët dhe të mbijetuarat e tjera vazhdimisht përballen me kërcënimin e mbylljes për shkak të mungesës së një zgjidhjeje buxhetore afatgjatë dhe të qëndrueshme. Prandaj, ende ekziston një nevojë urgjente për të krijuar një vijë të përhershme buxhetore për të siguruar financim të qëndrueshëm për strehimoret.

**120.** Gjykatat vazhduan të japin dënime të ulëta në rastet e dhunës në bazë gjinore, ndërsa disa gjyqtarë vazhduan të inkurajojnë pajtimin familjar dhe fajësuan viktimat për krimet e kryera kundër tyre. Në shtator të vitit 2020, Gjykata Themelore në Gjakovë uli dënimin e burgimit të përjetshëm të Pjetër Nrecaj, i cili vrau gruan dhe vajzën e tij në vitin 2018, në vetëm 24 vjet e gjysmë burg, gjë që çoi në protesta publike nga aktivistet për të drejtat e grave.<sup>200</sup> Përpjekjet për të pajtuar rastet

198 Zyra e Kryeministrit, 'Kryeministri Hoti: Kosova në mesin e 15 vendeve me masa për sigurimin ekonomik të grave gjatë pandemisë' (8 mars 2021).

199 Policia e Kosovës, 'Policimi në kohën e pandemisë: Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës Janar - Dhjetor 2020' (mars 2021), f. 11.

200 RRGK, 'Mos i jep zemër dhunuesit', RRGK me aksion kundër dënimeve të ulëta për vrasësit e grave' (16 shtator 2020).

mund të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për recidivizëm, duke i ekspozuar viktimat në rrezik të dhunës së mëtejshme. Ekziston ende nevoja për të trajnuar gjyqtarët, prokurorët dhe policinë për barazinë gjinore, veçanërisht në lidhje me dispozitat e Kodit Penal të rishikuar për ngacmimin seksual dhe dhunën në familje dhe detyrimet e reja të institucioneve publike sipas Konventës së Stambollit.

**121.** Për sa i përket ngacmimeve seksuale, QKSGJ ka arritur një zhvillim të madh pozitiv. Në nëntor të vitit 2020, Qeveria e Kosovës dhe QKSGJ nënshkruan një politikë kundër Ngacmimit Seksual në Administratën Publike që ka për qëllim parandalimin dhe sanksionimin e ngacmimit seksual në vendin e punës, i cili është i pari i këtij lloji.<sup>201</sup> Baza e të dhënave aktuale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e krijuar nga UN Women, përfshin gati të gjitha format e dhunës ndaj grave si dhuna fizike, dhuna seksuale dhe përdhunimi, ndjekja, martesa e detyruar, aborti i detyruar dhe sterilizimi i detyruar, që do të thotë të gjitha format e dhunës që ndodhin jashtë marrëdhënieve familjare janë të përfshira me përjashtim të gjymtimit gjenital të femrave dhe dhunës psikologjike. Baza e të dhënave aktuale përfshin gjithashtu informacione për kryesit e veprave.

## **122. Rekomandimet:**

- Korniza ligjore e Kosovës duhet të ndryshohet dhe rishikohet për të pasqyruar Konventën e Stambollit.
- Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë Projektligjin e Punës në mënyrë që të jetë në përputhje me direktivën e BE-së për balancim mes punës dhe jetës sociale.
- Qeveria e Kosovës duhet të punësojë më shumë inspektore femra, veçanërisht në kuadër të Inspektoratit të Punës, dhe tu ofroj inspektorëve trajnime specifike mbi diskriminimin me bazë gjinore në kontekstin e punës, përfshirë diskriminimin gjatë procedurave të rekrutimit dhe gjatë ngritjes në detyrë dhe transferimit të punëtorëve.
- Qeveria e Kosovës duhet të krijojë një linjë të përhershme buxhetore që do të siguronte fonde të qëndrueshme për strehimoret e të mbijetuarave të dhunës në familje.
- KGJK-ja duhet të ofroj trajnime për gjyqtarët, prokurorët dhe policinë, mbi barazinë gjinore posaçërisht në lidhje me dispozitat e Kodit Penal të rishikuar për ngacmimin seksual dhe dhunën në familje dhe detyrimet e reja të institucioneve publike sipas Konventës së Stambollit.
- Koordinator i Kosovës për Dhunën në Familje duhet të zgjeroj databazën e vet për të përfshirë të gjitha format e dhunës në bazë gjinore, jo vetëm dhunën në familje.
- Institucionet e Kosovës duhet të përmirësojnë mbledhjen, mirëmbajtjen dhe raportimin transparent të të dhënave të zberthyer, ndër të tjera, sipas gjinisë dhe etnisë.

201 RRGK, 'Pas shumë vitesh avokim, QKSGJ shtyn përpara miratimin e Politikës kundër ngacmimit seksual në administratën publike në Kosovë' (30 nëntor 2020).



## 7.2. Të drejtat e fëmijëve

**123.** Neni 50 i Kushtetutës në mënyrë të qartë mbron të drejtat e fëmijëve, përfshirë “të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre” dhe mbrojtjen nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF), e cila përkufizon se me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, gjithashtu zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë, sipas nenit 22 të Kushtetutës. Legjislacioni primar i Kosovës është gjithashtu në përputhje me standardet dhe parimet e përfshira në KDF. Më e rëndësishmja, Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës hyri në fuqi në korrik të vitit 2020<sup>202</sup> në një kontekst të raporteve se masat e parandalimit të COVID-19 kanë rritur dhunën ndaj fëmijëve në Kosovë. Ligji i ri, i cili mundëson zbatimin e plotë të Kushtetutës së Kosovës dhe KDF-së që zbatohet drejtpërdrejtë, synon të mbrojë fëmijët nga dhuna fizike dhe mendore, abuzimi, shfrytëzimi, lënia pas dore dhe format e tjera të dhunës që rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin, arsimin, ose zhvillimin e tyre. Ndër të tjera, ai ndalon ndëshkimin fizik dhe format e tjera të masave disiplinore që dëmtojnë dhe dobësojnë dinjitetin njerëzor të fëmijës në të gjitha institucionet arsimore dhe të kujdesit, në sistemin e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë, mjediset e punës dhe në shtëpi. Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve për 2019 - 2023 identifikon disa çështje që kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për t'u sigurohet fëmijëve mbrojtja dhe kujdesi i duhur për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.<sup>203</sup>

**124.** Përkundër kësaj kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe politike që mbron fëmijët dhe të drejtat e tyre, sfidat e zbatimit vazhduan edhe në vitin 2020, veçanërisht për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore që rrjedhin nga mungesa e vullnetit të institucioneve qendrore dhe lokale për të investuar më tej në këtë fushë të rëndësishme. Për shkak të dy ndryshimeve të qeverisë, shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës dhe vazhimit të pandemisë, Projektligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal, i cili do të vendoste një linjë specifike dhe minimale të buxhetit për shërbimet sociale për përfitimin e fëmijëve, mbeti pezull gjatë gjithë vitit 2020 pavarësisht disa kërkesave nga shoqëria civile për miratimin e tij. Për më tepër, edhe për shkak të krizës COVID-19 dhe paqëndrueshmërisë politike, MPMS-ja dhe institucionet përkatëse komunale u vonuan shumë në njoftimin e thirrjeve publike për të mbështetur shërbimet e ofruara për fëmijët nga sektori joqeveritar.

**125.** Anketa e fundit e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (AGTS) e vitit 2020 paraqet një situatë shqetësuese në lidhje me varfërinë e fëmijëve dhe se fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës vazhdojnë të jenë shumë mbrapa. Sipas të dhënave të AGTS-së, një në katër fëmijë nën moshën pesëvjeçare jeton në familjet më të varfra.<sup>204</sup> Për çdo 1000 lindje, 16 fëmijë vdesin para se të arrijnë ditëlindjen e tyre të pestë me 70 për qind të atyre vdekjeve që ndodhin brenda muajit të parë të jetës, ndërsa ky numër është pothuajse dy herë më i lartë në

202 [Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve](#) (17 korrik 2019).

203 ZQM, 'Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve për 2019 - 2023' (9 gusht 2019).

204 Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF Zyra në Kosovë, 'Lansimi i Gjetjeve Kryesore nga Anketa e Treguesve të Shumëfishtë 2020' (nëntor 2020) (në tekstin e mëtejshëm 2020 AGTS Gjetjet Kryesore).

mesin e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.<sup>205</sup> Bazuar në raportin e AGTS, tetë për qind e fëmijëve të moshës 2 deri në 17 vjeç raportuan vështirësi funksionale në të paktën një fushë (p.sh., shikim, dëgjim, ecje, komunikim dhe mësim), ndërsa përqindja është më e lartë (14 për qind) në mesin e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.<sup>206</sup> Sa i përket punës së fëmijëve, 5.3 për qind e fëmijëve midis moshës 5 dhe 17 kanë qenë të përfshirë në punë, ndërsa kjo përqindje është gjithashtu më e lartë tek fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës me 6.9 për qind.<sup>207</sup>

**126.** Fëmijëve të cilëve u mungon kujdesi prindëror u ofrohet zgjidhja alternative e përkujdesjes dhe nuk vendosen në institucione të mëdha banimi, ndonëse strehimi kujdestar nuk është në dispozicion në të gjitha komunat dhe “shpesh nuk i plotëson kërkesat e njohura ndërkombëtare”.<sup>208</sup> Sigurimi i përfshirjes së duhur sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara gjithashtu ka mbetur problem, dhe shumë prej tyre ende kanë “qasje të kufizuara në shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore”.<sup>209</sup> Përveç kësaj, autoritetet e Kosovës kanë qenë “joefikase në ofrimin e kujdesit adekuat për fëmijët e rrugës dhe kanë dështuar në adresimin e duhur të problemit”, edhe pse qendra e parë pilot e kujdesit për fëmijët e rrugës që u përrua në Prishtinë në vitin 2019, ka vazhduar t’u ofronte atyre dhe familjeve të tyre mbështetje psiko-sociale dhe arsimore në vitin 2020. Dhuna fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve po ashtu ka vazhduar dhe raportohet se është rritur pjesërisht për shkak të masave për parandalimin e COVID-19, siç janë kufizimet në lirinë e lëvizjes, ndërsa autoritetet e Kosovës kanë bërë progres të pamjaftueshëm në adresimin e dhunës ndaj fëmijëve pavarësisht nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 0/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës.<sup>210</sup>

**127.** Masat pandemike dhe masat e lidhura me të ndikuan në mënyrë disproporcionale në të drejtat e fëmijëve në Kosovë. Sipas ish-Avokatit të Popullit, masat ndaj COVID-19 dhe ndikimi i tyre socio-ekonomik ndikuan në të drejtat e fëmijëve për jetën, shëndetin, sigurinë dhe arsimin në Kosovë.<sup>211</sup> Ai theksoi se pandemia COVID-19 ka shfaqur “më shumë dobësi” në përpjekjet për të realizuar të drejtat e tyre dhe ka “thelluar...pabarazitë ekzistuese”. Në këtë drejtim, ai theksoi se ndërveprimi midis ndikimit të COVID-19 dhe faktorëve të tjerë, siç janë gjinia, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar dhe statusi ekonomik, ka prekur fëmijët në mënyrë të ndryshme, duke përdorur shembullin e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptian të Kosovës dhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët përballen me më shumë sfida për qasjen në mësimin online. Ai gjithashtu vuri në dukje se rritja e dhunës në familje ka prekur veçanërisht fëmijët, duke theksuar se liria nga dhuna është e drejtë themelore dhe “parakusht

205 Rezultatet e Programit të UNICEF 2020, shënimi 117, f. 3.

206 2020 AGTS Gjetjet Kryesore, shënimi 204.

207 KB ekipi Kosovës, UNICEF, UN Women, et al., ‘2019–2020 Kosovë\* (UNSCR 1244) Anketa e Treguesve të Shumëfishtë dhe Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë Anketa e Treguesve të Shumëfishtë’ (nëntor 2020), f. 27.

208 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, f. 35.

209 Po aty.

210 Po aty.

211 IAP, ‘Deklarata e Avokatit të Popullit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve’ (1 qershor 2020); APK, ‘Deklarata e Avokatit të Popullit Naim Qelaj në Ditën Universale të Fëmijëve’ (20 nëntor 2020).

i domosdoshëm” për mirëqenien dhe shëndetin e tyre. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre gjithashtu u përballën me sfida në qasjen në shërbimet thelbësore sociale, shëndetësore dhe rehabilituese për shkak të pandemisë.<sup>212</sup> Për shembull, Qeveria e Kosovës në mars të vitit 2020 pezulloi për dy muaj programin rutinor të imunizimit që mbulon më shumë se 210,747 fëmijë të moshës 0 deri 12 vjeç, ndërsa masat u hoqën gradualisht nga muaji maj.<sup>213</sup>

**128.** Megjithëse shërbimet e strehimit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijët që kanë qenë viktimë të dhunës, abuzimit dhe trafikimit janë siguruar me financim afatshkurtër deri më 31 dhjetor 2020, mungesa e fondeve të qëndrueshme afatgjate për strehimoret dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për fëmijët në situatë të vështirë vazhdoi të jetë çështje shqetësuese, sidomos duke marr parasysh ndikimin financiar të pandemisë. KOMF, IAP, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe organizata të tjera publikuan një dokument të qëndrimit të përbashkët duke i bërë thirrje Qeverisë së Kosovës për të siguruar një zgjidhje afatgjate dhe të qëndrueshme për financimin e shërbimeve sociale duke miratuar Projektligjin për Qeverisjen Lokale, i cili, nëse miratohet, do të krijonte një nivel minimal të financimit për shërbimet sociale. Sipas KOMF-së, shumë fëmijë në gjendje të vështirë kanë mbetur pa qasje në shërbimet sociale sepse ofruesit e shërbimeve janë mbyllur ose rrezikojnë të mbyllën për shkak të mungesës së fondeve si pasojë e pandemisë. Avokati i tanishëm i Popullit po ashtu në mënyrë specifike bëri thirrje për financim të qëndrueshëm për t’iu përgjigjur krizës shëndetësore, sociale dhe ekonomike të shkaktuar nga pandemia, dhe që institucionet e Kosovës të miratojnë masa të përshtatura për të mbështetur fëmijët në situata të rrugës, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që jetojnë në varfëri.<sup>214</sup>

## 129. Rekomandimet:

- Për të adresuar situatën e varfërisë së fëmijëve në Kosovë, Kuvendi i Kosovës duhet të ndryshojë Ligjin Nr. 2003/15 mbi Skemën e Ndihmës Sociale me qëllim të heqjes së kriterit diskriminues që kërkon që një familje duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç për të përfituar nga skema e ndihmës sociale si dhe të rritet shuma mujore e ndihmës sociale për të përmbushur kushtet themelore të jetesës për familjet.
- MASHT-i duhet të marrë masa shtesë për të siguruar përfshirjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë dhe qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore dhe sociale, përfshirë edhe punësimin e asistentëve personal në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Kuvendi i Kosovës duhet të vazhdojë sa më shpejt që të jetë e mundur me miratimin e Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal, i cili parashikon krijimin e një Granti Specifik për Shërbimet Sociale për të garantuar financim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale
- MPMS-ja duhet të krijojë një skemë të qëndrueshme për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori joqeveritar.
- MASHT-i duhet të rrisë numrin e psikologëve në shkolla për të forcuar mbështetjen emocionale të nxënësve dhe kujdesin për shëndetin e tyre mendor.

212 Koha, 'KOMF: Qeveria dhe komunat të marrin me urgjencë masat për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve' (koha.net, 31 maj 2020).

213 Po aty.; Rezultatet e Programit UNICEF 2020, shënimi 117, f. 3.

214 IAP, 'Deklarata e Avokatit të Popullit Naim Qelaj në Ditën Universale të Fëmijëve' (20 nëntor 2020).

### 7.3. Të drejtat e të rinjve

**130.** Të rinjtë në Kosovë nga mosha 15 deri 24 vjeç përbëjnë rreth 20 për qind të popullsisë së përgjithshme<sup>215</sup>, por ende vazhdojnë të mbesin nga grupet të rrezikuara në Kosovë për shkak të disa faktorëve, siç janë presionet [d]emografike, modeli i rritjes së papunësisë, prirja për të emigruar dhe rezultatet e dobëta të arsimit<sup>216</sup>.

**131.** Kosova ka vlerësimin më të ulët në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor në rajon, dhe standardi i jetesës është shumë më ulët se normat e BE-së.<sup>217</sup> Gjendja e dobët ekonomike në Kosovë ndikon drejtpërdrejt në realizimin e të drejtave sociale dhe ekonomike të të rinjve në Kosovë dhe në mundësitë e tyre të punësimit. Të rinjtë e moshës midis 15 dhe 24 vjeç mbeten grupi më i prekur nga papunësia dhe pasiviteti. Papunësia e të rinjve është deri në 49 për qind, gjë që sugjeron “punësim të padeklaruar dhe [një] mospërputhje midis rezultateve arsimore dhe nevojave të tregut të punës”.<sup>218</sup> Zbatimi i Strategjisë Sektoriale 2018 – 2022 dhe Planit të Veprimit 2018 - 2020 për Rritjen e Punësimit të të Rinjve të MPMS-së, e cila është thelbësore për adresimin e papunësisë së të rinjve në Kosovë, “mbetet në nivel të ulët”.<sup>219</sup>

**132.** Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë ka për qëllim të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes dhe të përmirësojë cilësinë e tyre të jetës dhe statusin shoqëror.<sup>220</sup> Ai adreson të drejtën e të rinjve për vetorganizim dhe punë vullnetare me organizata të ndryshme dhe përgjegjësitë e tyre, detyrimet e institucioneve qendrore dhe komunale, themelimin dhe përgjegjësitë e Këshillave Lokalë të Veprimit Rinor (KLVR) përgjegjës për përmirësimin e statusit të rinisë dhe pjesëmarrjen e të rinjve në politikat sektoriale për arsimin, punësimin, shëndetin publik, çështjet sociale dhe çështje të tjera që lidhen me to.<sup>221</sup> Strategjia për Rininë 2019 - 2023 e MKRS dhe Plani i Veprimit mbeten në fuqi, të dyja synojnë të përmirësojnë situatën e të rinjve në Kosovë përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në proceset e vendimmarrjes dhe jetës publike, pjesëmarrjes në arsimin joformal, punësim, arsim, promovim të shëndetit, kulturë, sport dhe rekreacion.<sup>222</sup>

**133.** Përkundër kësaj kornize ligjore dhe politike, pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje mbeti sfidë edhe gjatë vitit 2020. Funkcionalizimi i KVRL-ve dhe Këshillit Qendror të Veprimit Rinor (KQVR), që përfaqësojnë interesat e të rinjve në nivel qendror dhe lokal ka lënë shumë për të

215 MKRS, ‘[Strategjia për Rininë 2019 – 2023](#)’ (maj 2019), p. 5 (në tekstin e mëtejshëm Strategjia e Kosovës për Rininë).

216 Raporti i Progresit të BE-së 2020, shënimi 44, f. 79.

217 UNICEF Zyra në Kosovë, ‘[Monitorimi i të Drejtave të Fëmijëve dhe Mbrojtja Sociale: Promovimi i interesave më të mirë të fëmijëve në politikën sociale dhe ekonomike dhe diskursin publik](#)’, qasja e fundit më 28 prill 2021.

218 Raporti i Progresit të BE-së 2020, shënimi 44, f. 57.

219 Po aty., f. 79.

220 [Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë](#) (5 nëntor 2009), neni 1.

221 Po aty., nenet 4-10.

222 Strategjia e Kosovës për Rininë, shënimi 215, f. 4.

dëshiruar. Përveç kësaj, jo të gjitha komunat kanë buxhet të aprovuar për zbatimin e planeve të veprimit për të rinjtë, duke bërë që sektori i rinisë të funksionojë pjesërisht ose të mos funksionojë me kapacitet të plotë.<sup>223</sup> Të rinjtë gjithashtu nuk po informohen në mënyrë adekuate për rolin e tyre në vendimmarrje dhe politikë dhe nuk kanë zë në institucionet vendimmarrëse për shkak të praktikave aktuale, duke rezultuar në interesimin e tyre të ulët për politikë dhe përjashtim nga diskutimet për çështje që lidhen me të rinjtë.

#### 134. Rekomandimet:

- Institucionet në nivel qendror dhe lokal duhet të përfshijnë të rinjtë në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet për të siguruar që të rinjtë të mund të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre si partnerë të barabartë, duke siguruar që nevojat dhe interesat e tyre të pasqyrohen në politikat dhe programet përfundimtare.
- MASHT-i duhet të ndjekë trendet e praktikave më të mira botërore për adaptimin e sistemit arsimor në përputhje me nevojat e nxënësve në Kosovë dhe me gjendjen ekonomike, duke përfshirë mësimin elektronik.
- Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë plane strategjike ndërministrorë për të tejkaluar hendekun ndërmjet arsimit dhe tregut të punës në Kosovë në mënyrë që ta bëjë arsimin më të fokusuar në nevojat e tregut të punës, duke ofruar mundësi për praktikë me pagesë për studentët në fushën e tyre të studimit.
- MKRS duhet të ofrojë mbështetje konkrete për KQVR-në dhe KVRL-të në mënyrë që këta mekanizma rinorë të ushtrjnë mandatet e tyre siç duhet.

### 7.4. Personat me aftësi të kufizuara

**135.** Neni 24 i Kushtetutës ndalon shprehimisht diskriminimin në bazë të “aftësisë së kufizuar”, ndërsa neni 51 thotë se “sigurimi social themelor, që ka të bëjë me...aftësitë e kufizuara..., rregullohet me ligj”. Për më tepër, disa instrumente për të drejtat e njeriut që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë.<sup>224</sup> Megjithëse Kosova ka disa ligje për personat me aftësi të kufizuara, ajo ende nuk ka një ligj të harmonizuar që adreson të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Ligji nr. 03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme i jep përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme. Sidoqoftë, në ligj përdoret terminologji e vjetruar në përkufizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, si për shembull “fëmijë të palëvizshëm” dhe “fëmijë plotësisht të verbër”. Ky ligj gjithashtu nuk ofron përkrahje materiale për familjet që përkujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara jo të përhershme, edhe pse ata gjithashtu kanë nevojë për këtë mbështetje. Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ndalon në mënyrë specifike diskriminimin nga punëdhënësi dhe thekson nevojën për mundësi dhe trajtim të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në punësim, aftësim dhe

223 Po aty., f. 9.

224 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 22. Shih gjithashtu DUDNJ, neni 25; KDF, nenet 2, 23.

riaftësim dhe garanton mbrojtjen e tyre ligjore. Kushtetuta e Kosovës ende nuk është ndryshuar për ta bërë Konventën mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) të zbatohet drejtpërdrejt. Strategjia e Kosovës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013 - 2023 ka mbetur operacionale dhe ofron udhëzime të rëndësishme të politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, me qëllim të krijimit të një shoqërie të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, përfshirë sigurimin e përfshirjes së normave dhe standardeve të KDPAK në politika dhe programe për personat me aftësi të kufizuara.<sup>225</sup>

**136.** Kuvendi i Kosovës miratoi njëzëri një rezolutë më 4 dhjetor duke e deklaruar angazhimin e tij për të përmirësuar kornizën kushtetuese dhe ligjore për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë dhe se viti 2022 do të jetë vit i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë. Kuvendi gjithashtu inkurajoi autoritetet përkatëse të sjellin një amendament në mënyrë që KDPAK të shtohet në instrumentet e të drejtave të njeriut të cilat zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë të listuar në nenin 22 të Kushtetutës.

**137.** Pavarësisht miratimit të kornizës ligjore, personat me aftësi të kufizuara mbeten një nga grupet në gjendjen më të vështirë në Kosovë për shkak të mbështetjes së kufizuar, si dhe shërbimeve joadekuate shëndetësore, asistencës sociale dhe personale, rehabilitimit dhe pajisjeve ndihmëse. Dështimi i Këshillit të Kosovës për Personat me Aftësi të Kufizuara për të mbajtur takime për dy vjet ka qenë gjithashtu një tjetër mangësi në mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara.

**138.** MPMS, në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, është në proces të harmonizimit të legjislacionit të Kosovës me *acquis* e BE-së për personat me aftësi të kufizuara dhe legjislacionin për skemat e pensione. Është parashikuar gjithashtu krijimi i një mekanizmi të pavarur qendror për menaxhimin dhe administrimin e të gjitha skemave sociale dhe pensionale.<sup>226</sup> Efekti dhe ndikimi që kjo reformë mund të ketë, veçanërisht politika e decentralizimit të ofrimit të shërbimeve, qëllimi i së cilës është të sigurojë financim të qëndrueshme për kategoritë e mbrojtura, mbetet të shihet.<sup>227</sup>

**139.** Personat me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të kenë një mungesë të madhe të qasjes në institucionet dhe hapësirat publike, siç janë institucionet arsimore, qendrat shëndetësore, gjykatat dhe prokuroritë, gjë që i pengon ata të marrin pjesë plotësisht në shoqëri. Megjithëse Ligji për Ndërtimin siguron standarde minimale për ndërtimin, qasja në ndërtesa për personat me aftësi të kufizuara rregullohet me një udhëzim administrativ që ende nuk është duke u zbatuar plotësisht. Vetëdijesimi për aftësinë e kufizuar në radhët e personave me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre, institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi mbetet i ulët në Kosovë.

225 ZQM, 'Strategjia e Kosovës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013 - 2023' (qershor 2013).

226 Qeveria e Kosovës, 'Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2017 - 2021' (mars 2017), f. 235.

227 Po aty.



**140.** Personat me aftësi të kufizuara përjetuan disa sfida në gëzimin e të drejtave të njeriut gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, megjithëse u bënë përjashtime të rëndësishme në masat që kufizojnë lëvizjen për njerëzit që përkujdesen për ta. Në veçanti, dështimi për të siguruar përkthyes të gjuhës së shenjave gjatë konferencave zyrtare për shtyp dhe informacionet në alfabetin e Brajrit pengoi qasjen në informata të rëndësishme mbi kufizimet e COVID-19 dhe masave parandaluese për personat me dëmtime të dëgjimit dhe pamore, respektivisht. Për shembull, Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës (KGVK) deklaroi se asnjë informacion për COVID-19 nuk ishte shtypur në alfabetin e Brajrit qysh nga mesi i qershorit për personat me dëmtime pamore gjatë pandemisë dhe bëri thirrje për zbatimin e plotë të Ligjit Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, i cili, sipas KGVK, nuk është zbatuar plotësisht në praktikë. KGVK gjithashtu vuri në dukje se personat me dëmtime pamore përballen me probleme të tjera, si mbështetja joadekuate financiare nga institucionet e Kosovës, diskriminimi në punësim dhe mobilitetit urban dhe mungesa e librave në alfabetin e Brajrit.<sup>228</sup>

**141.** Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë mbetur pa qasje në arsim për pothuajse një muaj e gjysmë gjatë krizës së COVID-19 në Kosovë, pasi MASHT-i filloi një platformë arsimore online për ta vetëm në fund të prillit. Sa i përket të drejtës së tyre për kujdes shëndetësor, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë vuri në dukje se shëndeti i pacientëve me gjendje mjekësore kronike, siç janë personat me aftësi të kufizuara, u përkeqësua si rezultat i kujdesit të pamjaftueshëm shëndetësor për shkak të fokusimit në COVID-19. Sipas KOMF, kriza COVID-19 ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme te fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre për shkak të mungesës së shërbimeve thelbësore sociale, shëndetësore dhe rehabilituese. OJQ-të përkatëse gjithashtu vunë në dukje se kriza COVID-19 kishte prekur në mënyrë disproporcionale fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të drejtat ekonomike dhe sociale të familjeve të tyre, duke përfshirë të drejtën për standard adekuat të jetesës, dhe u bënë thirrje institucioneve të Kosovës të krijojnë pako të përshtatura ekonomike duke marrë parasysh nevojat e tyre specifike. Sidoqoftë, raportohet se Qeveria e Kosovës nuk është konsultuar sa duhet me OSHC-të që punojnë për këtë çështje për të siguruar që masat COVID-19 t'iu përshtaten nevojave specifike të personave me aftësi të kufizuara, duke ndikuar në të drejtën e tyre të pjesëmarrjes.

## **142. Rekomandimet:**

- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të ndryshojnë nenin 22 të Kushtetutës për ta bërë KDPAK-në drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë qasje në të gjitha institucionet dhe hapësirat publike për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë zbatimin e plotë të kornizës ekzistuese ligjore dhe udhëzimet administrative për këtë çështje.
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën e tyre për qasje në shërbime shëndetësore, ndihmë sociale dhe personale, rehabilitim dhe pajisje ndihmëse, përfshirë hartimin dhe miratimin e Udhëzimit Administrativ për Rehabilitimin dhe Mbështetjen e Personave me Aftësi të

228 Zëri, 'Asnjë informacion për mbrojtje nga COVID-19 nuk është shtypur për të verbrit' (zeri.info, 18 qershor 2020).

Kufizuara me Pajisje Ndhimëse, bazuar në Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara të jenë në qendër të reagimit dhe rimëkëmbjes ndaj COVID-19, duke përfshirë të drejtën e tyre për qasje në informacionet kryesore duke siguruar interpretues të gjuhës së shenjave në të gjitha konferencat zyrtare për shtyp dhe duke siguruar zbatimin e plotë të Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër.

## 7.5. Të drejtat e komuniteteve

**143.** Kosova ka kornizë të fuqishme ligjore, institucionale dhe strategjike për të drejtat dhe mbrojtjen e komuniteteve pakicë<sup>229</sup> që është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 3 i Kushtetutës thekson se Kosova është “shoqëri shumetnike” dhe garanton për të gjithë mbrojtje të barabartë para ligjit, përfshirë “mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjen” e të gjitha komuniteteve në Kosovë por “nevojiten ende përpjekje të rëndësishme për të krijuar kushtet për një shoqëri me të vërtetë shumetnike”.<sup>230</sup> Neni 24 i Kushtetutës ndalon në mënyrë specifike diskriminimin në bazë të “lidhjes me ndonjë komunitet”. Përveç kësaj, Kapitulli III i Kushtetutës përcakton të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe detyrimet e Kosovës në këtë aspekt. Aty përcaktohet se pjesëtarët e komuniteteve në Kosovë kanë “të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.”<sup>231</sup> Komunitetet pakicë gjithashtu gëzojnë garanci kushtetuese, ndër të tjera, për të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre amtare në jetën private dhe publike, aftësinë për të gëzuar lidhje me shtetet me të cilat ndajnë trashëgiminë “kulturore, gjuhësore a fetare” dhe përfaqësimin në Kuvendin e Kosovës, institucionet dhe organet publike dhe mediat transmetuese publike.<sup>232</sup> FCPNM e cila zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë,<sup>233</sup> gjithashtu mbron dhe promovon të drejtat dhe liritë e pakicave në Kosovë. Në nivelin legjislativ, Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës mbulon të drejtat e komuniteteve në lidhje me barazinë, gjuhën, kulturën, fenë, arsimin, mundësitë ekonomike dhe shoqërore, shëndetin dhe pjesëmarrjen politike. Zbatimi i kësaj kornize të fortë mbetet çështje e hapur dhe komplikohet nga dobësitë e kapaciteteve brenda institucioneve të Kosovës që vështirësojnë mbrojtjen gjithëpërfshirëse të të drejtave të pakicave.

**144.** Liria e lëvizjes vazhdon të jetë problem për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, veçanërisht për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës. Qeveria e Kosovës ende nuk i njeh dokumentet

229 Grupet kryesore të pakicave në Kosovë janë serbët, boshnjakët, turqit, ashkalinjtë, egjiptianët, goranët dhe romët. Shikoni Grupin Ndërkombëtar të të Drejtave të Pakicave, ‘Kosova’ (e përditësuar për here të fundit në mars 2018).

230 Raporti i Progresit të BE-së 2020, shënimi 44, f. 37.

231 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 57(3).

232 Po aty., nenet 59, 61-62.

233 Po aty., neni 22.

personale të lëshuara nga Serbia që mbajnë emrat e qyteteve të Kosovës si dokumente të vlefshme të udhëtimit, gjë që ka penguar lëvizjen e lirë të serbëve të Kosovës brenda dhe jashtë Kosovës.<sup>234</sup> Raportohet se, shtetasit serbë të martuar me serbë të Kosovës gjithashtu u ballafaquan me sfida në qasjen në dokumentet e gjendjes civile.<sup>235</sup>

**145.** Megjithëse situata e sigurisë së komuniteteve pakicë mbetet e qëndrueshme, sipas raportit të fundit të progresit të BE-së,<sup>236</sup> ka pasur incidente që kanë pasur në shënjestër pjesëtarët e komuniteteve pakicë në vitin 2020, përfshirë edhe sulme fizike dhe verbale, ngacmime dhe kërcënime dhe shkatërrim ose shpërdorim të pronës, shumë prej të cilave kishin në shënjestër serbët e Kosovës dhe të kthyerit.<sup>237</sup> Ministria për Komunitete dhe Kthim ka pranuar 49 ankesa që kanë të bëjnë me incidente të sigurisë ndaj komunitetit serbë të Kosovës dhe të kthyerve nga janari deri në tetor 2020.<sup>238</sup> OJQ-ja AKTIV raportoi më shumë se 20 incidente të sigurisë që kishin në shënjestër serbët e Kosovës ndërmjet marsit dhe qershorit 2020.<sup>239</sup> Në qershor, Raportuesit Special të KB-së për çështjet e pakicave, të drejta të njeriut të personave të zhvendosur brenda vendit si dhe format bashkëkohore të racizmit i dërguan një komunikim zyrtar të përbashkët ish-qeverisë duke ngritur shqetësime rreth incidenteve të raportuara ndëretnike që kishin në shënjestër pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë, edhe pse qeveria ende nuk është përgjigjur.<sup>240</sup> Sa i përket incidenteve, një çështje tjetër e ndërlidhur është numri i pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Policinë e Kosovës, i cili mbetet i ulët. Për shembull, në Klinë është vetëm një pjesëtar i Policisë së Kosovës që vjen nga komuniteti jo-shumicë (komuniteti ashkali), ndërsa në Istog ka vetëm pesë boshnjakë, një ashkali, dhe një serb të Kosovës në Policinë e Kosovës.

**146.** Përkundër avokimit nga OJQ-të, institucionet përkatëse të Kosovës vazhduan të reagojnë ngadalë ndaj rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore të raportuara nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës në shkelje të standardeve të zbatueshme ndërkombëtare dhe kornizës ligjore të Kosovës dhe të drejtës së tyre për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim. Në rastet kur nuk ka ndërhyrje nga OJQ-të, institucionet nuk bashkëpunojnë fare me njëri-tjetrin në referimin dhe kërkimin e trajtimit të këtyre rasteve. Në një rast simbolik, një rast i dhunës në familje i raportuar nga një pjesëtar i komunitetit egjiptian në Gjakovë nuk i është referuar fare Qendrës për Mirëqenie Sociale ose Avokatit të Viktimave, ndërsa OJQ-të në këtë rast i ofruan viktimës ndihmë psikosociale.

**147.** Zbatimi i detyrueshëm i Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, i cili, ndër të tjera, njeh dy gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kërkon sigurimin e informacioneve në të dy gjuhët, mbeti një sfidë e vazhdueshme dhe urgjente edhe në vitin 2020 e cila duhet të adresohet me shpejtësi.

234 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti i të Drejtave të Njeriut 2020, shënimi 28, f. 16.

235 Po aty.

236 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, p. 37.

237 Procedurat Speciale të Këshillit të KB për të Drejtat e Njeriut, Komunikatë e Përbashkët nga Raportuesit Special i KB për çështjet e pakicave, të drejtat e njeriut të personave të zhvendosur brenda dhe format bashkëkohore të racizmit (29 qershor 2020) [Reference No. AL KSV 1/2020](#) (në tekstin e mëtejshëm Komunikatë e Përbashkët për Procedurat e Veçanta).

238 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti i të Drejtave të Njeriut 2020, shënimi 28, ff. 30-31.

239 Po aty., f. 30.

240 Komunikatë e Përbashkët e Procedurave të Veçanta, shënimi 237.

Cilësia e dobët ose përkthimet e pakta të dokumenteve zyrtare dhe vështirësi të tjera që kanë të bëjnë me gjuhën vazhduan të pengojnë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, në veçanti serbët e Kosovës, të kenë qasje në shërbimet publike dhe institucionet gjyqësore.<sup>241</sup>

**148.** Komuniteti serb i Kosovës dhe komunitetet e tjera joshqiptare gjithashtu përballen me sfida të veçanta në marrjen e informacionit të duhur dhe në kohën e duhur mbi masat parandaluese dhe kufizuese të COVID-19 pasi pandemia përkeqësoi çështjet ekzistuese për sigurimin e përkthimeve në të dy gjuhët zyrtare, duke ndikuar në të drejtën e tyre për informim dhe të drejtën për gjuhën, si dhe qasjen e tyre në programet e rimëkëmbjes ekonomike. Zyra e Komisionerit të Gjuhëve raportoi se ka marrë disa ankesa në vitin 2020 për shkak se “vendimet në lidhje me pandeminë, në shumicën e rasteve, nuk ishin përkthyer” në serbisht. Sipas raportit të tij, faqet e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK-së mbeten “jofunksionale në gjuhën serbe”, përkundër disa rekomandimeve dhe ndërhyrjeve në të kaluarën. Bazuar në hulumtimin e kryer nga OJQ AKTIV, shumica dërrmuese e të anketuarve deklaruan se kishin vështirësi të kuptonin udhëzimet për qasje në masat e ndihmës financiare COVID-19.<sup>242</sup> Një raport tjetër i publikuar nga OJQ AKTIV deklaroi se mungesa e informacionit në gjuhën serbe gjatë krizës pandemike “kishte efekte të shumta negative në pozitën e pjesëtarëve të komuniteti serb dhe komuniteteve tjera jo-shumicë në Kosovë”, duke përfshirë, në veçanti, rritjen e rreziqeve shëndetësore, mungesën e vetëdijesimit për masat kufizuese dhe pengimin e qasjes në masat e ndihmës ekonomike.<sup>243</sup>

**149.** Komunitete të tjera jo-shumicë, si ai rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, janë prekur në mënyrë disproporcionale nga COVID-19 dhe masat kufizuese të tij për shkak të qasjes së tyre të kufizuar në ujë të pastër dhe kujdes shëndetësor, gjë që përkeqësoi kushtet e tyre të vështira të jetesës. Përveç sfidave me të cilat përballen ata në qasjen në mësimin online, janë pranuar raporte të shumta se këto komunitete nuk kishin ushqim të mjaftueshëm, PPM, furnizime mjekësore dhe artikuj higjienik, duke ndikuar në të drejtat e tyre për jetën, ushqimin e duhur, shëndet dhe të drejta të tjera të ndërlidhura. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve do të vazhdojnë të kenë nevojë për kujdes shëndetësor, ushqim dhe ndihmë ekonomike si gjatë ashtu dhe pas krizës COVID-19 për të gëzuar plotësisht të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale. Në veçanti, e drejta e tyre për një standard adekuat të jetesës është ndikuar në mënyrë disproporcionale nga mbyllja e bizneseve jo-esenciale dhe ndërprerja e aktivitetit ekonomik, sepse disa prej tyre punojnë në ekonominë joformale dhe mund të kenë qasje të kufizuar në rrjetet e mbrojtjes sociale. Sipas IAP-së, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës mbeten grupet më të marginalizuara dhe më të rrezikuara.<sup>244</sup> Përkundër faktit se tashmë ekziston një Strategji dhe Plan i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, kjo strategji nuk ka shënuar ndonjë përparim të madh ose rezultate deri më tani, dhe ky vit është gjithashtu viti i fundit i strategjisë.<sup>245</sup>

241 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti i të Drejtave të Njeriut, shënimi 28, ff. 31-33.

242 OJQ AKTIV, ‘2020 Analiza e Trendit: Qëndrimet e Komunitetit Serb në Kosovë’ (nëntor 2020).

243 AKTIV 2020 Raporti për të drejtat Gjuhësore, shënimi 69.

244 Raporti i IAP-së 2020, shënimi 26, f. 87.

245 Po aty, f. 96.

**150.** Përveç çështjes së gjuhës të përshkruar më lart, një tjetër sfidë për pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë është punësimi. Ata janë më pak të punësuar në pozita drejtuese, në shërbimin civil të Kosovës, në institucione e kujdesit shëndetësor, në arsimin formal dhe në ndërmarrjet private.<sup>246</sup> Për më tepër, “pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë mbeten të nënpërfaqësuar edhe në shërbimin civil si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal.”<sup>247</sup>

### **151. Rekomandimet:**

- Institucionet publike duhet të rrisin kapacitetet e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në njohuritë gjuhësore, cilësinë e përkthimeve zyrtare si dhe ofrimin e shërbimeve në gjuhët jo-shumicë, përfshirë edhe në sistemin gjyqësor.
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë monitorimin e duhur të zbatimit të rekomandimeve të miratuara nga Komiteti i Këshillit të Evropës për FCPNM.
- Institucionet gjyqësore duhet të adresojnë si duhet krimet potenciale me motive etnike.
- Policia e Kosovës duhet të rekrutojë më shumë policë nga komunitetet jo-shumicë, dhe gjithashtu të forcoj policimin në komunitet siç rekomandohet nga Komisioni Evropian.

## **7.6. Të drejtat e LGBT+**

**152.** Neni 24 i Kushtetutës shprehimisht ndalon diskriminimin në bazë të gjinisë dhe orientimit seksual. Disa instrumente të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë gjithashtu ndalojnë diskriminimin në bazë të gjinisë dhe ndonjë statusit tjetër.<sup>248</sup> Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit bazuar në seks, gjini, identitet gjinor dhe orientim seksual, ndër statuset tjera, dhe përcakton IAP-në si organin e autorizuar për të pranuar dhe hetuar ankesat e diskriminimit. Ai mbron personat LGBT+ nga veprimet diskriminuese të drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga institucionet qendrore dhe lokale, si dhe nga personat fizikë dhe juridikë në sektorin publik dhe privat. Për më tepër, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore garanton mundësi dhe trajtim të barabartë për burrat, gratë dhe personat që kanë një “identitetit gjinor apo përcaktim seksual” të mbrojtur në “në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera”.

**153.** Ndonëse Plani Kombëtar i Veprimit për 2019 - 2022 i hartuar nga Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për personat LGBT+ në Kosovë (GKK) mbeti funksional, asnjë nga masat e tij nuk u zbatuan nga nëntori 2019 deri në shkurt 2020. Situata u përmirësua pak sa i përket zbatimit të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit pasi ZQM-ja ndërmori iniciativën për të forcuar bashkëpunimin me OSHC-të që punojnë për avancimin e të drejtave të LGBT+ duke organizuar disa takime dhe ngjarje mbi rëndësinë e avancimit të të drejtave të LGBT+.

246 Po aty., f. 97.

247 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, f. 37.

248 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 22. Shih gjithashtu, DIDNJ, neni 2; PNDKP, nenet 2, 26; KEDNJ, neni 14, dhe Protokollin i saj, 12, neni 1.

**154.** Të paktën tri raste të dhunës që kanë pasur në shënjestër personat LGBT+ u raportuan në Policinë e Kosovës në vitin 2020 dhe më pas u dërguan në Prokurorinë e Kosovës. Siç është raportuar nga Policia e Kosovës, dy raste janë për nxitje të urrejtjes, përçarjes dhe jo tolerancës në baza fetare, racore dhe etnike, ndërsa një rast është nxitje e kërcënimit.

**155.** Pas zhvillimeve në vitin 2019 në lidhje me ndryshimet e shënuesit gjinorë për personat transgjinorë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike vendosi të krijojë një Grup Punues për të punuar në hartimin e një pjese të re të legjislacionit që do të rregullojë çështjen e ndryshimit të shënuesve të gjinisë në regjistrat publikë. Kjo iniciativë do të zgjidhte mangësitë ekzistuese ligjore në lidhje me njohjen ligjore të gjinisë.

**156.** Në gusht të vitit 2020, Qeveria e Kosovës miratoi Projekt Kodin Civil, i cili ende nuk është miratuar nga Kuvendi. Organizatat LGBT+ kanë avokuar për një ndryshim shtesë në Projekt Kodin Civil pasi ai përmban konceptin tradicional të martesës në mes të një burri dhe një gruaje dhe përcakton që format e tjera të bashkimeve civile do të rregullohen përmes një ligji të veçantë që ende nuk është hartuar. Sipas këtyre organizatave, ky formulim diskriminon personat LGBT+ pasi nuk njih shprehimisht martesat e të njëjtit seks në shkelje të së drejtës së çdo personi për t'u martuar sipas nenit 37 të Kushtetutës ose, të paktën, bashkimin civil të të njëjtit seks. Projekt Kodi Civil e lë këtë çështje të rëndësishme për komunitetin LGBT+ në Kosovë që të rregullohet me një ligj të ardhshëm që në fakt mund të mos hartohet ose miratohet kurrë pasi nuk jepet ndonjë afat kohor i detyrueshëm që specifikon se kur duhet të hartohet dhe miratohet një ligj i tillë.

**157.** Parada e tretë vjetore e krenarisë në Kosovë është mbajtur më 12 tetor me mbështetjen e institucioneve përkatëse të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare në formatin e një parade me automjete në Prishtinë në përputhje me masat e COVID-19. Parada u përpoq t'i vinte në dukje personat LGBT+ në Kosovë dhe të kërkonte realizimin e të drejtave të tyre njerëzore, përfshirë përfshirjen e martesave të seksit së njëjtë në Projekt Kodin Civil të ardhshëm. Për të shënuar këtë rast, Avokati i Popullit bëri një deklaratë publike duke kujtuar se të gjithë në Kosovë janë të barabartë dhe se autoritetet e Kosovës kanë për detyrë të mbrojnë të drejtat e njeriut të personave LGBT+.<sup>249</sup>

**158.** Masat për të luftuar COVID-19 përkeqësuan situatat e vështira me të cilat përballen personat LGBT+ në Kosovë. Sipas dy OJQ-ve që punojnë për të drejtat LGBT+ në Kosovë, CEL dhe CSGD, masat që kufizojnë lëvizjen detyruan shumë persona LGBT+ të kthehen ose të qëndrojnë në shtëpi në izolim për një periudhë më të gjatë kohore me disa anëtarë të familjes që mund të mos pranojnë orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor, duke shkaktuar ndikime të mundshme në të drejtat e tyre për shëndetin fizik dhe mendor dhe integritetin personal.<sup>250</sup> Pezullimi i udhëtimeve

249 IAP, 'Deklarata e Avokatit të Popullit me rastin e Javës së Krenarisë' (12 tetor 2020).

250 CEL, 'Deklaratë për Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë' (22 maj 2020).



ndërkombëtare ajrore dhe tokësore ndikoi në mënyrë disproporcionale në qasjen e personave transgjnorë në kujdesin shëndetësor sepse shërbimet shëndetësore për t'i ndihmuar ata në konvertim, siç është terapia hormonale, nuk ofrohen në Kosovë, edhe pse udhëzimet e OBSH-së përcaktojnë që terapitë e konvertimit janë shërbime shëndetësore thelbësore për komunitetin transgjnorë.

**159.** Gjatë vitit të kaluar, komuna e Prishtinës ka treguar solidaritet të madh dhe mbështetje për personat LGBT+ duke siguruar një qendër ditore të sigurt për ta, të cilën mund ta përdorin edhe OJQ-të për të zhvilluar aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve të personave LGBT+. Ajo gjithashtu ka ndarë fonde për ndërtimin e një strehimore në Kosovë që do të jetë strehimorja e parë për akomodimin e personave LGBT+.<sup>251</sup>

## **160. Rekomandimet:**

- ZQM-ja duhet të organizojë takime më të shpeshta të GKK me palët përkatëse të interesit dhe aktorët kyç, në veçanti me Ministrinë e Shëndetësisë, për të iniciuar më shumë raporte nga profesionistët e departamenteve të ndryshme shëndetësore mbi çështjet transgjnore dhe interseksuale.
- ZQM-ja duhet të jetë më aktive në kërkimin dhe organizimin e seminareve me zyrtarët e Policisë së Kosovës në tërë rajonin e Kosovës duke përfshirë ekspertë nga shtete të ndryshme të BE-së.
- Ministria e Drejtësisë duhet të ndryshojë draftin aktual të Kodit Civil për të përfshirë në mënyrë specifike martesat e të njëjtit seks.
- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për personat LGBT+, duke marrë parasysh ndryshimet e fundit në Kodin Penal.
- Qeveria e Kosovës duhet të miratojë një rregullore të re me procedura që do të lejojnë personat transgjnorë të ndryshojnë emrin dhe gjininë e tyre në dokumentet zyrtare.

## **7.7. Personat në lëvizje**

**161.** Neni 156 i Kushtetutës së Kosovës përcakton që Kosova “promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.” Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit midis BE-së dhe Kosovës riafirmon gjithashtu të drejtën e tyre të kthimit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre pronësore dhe të drejtave të ndërlidhura të njeriut.<sup>252</sup> Ajo parashikon bashkëpunimin midis BE-së dhe Kosovës në çështjet e azilit me qëllim që t’i ndihmohet Kosovës për të përmbushur standardet e përfshira në Konventën e Gjenevës të vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e saj të vitit 1967, duke përfshirë sigurimin e respektimit të parimit të mos-dëbimit dhe të drejtave të njeriut të azilkërkuesve dhe refugjatëve. Më konkretisht, Ligji Nr. 06/L-026 për

251 Telegrafi, ‘Komuna e Prishtinës ndan 300 mijë euro për ndërtimin e strehimores për komunitetin LGBT!’ (telegrafi.com, 3 tetor 2020).

252 Marrëveshja e Stabilizimit-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike dhe Kosovës (2 tetor 2015).

Azilin përcakton kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, statusit të mbrojtjes plotësuese apo mbrojtjes së përkohshme dhe rregullon të drejtat dhe detyrimet e personave të cilëve u është njohur statusi i tillë si dhe të azilkërkuesve.<sup>253</sup> Në ligjet tjera të rëndësishme për mbrojtjen dhe të drejtat e personave në lëvizje hyjnë Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt, i cili përkufizon refugjatët në përputhje me standardet ndërkombëtare,<sup>254</sup> dhe Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.<sup>255</sup> Çka është më e rëndësishmja, Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt i jep prioritet masave alternative të ndalimit për të huajt kur kjo është e mundur.

**162.** Autoritetet e Kosovës kanë një kornizë të solide ligjore për azil që garanton hyrjen në territor dhe respektimin e parimit të mos-dëbimit, kushtet e pritjes, qasjen në procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit, lirinë e lëvizjes dhe alternativat e ndalimit, si dhe kornizën ligjore që rregullon bashkimin familjar dhe që kontribuon në procesin e integritit të refugjatëve të njohur në Kosovë. Kjo kornizë siguron mbrojtje ligjore për njerëzit në lëvizje që janë në situatat më të cënueshme, siç janë të miturit e pashoqëruar, fëmijët, familjet me fëmijë, gratë dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe torturës.

**163.** Kosova ende mbetet një rrugë tranzite për lëvizjet e përziera, dhe në vitin 2020 janë paraqitur rreth 1,370 kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare.<sup>256</sup> Lëvizjet e parregullta vazhduan të ndodhin, si dhe rastet e kthimit, kontrabandës dhe veprimeve të dëmshme ndaj azilkërkuesve janë rritur.<sup>257</sup> Sipas Komisionerit të Lartë të KB-së për Refugjatët (UNHCR), mungon një "regjistrim i detajuar dhe të dhëna adekuate të profilizimit" për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, që pengon qasjen e tyre në të drejtat e njeriut dhe planet e zhvillimit.<sup>258</sup>

**164.** Personat e zhvendosur dhe të kthyerit vazhdojnë të përballen me probleme të sigurisë dhe sfida në realizimin e të drejtave të tyre ekonomike dhe sociale. UNHCR-ja ka raportuar se që nga korriku ka pasur 45 incidente që kishin pasur në shënjestër të kthyerit dhe pronën e tyre.<sup>259</sup> Mbi 408 persona të zhvendosur kanë jetuar në qendrat e strehimit kolektiv në qershor.<sup>260</sup> Përkundër shqetësimeve të ngritura nga Avokati i Popullit në raportet vjetore gjatë tri viteve të fundit dhe rekomandimeve për këtë çështje, çështja e banimit për familjet e zhvendosura ende ka mbetur e pazgjidhur deri në fund të vitit 2020.

253 [Ligji Nr. 06/L-026 për Azilin](#) (15 maj 2018), neni 1.

254 [Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt](#) (3 shtator 2013), nenet 2-3.

255 [Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit](#) (4 shtator 2013), neni 1.

256 Sipas të dhënave të mbledhura nga OJQ CRP/K, e cila ofron ndihmë juridike falas për azilkërkuesit dhe refugjatët në Kosovë.

257 Bazuar në aktivitetet e monitorimit të kufirit dhe vëzhgimet e OJQ-së CRP/K, veçanërisht gjatë situatës pandemike COVID-19.

258 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti për të Drejtat e Njeriut 2020, shënimi 28, f. 17.

259 Po aty., f. 18.

260 Po aty., f. 17.

**165.** Përkundër vazhdimet të pandemisë, numri i kthimeve vullnetare u rrit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Sipas UNHCR-së, kishte 394 të kthyer krahasuar me vitin 2019, gjatë të cilit ishin kthyer gjithsej 191. Nga janari deri në fund të dhjetorit 2020, u kthyen 238 serbë, 16 shqiptarë, 76 ashkali, egjiptianë, tre boshnjakë dhe 61 romë të Kosovës.

**166.** Personat në lëvizje, megjithatë, u përballën me një rritje të rrezikut për t'u infektuar me COVID-19 për shkak të mundësive të kufizuara për të aplikuar masat e distancimit fizik dhe qasjes së kufizuar në ushqim adekuat, PPM, produkte higjienike dhe ilaçe thelbësore për sëmundjet kronike. Këto çështje, të cilat ndikojnë në të drejtat e tyre për jetën, shëndetin dhe ushqimin adekuat, janë përkeqësuar për azilkërkuesit e vendosur në qendrat e azilit në Kosovë, emigrantët i janë nënshtruar një karantine të detyrueshme 14-ditore në qendrën e ndalimit të emigracionit në Vranidoll e përcaktuar për këtë qëllim, dhe personat e zhvendosur brenda vendit të vendosur në qendrat kolektive të Kosovës. Nga marsi deri në qershor, 171 deri në 207 azilkërkues ishin vendosur në qendrat e azilit në Kosovë, ndërsa në të njëjtën kohë deri në 31 emigrantë ishin në karantinë në qendrën e Vranidollit. Më 29 maj, të gjithë personat në lëvizje që ende ishin në karantinë në qendrën në Vranidoll, e cila u mbyll më 30 maj, u testuan për COVID-19 dhe më pas u lanë në vet-izolim për 14 ditë. Vonesat në dhënien dhe kërkimin e ndihmës sociale si dhe vonesat në përpunimin e kërkesave për azil për shkak të pezullimit të procedurave për përcaktimin e statusit të refugjatit dhe mungesës së veshmbathjeve të përshtatshme për të gjitha moshat, gjinitë dhe stinët ndikuan në të drejtat e shumë azilkërkuesve.

#### **167. Rekomandimet:**

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë qasje në të drejtat dhe shërbimet themelore për të gjithë azilkërkuesit dhe refugjatët në kohën e duhur dhe të përmirësojë kushtet e jetesës në të gjitha qendrat e azilit në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës duhet të rrit bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstytucional në mënyrë që t'i përgjigjet në mënyrë efektive nevojave dhe kërkesave të refugjatëve të pranuar dhe personave me status të mbrojtjes plotësuese në Kosovë për statusin e tyre ligjor dhe socio-ekonomik.
- Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të krijojë një bazë të qartë të dhënash me të dhëna adekuate të profilizimit për personat e zhvendosur dhe të kthyerit.
- Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të hartojë dhe miratojë një strategji të re për komunitetet dhe të kthyerit.

## 8. SEKSIONI D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

### 8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut

**168.** Deri në fund të vitit 2018, rreth 900 lëndë të pazgjidhura që kanë të bëjnë me krimet e mundshme të kryera gjatë konfliktit 1998-1999 në Kosovë të cilat ishin duke u hetuar nga organizatat ndërkombëtare u transferuan dhe u vendosën nën juridiksionin e sistemit gjyqësor të Kosovës. Që nga ajo kohë e deri më tani, ritmi i punës së autoriteteve të prokurorisë në zgjidhjen e këtyre çështjeve, një komponent kyç për realizimin e së drejtës për të vërtetën dhe avancimin e drejtësisë tranzicionale në Kosovë, nuk ka qenë premtues. Nga ky raport, mund të konkludohet se sistemi i drejtësisë në Kosovë është vetëm në fazën fillestare të detyrës së tij herkuliane për të siguruar drejtësi për viktimat dhe familjet e tyre duke identifikuar autorët e pretenduar të këtyre krimeve dhe duke i ndëshkuar ata sipas ligjit.

**169.** Në vitin 2019, KPK-ja miratoi një strategji për krime të luftës, megjithëse sfidat për zbatimin e saj vazhduan edhe në vitin 2020 për shkak të problemeve politike, mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore dhe mungesës së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.<sup>261</sup> Prokurorët dhe gjyqtarët në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës aktualisht të ngarkuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës zakonisht nuk kanë përvojë të mjaftueshme në ndjekjen penale të këtyre krimeve, të cilat janë për nga natyra specifike dhe kërkojnë ekspertizë specifike në standardet përkatëse ndërkombëtare si dhe përvojë paraprake në gjykimin e këtyre rasteve komplekse.

**170.** Deri në fund të vitit 2020, asnjë autor i dyshuar nuk ishte gjykuar në mungesë në përputhje me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale i cili u miratua dhe hyri në fuqi në vitin 2019, i cili lejon mbajtjen e gjykimeve në mungesë në lidhje me krimet që kanë të bëjnë me shkelje të rënda të të drejtës ndërkombëtare humanitar dhe të drejtës ndërkombëtare penal të bëra ndërmjet janarit 1998 dhe qershorit 1999. Sidoqoftë, lejimi i një gjykimi pa praninë fizike të të akuzuarit nuk do të ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe standardet e gjykimin të drejtë, në veçanti nenin 6 të KEDNJ-së dhe Konventën për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Për më tepër, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në lidhje me gjykimet në mungesë janë të pasakta dhe të paqarta, veçanërisht në lidhje me veprimet që një gjykatë duhet të ndërmarrë përpara se të vendosë për të organizuar një gjykim në mungesë.

261 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, f. 23.

**171.** Seancat gjyqësore për aktakuzat për krime lufte që kanë ndodhur në të kaluarën kanë zgjatur një kohë papranueshëm të gjatë, madje edhe në rastet kur të akuzuarit mbaheshin në paraburgim. Gjatë gjykimit të këtyre rasteve, trupat gjykues duhet tu përmbahen dispozitave të rrepta të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor kur të akuzuarit janë në paraburgim. Dispozitat e KEDNJ-së lidhur me gjykimin e drejtë po ashtu parashikojnë që gjykimet duhet të përfundojnë brenda një kohe të arsyeshme në rastet kur të akuzuarit janë në paraburgim. Për më tepër, pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të aktakuzës, trupi gjykues duhet, në fazën e hapjes së shqyrtimit gjyqësor, të bëjë përgatitjet e duhura që shqyrtimi gjyqësor të përfundojë brenda afateve të përcaktuara me ligj. Shqyrtimet gjyqësore të zgjatura që nuk justifikohen me numrin e madh të dëshmitarëve, duhet të shmangen. Gjykimet duhet të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara me ligj. Çdo zgjatje parapërcakton vendimin për dënimin.

**172.** Sipas disa organizatave të shoqërisë civile, si FDH në Kosovë, është e rëndësishme të vendoset një bashkëpunim efektiv ligjor midis Prishtinës dhe Beogradit në mënyrë që të zgjidhen më mirë rastet komplekse që përfshijnë krimet e luftës dhe krimet e tjera ndërkombëtare, veçanërisht duke pasur parasysh kontekstin e vazhdimin të dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe thirrjet e bashkësisë ndërkombëtare për rinisjen e negociatave politike. Në veçanti, çështjet në lidhje me bashkëpunimin juridik dhe ndihmën e ndërsjellë juridike duhet të vendosen në agjendën e këtyre negociatave dhe bisedimeve të vazhdueshme, të cilat do të ishin thelbësore për vendosjen e një komunikimi efektiv midis institucioneve gjyqësore të Kosovës dhe Serbisë dhe një ndjekje më të suksesshme penale të krimeve të luftës.

**173.** Jashtë ndjekjeve penale, krijimi i përmendoreve shpesh shihet si një mënyrë për të trajtuar të kaluarën. Në dy dekadat e fundit, mijëra përmendore janë ngritur në Kosovë, megjithëse ka pasur një mungesë të përgjithshme të përfaqësimit të fëmijëve, grave dhe civilëve në përmendoret publike. Përmendoret në kujtim të civilëve të prekur nga konflikti shpesh financohen individualisht përmes iniciativave individuale dhe vendosen në pronësi private. Për më tepër, nuk ka asnjë kornizë ligjore që rregullon përmendoret gjë që lejon çdokënd të ngrejë përmendore në pronë private apo edhe në pronë publike, me një kërkesë të thjeshtë drejtuar autoriteteve të tyre komunale, e cila shpesh miratohet. Kjo mungesë e rregullimit mund të vërë në rrezik tregimin më faktik të ngjarjeve të së kaluarës dhe mund të çojë në përmendore të njëanshme që nuk marrin plotësisht parasysh dhe trajtojnë kompleksitetin e të kaluarës.

**174.** Situata dhe statusi i viktimave dhe të mbijetuarve të dhunës seksuale lidhur me konfliktin (DHSLK) është një çështje tjetër shumë e rëndësishme në lidhje me drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Si rezultat i konfliktit 1998-1999 në Kosovë, gratë dhe burrat, si dhe djemtë dhe vajzat, ishin të ekspozuar ndaj DHSLK-së në të gjithë Kosovën gjatë dhe pas konfliktit. Ndonëse nuk dihet numri i saktë, disa vlerësojnë se ka rreth 20,000 të mbijetuar të DHSLK-së. Deri më tani, megjithatë, nuk ka pasur asnjë dokumentacion sistematik ose hulumtim të DHSLK-së në Kosovë.

**175.** Në vitet e fundit, shumë aktorë në Kosovë kanë bërë përpjekje të rëndësishme për të mbështetur të drejtat e të mbijetuarve të DHSLK-së për dëmshpërblime dhe për të adresuar nevojat e tyre. Në vitin 2014, korniza legjislative u ndryshua për të siguruar dëmshpërblime për të mbijetuarit e DHSLK-së dhe për të krijuar Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Komisioni përbëhet nga gjithsej nëntë anëtarë, i cili përfshin pesë përfaqësues të ministrive përkatëse, psikologë, psikiatër, avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Komisioni autorizoi katër OJQ që kanë përvojë në fushën e mbrojtjes së viktimave të dhunës seksuale për të pranuar kërkesat dhe për të kryer detyra të tjera.<sup>262</sup>

**176.** Ligji i ndryshuar e përkufizon një të mbijetuar të DHSLK-së si një person që i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe përdhunimit që ka ndodhur nga data 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999, megjithëse shoqëria civile vazhdon të avokojë për rishikimin e këtij kufizimi kohor pasi përjashton disa të mbijetuar të DHSLK-së nga procesi. Personat që fitojnë me sukses statusin e të mbijetuarit të DHSLK-së kanë të drejtë për disa forma të dëmshpërblimeve dhe ndihmave,<sup>263</sup> përfshirë një pension mujor prej 230 €; mbulimi i shpenzimeve të shërbimeve shëndetësore jashtë vendit në lidhje me gjendjen shëndetësore që rezulton nga lufta dhe për të cilën trajtimi nuk është i disponueshëm në Kosovë; përparësi për punësim në ndërmarrjet publike dhe private; lirimi nga tatimi në pronë; dhe ndihma në strehim.<sup>264</sup> Procesi i aplikimit dhe marrjes së vërtetimi të statusit DHSLK, që është një parakusht për marrjen e dëmshpërblimeve dhe formave të tjera të ndihmës, filloi zyrtarisht në shkurt të vitit 2018 dhe do të përfundojë në shkurt të vitit 2022. OSHC-të kanë shprehur shqetësime për këtë kufizim kohor arbitrar dhe kanë avokuar për heqjen e tij. Që nga fillimi i tij në vitin 2018, Komisioni Qeveritar ka pranuar 1,396 kërkesa për statusin e DHSLK, nga të cilat 904 ose 75 për qind (873 gra dhe 31 burra) u miratuan, ndërsa 242 ose 20 për qind u refuzuan. Për shkak të situatës me pandeminë, numri i të mbijetuarve që kanë aplikuar për status ka rënë, kryesisht për shkak të zvogëlimit të kontaktit midis të mbijetuarve të DHSLK-së dhe OJQ-ve që janë certifikuar për t'i mbështetur ato në këtë proces duke plotësuar aplikacionet dhe duke ju ofruar këshillim psikosocial. Stigmatizimi i të mbijetuarve të DHSLK-së gjithashtu vazhdoi të mbetet problem dhe sfidë e veçantë në vitin 2020, duke i parandaluar shumë prej tyre të avokojnë ose të flasin hapur për dhunën seksuale dhe përvojat e tyre. Kjo gjithashtu mund t'i ketë dekurajuar ata të kërkojnë ndihmë ose përfitime nga dëmshpërblimet nga frika se identiteti i tyre mund të zbulohet gjatë procesit.

**177.** Përkundër disa përparimeve të bëra në vitin 2020, çështja e rreth 6,044 personave ende të pagjetur si pasojë e konfliktin 1998-1999 në Kosovë mbetet e pazgjidhur. Sipas Komitetit

262 [Rregullore \(QRK\) nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës](#) (30 dhjetor 2015).

263 [Ligji nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre](#) (23 prill 2014), neni 6.

264 Po aty.



Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), ka ende 1,642 persona të zhdukur. Procesi i zbardhjes së fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur, i cili është thelbësor për të realizuar të drejtën e anëtarëve të familjeve të tyre për të vërtetën, ka ngecur gjatë viteve të fundit. Sidoqoftë, përpjekjet e deritanishme kanë rezultuar në sqarimin e fatit të 70 për qind të numrit të përgjithshëm të personave të vlerësuar si të zhdukur. Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur, i miratuar në vitin 2011, vazhdon të rregullojë këtë çështje kritike me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të personave të zhdukur dhe anëtarëve të familjes së tyre, në veçanti të drejtën e anëtarëve të familjes për të vërtetën rreth fatit të më të dashurve të tyre.<sup>265</sup> Megjithëse qeveria e ka miratuar Koncept Dokumentin për Personat e Zhdukur në vitin 2019 me qëllim të ndryshimit të Ligjit Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur,<sup>266</sup> për të cilën gjë familjet e personave të zhdukur kanë avokuar për vite me radhë, Kuvendi ende nuk e ka përfshirë këtë iniciativë të rëndësishme në agjendën e vet legjislative.

**178.** Grupi Punues për Personat e Zhdukur (GPPZH) dhe Komisioni Qeveritar për Personat e Zhdukur (KQPZH) vazhdojnë të funksionojnë si mekanizma kryesorë institucionalë të dedikuar për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Që nga marsi i vitit 2004, GPPZH, i cili kryesohet nga KNKK dhe përbëhet nga dy delegacione nga Beogradi dhe Prishtina, ka qenë një mekanizëm i rëndësishëm bashkëpunimi dhe koordinimi humanitar i angazhuar për të çuar përpara përpjekjet për të realizuar të drejtën e familjarëve të personave të zhdukur për të vërtetën. GPPZH, që trajton përpjekjet për të gjetur personat e zhdukur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetor 2000, ka mbajtur 51 takime që nga shtatori 2020, vendtakimet janë herë në Prishtinë e herë në Beograd.

**179.** KQPZH, i cili është themeluar në vitin 2006, mbikëqyr, harmonizon dhe koordinon aktivitetet me institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Sipas KQPZH-së, autoritetet e Prishtinës kanë kryer nëntë gërmime vlerësuese gjatë vitit 2020 në Mitrovicën e Veriut, Pejë, Gjilan, Rahovec, Skenderaj dhe Prizren, duke rezultuar në gjetjen e mbetjeve mortore të së paku 11 personave në tetë lokacione. Është duke u bërë identifikimi përmes ADN-së. Për më tepër, janë identifikuar shtatë trupa të rivarrosur, katër prej të cilëve iu dorëzuan familjeve. Sipas KQPZH-së serbe, autoritetet e Beogradit kanë kryer tri gërmime vlerësuese në terren në vitin 2020. Mbetjet mortore të së paku pesë personave janë gjetur në një varrezë masive të zbuluar rishtazi në Kishevak të Rashkës ndërsa “miniera e qymyrit Shtavall” në komunën e Sjenicës do të gërmohet në të ardhmen. Lokacioni “Kozarevo” në Rashkë gjithashtu u gërmua por pa rezultat pozitiv.

**180.** Pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht në tërë procesin e zgjidhjes së rasteve të personave të zhdukur, po ashtu edhe në të drejtën e anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur për të vërtetën. Sidoqoftë, GPPZH vazhdoi punën e tij pavarësisht rrethanave përmes takimeve dhe gërmimeve të përbashkëta vlerësuese. Ai ka mbajtur dy takimet e tij të rregullta në shkurt dhe shtator dhe një takim ad hoc në dhjetor të vitit 2020. Puna e OJQ-ve që merren me këtë çështje

265 [Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur](#) (14 shtator 2011), neni 1.

266 [Zyra e Kryeministrit, 'Qeveria ka aprovuar Koncept Dokumentin për Personat e Zhdukur dhe Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian Mbledhja e 107-të e Qeverisë së Kosovës'](#) (18 qershor 2019).

të ndjeshme u rrezikua gjithashtu gjatë pandemisë për shkak të mundësive të kufizuara për të bashkëpunuar, komunikuar dhe shkëmbyer informacion. Qasja në informacion për anëtarët e familjes së personave të zhdukur ishte veçanërisht më e vështirë gjatë izolimit për shkak të qasjes së kufizuar në pajisjet elektronike.

**181.** Çështja e personave të zhdukur është përfshirë edhe në agjendën e bisedimeve të fundit të lehtësuara nga BE në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Janë mbajtur një sërë takimesh të nivelit të ekspertëve mbi personat e zhdukur në Bruksel në korrik si pjesë e dialogut Prishtinë-Beograd. Kjo çështje e rëndësishme është përfshirë edhe në marrëveshjet ekonomike midis Prishtinës dhe Beogradit të nënshkruara në Uashington më 4 shtator 2020, ku të dy palët u zotuan të shpejtojnë përpjekjet për të gjetur dhe identifikuar mbetjet mortore të personave të zhdukur dhe për të caktuar një pikë kontakti për të drejtuar ato përpjekje.

**182.** QBPZH-ja kohët e fundit adresoi mungesën e kapacitetit për t'u marrë me çështjen e personave të zhdukur në nivelin komunal. Në vitin 2020, QBPZH vlerësoi kapacitetet komunale në lidhje me zyrtarët që merren me çështjen e personave të zhdukur dhe shërbimet komunale të ofruara për anëtarët e familjeve të personave të zhdukur. Sipas gjetjeve të QBPZH-së, shumica e komunave në Kosovë nuk kanë zyrtar që merret ekskluzivisht me rastet e personave të zhdukur. Në disa komuna, zyrtarëve të caktuar në departamente të tjera, siç janë zyrtarët komunalë për të drejtat e njeriut, u kërkohet - përveç detyrave të tjera - të adresojnë edhe çështjen e personave të zhdukur dhe të ofrojnë shërbime të ndryshme për anëtarët e familjeve të personave të zhdukur, gjë që ndikon negativisht në realizimin e të drejtave të anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur.

### **183. Rekomandimet:**

- Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren ekskluzivisht me krime lufte duhet të rritet.
- Të gjithë zyrtarëve, duke përfshirë zyrtarët e policisë, prokurorët dhe gjyqtarë, duhet t'u ofrohen trajnime të specializuara në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare.
- Kufizimi kohor i të mbijetuarve të dhunës seksuale për të aplikuar për të marrë statusin e viktimës siç përcaktohet në Ligj duhet të hiqet.
- Qeveria e Kosovës duhet të mbështesë më tej dhe të zhvillojë fushata të gjera për të mbijetuarit e DHSLK-së për të luftuar stigmën.
- Institucionet e Kosovës duhet të fillojnë të punojnë në mënyrë të strukturuar, të bazuar në fakte dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar që përmendoret të dokumentojnë dhe përkujtojnë saktësisht të kaluarën, si në formën e një muzeu të luftës, muzeu të fëmijërisë në luftë, shënimi i vendeve të krimit dhe formave tjera të përkujtimit.

- GPPZH, KQPZH dhe palët e tjera relevante të interesit duhet të shtojnë përpjekjet për të zbardhur fatin e personave të zhdukur dhe për të realizuar të drejtën e familjeve të tyre për të vërtetën, si dhe për drejtësinë dhe rivendosjen, përfshirë duke marrë masa konkrete për të parandaluar politizimin e çështjes dhe për të siguruar që procesi i kërkimit për të zhdukurit të udhëhiqet vetëm nga parimet e respektimit të drejtës humanitare dhe të njeriut.
- Institucionet kompetente duhet të adresojnë çështjen e identifikimit/ndërlidhjes së gabuar të mbetjeve mortore të gjetura gjatë procesit të kërkimit të të zhdukurve.

## 8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

**184.** Korrupsioni ndikon shumë në ushtrimin e të gjitha të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupet dhe personat në situata më të cenueshme.<sup>267</sup> Në veçanti, korrupsioni pamundëson disponueshmërinë, cilësinë dhe qasshmërinë e mallrave dhe shërbimeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm, dhe gjithashtu minon kredibilitetin dhe funksionimin e institucioneve publike dhe sundimin e ligjit, që janë thelbësore për promovimin dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut.<sup>268</sup>

**185.** Korrupsioni në Kosovë ka vazhduar të jetë në çështje serioze dhe urgjente edhe në vitin 2020, ndërsa institucionet e drejtësisë së Kosovës ende nuk kanë treguar ndonjë gatishmëri për të ndryshuar gjendjen. Bazuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2020, Kosova vazhdon të jetë një vend tejet i korruptuar.<sup>269</sup> Sipas Raportit të Lirisë në Botë 2020 për Kosovën, Kosova ende ka një kornizë institucionale të pamjaftueshme dhe të dobët për të luftuar korrupsionin për shkak të mbivendosjes së mandateve dhe koordinimit të pamjaftueshëm, duke rezultuar në “mosbesim” ndaj qeverisë.<sup>270</sup> Autoritetet përkatëse thuhet se nuk janë të përkushtuara në ndjekjen penale dhe trajtimin e korrupsionit të nivelit të lartë dhe dënimet janë ende “të rralla” edhe në ato pak raste ku zyrtarë të lartë ndiqen penalisht për korrupsion.<sup>271</sup> Sipas disa raporteve, sistemi gjyqësor shpesh nuk i ka gjykuar raste qëllimisht për të lejuar parashkrimin e tyre.<sup>272</sup> Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës miratoi një strategji dhe plan veprimi kundër korrupsionit për periudhën 2018-2022, i cili u paraqit në Kuvendin e Kosovës, por ende nuk është miratuar. Kjo tregon për mungesë të vullnetit politik dhe udhëheqjes për të luftuar korrupsionin.<sup>273</sup> Në përgjithësi, Kosova ka bërë “progres të kufizuar” në adresimin e korrupsionit dhe duhet të bëjë më shumë për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e profilit të lartë të korrupsionit, konfiskimin e pasurive të fituara përmes praktikave korruptive dhe krijimin e departamenteve të posaçme gjyqësore të dedikuara për trajtimin e rasteve të nivelit të lartë të korrupsionit, të cilat shpesh janë komplekse për nga natyra.<sup>274</sup>

267 OHCHR, ‘Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut’, qasja e fundit më 28 prill 2021.

268 Po aty.

269 Transparency International, ‘Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2020’ (janar 2021), f. 3.

270 Freedom House, ‘Liria në Botë 2020: Kosova’ (mars 2020).

271 Po aty.

272 Departamenti i Shtetit i SHBA, Raporti për të Drejtat e Njeriut 2020, shënimi 28, f. 22.

273 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, f. 28.

274 Po aty., f. 24.

**186.** Sipas Raportit Vjetor të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) për vitin 2020, AKK ka zhvilluar procedurat e hetimeve paraprake në gjithsej 313 raste, prej të cilave 134 raste kanë qenë të bartura nga vitet e mëhershme dhe 179 janë pranuar nga AKK në vitin 2020. Prej tyre, 124 raste janë referuar në Prokurorinë e Kosovës dhe Policinë e Kosovës, 16 janë referuar në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurave disiplinore, dhe 112 raste janë mbyllur, ndërsa 61 raste janë ende duke u hetuar. Numri i përgjithshëm i raporteve anonime të trajtuara është 19. Gjatë vitit raportues, Agjencia ka trajtuar gjithsej 66 raste të iniciuara sipas detyrës zyrtare.<sup>275</sup>

**187.** Gjatë vitit 2020, PSRK-ja ka ngritur padi kundër katër ish-ministrave të qeverisë, z. Besim Beqaj, znj. Mimoza Kusari-Lila, z. Dardan Gashi dhe z. Nenad Rashiq, si dhe kundër pesëmbëdhjetë personave të tjerë të akuzuar për keqpërdorim të detyrës në lidhje me privatizimin e distribucionit të Korporatës Energjetike të Kosovës,<sup>276</sup> ndërsa gjyqtari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, z. Rafet Ismajli dhe ai i Gjykatës Themelore në Pejë, z. Sali Berisha, gjithashtu u akuzuan për korrupsion. Ky rast nuk ishte përfunduar ende në fund të vitit 2020.

**188.** Një problem tjetër në lidhje me luftën kundër korrupsionit është qasja selektive e gjyqtarëve në rastet e korrupsionit që përfshijnë zyrtarë të profilit të lartë, e cila është në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor dhe trajtim të barabartë sipas ligjit i personave të tjerë që akuzohen dhe ndiqen penalisht për veprat penale të korrupsionit të nivelit më të ulët. Në terma të përgjithshëm, shumica e njerëzve të akuzuar për korrupsion përfundojnë me dënime, por kjo nuk ndodh edhe në rastet kur akuzohen për korrupsion zyrtarë të profilit të lartë.<sup>277</sup> Kjo konfirmohet nga analiza e IKD-së që mbulon periudhën nga 17 shkurti 2008 deri më 31 maj 2020, e cila analizoi 298 aktakuzat kundër 216 politikanëve, shumica e të cilave përmbajnë vepra penale të lidhura me korrupsionin. Sipas gjetjeve të IKD-së, nga 55 raste në të cilat ishin akuzuar zyrtarë të lartë qeveritarë, 33 përfunduan me një vendim të formës së prerë, prej të cilëve vetëm tri raste ose pesë për qind u dënuan, ndërsa në 30 raste të tjera gjykata nuk gjeti asnjë përgjegjësi penale kundër zyrtarëve të profilit të lartë.<sup>278</sup>

### **189. Rekomandimet:**

- Qeveria e Kosovës duhet të demonstrojë udhëheqje të mirëfilltë, aftësi për të praktikuar planifikim paraprak dhe një gatishmëri për të shpërndarë resurset adekuate për të luftuar korrupsionin. Ajo duhet të miratojë një strategji të re dhe plan të veprimit kundër korrupsionit dhe të krijojë një mekanizëm monitorues për të vlerësuar zbatimin dhe ndikimin e tij.

275 AKA, 'Raporti Vjetor i Punës 2020' (Mars 2021), f. 9.

276 Betim për Drejtësi, 'PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë' ([betimiperdrejtesi.com](http://betimiperdrejtesi.com), 10 prill 2020).

277 IKD, 'Lufta për statistika të korrupsionit' (23 qershor 2020).

278 IKD, 'Politikë e "kriminalizuar"' (26 dhjetor 2020).

- Prokurorët në Departamentin për Korrupsion dhe Krim Financiar në PSRK duhet të emërohen sipas parimeve të meritës, ndërsa Zyra e Prokurorit të Kosovës dhe PSRK-së duhet vazhdimisht të investojnë në zhvillimin profesional të prokurorëve në këtë departament
- PSRK-ja duhet të rrisë numrin e rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare.
- PSRK-ja duhet të themelojë një departament të veçantë për luftën kundër korrupsionit.

### 8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut

**190.** Rendi kushtetues i Kosovës, mes tjerash, bazohet edhe në parimet e mbrojtjes së mjedisit.<sup>279</sup> Neni 52 përcakton mbrojtjen e mjedisit si përgjegjësi e të gjithëve dhe kërkon që institucionet publike të marrin parasysh ndikimet mjedisore të vendimeve të tyre. Përveç kësaj, aktet legjislative të Kosovës përfshijnë gjithashtu instrumente dhe standarde ndërkombëtare për të ruajtur ajrin, mjedisin, tokën dhe ujërat,<sup>280</sup> ndërsa Kodi Penal përcakton veprat penale dhe sanksionet për dëmtimin e mjedisit.<sup>281</sup> Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Agjendën 2030 dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, shumë prej të cilëve kanë për qëllim sigurimin e jetës së shëndetshme, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e një planeti më të gjelbër. Megjithatë, disa probleme mjedisore vazhduan edhe në vitin 2020, përfshirë moszbatimin e duhur të kornizës ligjore dhe politikave të tjera.

**191.** Kosova ka shumë probleme mjedisore të trashëguara gjatë dekadave të përdorimit të pakontrolluar të resurseve të ndryshme, si burimet natyrore dhe minerale dhe prodhimi industrial i shoqëruar me nivele të larta të ndotjes. Situata e përgjithshme mjedisore në Kosovë është përkeqësuar viteve të fundit për shkak të rritjes së ndërtimit, trafikut dhe ndotjes industriale, përfshirë ndotjen nga termocentralet dhe ngrohja e shtëpive gjatë dimrit. Kosova është ende në "fazën e hershme" të adresimit të çështjeve mjedisore, siç është ndryshimi i klimës.<sup>282</sup> Në veçanti, Kosova ende ka nevojë që të krijojë një sistem efektiv të monitorimit të ujit, të zbatojë dispozitat ligjore mbi përgjegjësinë mjedisore dhe të zbatojë një strategji për ndryshimet klimatike.<sup>283</sup> Në vitin 2020, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës publikoi një Raport të Treguesve Mjedisorë që analizon trysnitë në mjedis bazuar në treguesit lidhur me ajrin, ujin, tokën, ndryshimet klimatike, biodiversitetin dhe të tjerët, duke plotësuar kështu mungesën në raportim e cila ekzistonte në vitin paraprak.<sup>284</sup>

**192.** Ndotja e ajrit vazhdon të jetë shqetësimi kryesor në Kosovë. Sipas AQICN, Kosova vazhdon të renditet si vend me nivel të moderuar të ndotjes së ajrit prej 74 në Indeksin e Cilësisë së Ajrit.<sup>285</sup> Sidoqoftë, ky nivel i ndotjes së ajrit ndryshon nga qyteti në qytet, ku disa qytete kanë nivel dukshëm më të keq të ndotjes së ajrit.<sup>286</sup> Në veçanti, cilësia e ajrit në Prishtinë është përkeqësuar ndjeshëm.<sup>287</sup>

279 Kushtetuta e Kosovës, shënimi 2, neni 7.

280 Për një listë të legjislacionit përkatës primar dhe sekondar në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike në Kosovë, ju lutemi referojuni <http://kepweb.org/legislation/>.

281 Kodi Penal, shënimi 20, nenet 170, 338-353.

282 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, f. 92

283 Po aty., p. 93.

284 Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, 'Mjedisi i Kosovës 2020 Raport i Treguesve Mjedisorë' (2020), f. 21, Tabela 3.

285 AQICN, "Cilësia e Ajrit në Botë: Renditja e Cilësisë së Ajrit".

286 Po aty.

287 Delfinë Elshani, 'Ajri i Kosovës: Arrin Vlerën e Re më të Ulët' (GLPS, 14 janar 2020).

**193.** Sa i përket ujit, Kosova ka miratuar disa ligje që ende nuk janë plotësisht në përputhje me legjislacionin të BE-së (*acquis*).<sup>288</sup> Megjithëse ekzistojnë ligje që kërkojnë mbrojtjen e burimeve ujore të Kosovës, “ndotja, përdorimi i tepruar dhe keqpërdorimi i lumenjve ka vazhduar me pothuajse të njëjtin ritëm” si në vitet e mëparshme.<sup>289</sup> Ende nuk ka ndonjë iniciativë të dukshme institucionale për të përmirësuar shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, e cila është e domosdoshme për të siguruar «shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik» në Kosovë.<sup>290</sup>

**194.** Në vitin 2020, autoritetet në Prishtinë dhe Beograd nënshkruan një marrëveshje me Shtetet e Bashkuara për të punuar në një studim të fizibilitetit duke konsideruar mundësinë e shfrytëzimit të përbashkët të Liqenit të kontestuar të Ujmanit si burim uji dhe energjie.<sup>291</sup> Sipas marrëveshjes, qeveria u angazhua për krijimin e një Grupi Punues për studimin e fizibilitetit, duke u fokusuar në: (1) “përcaktimin e ndarjes ekzistuese teknike të burimeve ujore të liqenit”; (2) “eksplorimin e mundësive, nëse ka, për të avancuar infrastrukturën e liqenit për të optimizuar furnizimin me ujë, për të mundësuar përdorimin për qëllime të tjera (p.sh. ujitje, ujë të pijshëm)”; dhe (3) “sigurimin që secili rekomandim ose propozim në studim nuk duhet të rrezikojë shfrytëzimin aktual të ujit.”<sup>292</sup>

**195.** Ndërtimi i hidrocentraleve nga KelKos Energy, një kompani me seli në Kosovë për menaxhimin e energjisë nga hidrocentralet në qytetin e Deçanit,<sup>293</sup> është një sfidë tjetër për mbrojtjen e mjedisit e cila mori shumë vëmendje gjatë vitit 2020. Veçanërisht, për shkak të kritikave të shumta që mori nga ambientalistja Znj. Shpresa Loshaj, KelKos Energy së fundmi ngriti padi duke kërkuar 100,000 € nga zonja Loshaj për shpifje.<sup>294</sup>

#### **196. Rekomandimet:**

- Qeveria e Kosovës duhet të bëjë një rishikim urgjent të praktikave të zbatimit të sanksioneve nga inspektorët e mjedisit.
- Qeveria e Kosovës duhet të forcojë koordinimin e aktiviteteve ndërmjet inspektorateve përkatëse, Policisë së Kosovës, Prokurorisë së Kosovës dhe gjykatave në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.
- Qeveria e Kosovës duhet të krijojë një sistem efektiv të monitorimit të ujërave si dhe të zbatojë strategjinë për ndryshimet klimatike sipas rekomandimit nga Komisioni Evropian.

288 Raporti i Progresit BE-së 2020, shënimi 44, f. 94.

289 Raporti i IAP-së 2020, shënimi 26, f. 42.

290 Po aty.

291 Nikola Đorđević, ‘Marrëveshja nënçmuese e Kosovës dhe Serbisë’ (emerging-europe.com, 7 shtator 2020).

292 Qeveria e Kosovës, ‘Plani i Zbatimit të Marrëveshjeve të Uashingtonit. Normalizimi Ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë’ (Tetor 2020).

293 Shpresa Loshaj, ‘Lufta për lumenjtë e Kosovës duhet të vazhdojë’ (prishtinainsight.com, 15 Tetor 2020).

294 Igor Todorović, ‘Pronari i hidrocentralit të vogël padit aktivisten Shpresa Loshaj në Kosovë\* për shpifje’ (balkangreenenergynews.com, 22 shkurt 2021).



